

Public Disclosure Authorized

Raport Nr. 53599-AL

SHQIPËRIA: Axhenda e Re e Rritjes Ekonomike Memorandum Ekonomik i Vendit

Nëntor, 2010

Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore



Dokument i Bankës Botërore

Public Disclosure Authorized

EKUIVALENTËT E MONEDHAVE

Njësia e Monedhës – Lek (ALL)

KURSI I KËMBIMIT

31 Dhjetor, 2009 – ALL 138.0 = € 1.00

PESHAT DHE MASAT

Sistemi Metrik

VITI FISKAL

1 Janar 1 – 31 Dhjetor

SHKURTIME DHE AKRONIME

AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (Rregullatori i Telekomunikacione)	KESH	Korporata Energjetike Shqiptare
BEEPS	Studimi i Mjedisit të Biznesit dhe Performancës së Ndërmarrjeve	OECD	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimit Ekonomik
AK	Autoriteti i Konkurrencës	OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
CAD	Deficiti i Llogarive Rrjedhëse	R&D	Kërkimi dhe Zhvillimi
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes	RIA	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	TFRR	Task Forca e Reformës Rregullatore
ECA	Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore	SEE	Evropa Jug Lindore
ERE	Enti Rregullator i Energjisë	SME	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
BE	Bashkimi Evropian	FNT	Fuqi e Ndjeshme në Treg
IHD	Investime të Huaja Direkte	OST	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto	TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
ICA	Vlerësimi i Klimës së Investimeve	WDI	Treguesit e Zhvillimit Botëror
ICS	Studimi i Klimës së Investimeve	WGI	Treguesit Botërorë të Qeverisjes
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit	FPS	Furnizuesi Publik me Shumicë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar		
PPE	Prodhues i Pavarur i Energjisë		

Zëvendës President:	Philippe H. Le Houerou, ECAVP
Drejtor i Vendit:	Jane Armitage, ECCU4
Drejtor i Sektorit:	Luca Barbone, ECSPE
Menaxher i Sektorit:	Bernard Funck, ECSP2
Drejtuesit e Raportit:	Roland Clarke dhe Erjon Luçi, ECSP2

FALENDERIME

Ky raport u përgatit nga një ekip i drejtuar fillimisht nga Alia Moubayed dhe më pas nga Roland Clarke, Erjon Luçi dhe Borko Handjiski. Ekipi përfshinte Salvador Rivera, Gazmend Daci, Evis Sulko, Rick Hopper, Gentjana Sula, Andrea Guedes, Caterina Ruggeri Laderchi, Alexandru Cojucaru, Andrew Dabalen, Atsushi Iimi, Gareth Locksely, Martin Humphreys, Peter Miovic, Artan Guxho, Donato De Rosa, Sanjay Kathuria, Marco Ranzani and Clelia Rontoyanni.

Raporti u ndërmor nën udhëheqjen e Jane Armitage, Drejtore e Vendit, Luca Barbone, Drejtor i Sektorit, dhe Bernard Funck, Menaxher Sektorit, Camille Nuamah, Drejtore e Zyrës së Vendit dhe Ron Hood Koordinator Sektorial i Vendit, dhe autorët u janë shumë mirënjohës për mbështetjen dhe udhëheqjen e tyre, si edhe për komentet e marra nga Indermit Gill, Krye-ekonomisti Rajonal dhe Juan Zalduendo, Ekonomist Drejtues.

Raporti gjithashtu ka përfituar nga dokumentet informues të përgatitur nga Martin Melecky, Sam Mikhail dhe Ilir Gedeshi. Sébastien C. Dessus, Dilip Ratha, Albert G. Zeufack dhanë komente të dobishme në fazën e konceptimit të raportit. Falënderime të veçanta jepen për rishikuesit e raportit final: Demetrios Papathanasiou, Cevdet Denizer dhe Carole Garnier, gjithashtu komente dhe kontribute shumë të dobishme u morën nga Lars Sondergaard dhe Nina Arnhold. Falënderime gjithashtu për Mismake Galatis dhe Enkelejda Karaj për mbështetjen në përgatitjen e raportit dhe në çështjet organizative dhe administrative.

Raporti gjithashtu ka përfituar nga diskutimet e vlefshme me autoritetet, Sherefedin Shehu, Selami Xhepa, Sybi Hida (Komisioni Parlamentar i Ekonomisë), Altin Rapaj (AKEP) dhe shumë zyrtarë të Ministrisë Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Bankës së Shqipërisë, përfaqësues të bizneseve, akademikë dhe zyrtarë të universiteteve.

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE	I
KAPITULLI 1: PERFORMANCA MAKROEKONOMIKE, KRIZA GLOBALE DHE MË PAS.....	1
I. HYRJE	1
II. PERFORMANCA EKONOMIKE E SHQIPËRISË E KOHËVE TË FUNDIT	2
III. KRIZA DHE SFIDAT E REJA.....	7
IV. PËRGJIGJET E POLITIKAVE NDAJ KRIZËS.....	8
V. PËRSHPEJTIMI I RITJES EKONOMIKE AFATGJATË	11
KAPITULLI 2: ARSIMI DHE AFTËSITË PËR NJË EKONOMI INOVATIVE.....	13
I. HYRJE.....	13
II. HENDEKU I AFTËSIVE	14
III. NGA LARGIMI I TRURIT NË QARKULLIMIN E TRURIT	17
IV. NJË SISTEM MË I MADH DHE MË I MIRË ARSIMOR.....	20
V. PËRMIRËSIMI I AFTËSIVE TË TREGTUESHME.....	24
VI. FUSHAT E REFORMAVE NË ARSIM.....	25
KAPITULLI 3: MODERNIZIMI I INFRASTRUKTURËS.....	30
I. HYRJE	300
II. PËRMIRËSIMI I KONEKTIVITETIT NËPËRMJET TIK	31
III. ENERGJIA ELEKTRIKE.....	39
IV. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT.....	48
KAPITULLI 4: INSTITUCIONET PUBLIKE DHE QEVERISJA PËR INVESTIMET	52
I. HYRJE.....	52
II. QEVERISJA DHE KLIMA E INVESTIMEVE.....	52
III. IMPLEMENTIMI I KUADRIT LIGJOR.....	54
IV. REKOMANDIME.....	60

TABELA

Tabela 1.1: Treguesit Kryesorë Makroekonomikë (në përqindje ndaj PBB, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)	2
Tabela 1.2: Nivelet e Uljes së Varfërisë në Zonat Rurale dhe Urbane	5
Tabela 1.3: Shqipëria – Bilanci i Pagesave (% i PBB)	7
Tabela 2.1: Shpenzimet për Arsimin (Struktura në Përqindje)	20
Tabela 2.2: Numri i nxënësve sipas Niveleve të Arsimit Publik (Mijë)	200
Tabela 2.3: Shpenzimet për Student si % e PBB për Frymë.....	200
Tabela 2.4: Rroga shtesë për Kategori të Ndryshme të Arsimit	21
Tabela 2.5: Zgjerimi i Arsimit të Lartë në Shqipëri (Mijë)	222
Tabela 2.6: Shpërndarja e Studentëve sipas Fushës së Studimit, 2006-2008	233
Tabela 3.1: Performanca e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.....	411
Tabela 3.2: Tarifat e Energjisë Elektrike në Shqipëri (Lek për kWh)	441

FIGURA

Figura 1.1: Performanca Ekonomike e Ekonomive të Europës Qëndrore dhe Juglindore.....	1
Figura 1.2: Përbërja e PBB-së % (figura në të majtë) dhe Punësimi sipas Sektorëve % (figura në të djathtë).....	3
Figura 1.3: Kursime dhe Investime.....	4
Figura 1.4: Kursimet e Brendshme vs. atyre Kombëtare.....	4
Figura 1.5: Raporti i Varfërisë së Përgjithshme sipas Rretheve në përqindje.....	5
Figura 1.6: Bilanci Fiskal (% e PBB).....	6
Figura 1.7: Të ardhurat Fiskale dhe Shpenzimet (% e PBB).....	6
Figura 1.8: Kreditë për Sektorin Privat dhe Depozitat (% e PBB).....	6
Figura 1.9: Normat e Rritjes së Tendencës së Prodhimit.....	88
Figura 2.1: Shpenzimet Publike për Arsimin dhe Nivelet e Arritjeve Arsimore.....	15
Figura 2.2: Treguesi i Aftësive Njohëse (2000).....	166
Figura 2.3: Përqindja e Studentëve me Shkollimin Bazë (2000).....	166
Figura 2.4: Dinamika e Emigrimit të Trurit: përqindja e Akademikëve të larguar jashtë shtetit si % e numrit total të Akademikëve.....	18
Figura 3.1: Ndikimi i Rritjes së Penetrimit të ICT me 10 Pikë Përqindje në Rritjen e PBB për Frymë, 1980-2006.....	311
Figura 3.2: Penetrimi i Internetit dhe PBB për frymë.....	311
Figura 3.4: Pjesa e Teknologjive 3G (përqindje).....	322
Figura 3.3: Penetrimi Celular në Vende të Rajonit dhe BE.....	322
Figura 3.5: Teknologjitë Alternative me Brez të Gjerë.....	333
Figura 3.6: Tarifat e Operatorëve të Telefonisë Celulare në Rajon.....	344
Figura 3.7: Tarifat e Telefonisë Fikse, Tetor 2009, Euro cent.....	344
Figura 3.8: Tarifat e Pajtimin Muajor për Internet me Brez të Gjerë 2 mbps, Euro në muaj.....	344
Figura 3.9: Furnizimi me Energji Elektrike dhe Ndërprerjet.....	400
Figura 3.10: Çmimet e Energjisë Elektrike në Shqipëri, € Cent Për Kwh.....	433
Figura 3.11: Krahasimi i Çmimeve të Energjisë Elektrike, 2007, € Cent Për Kwh.....	433
Figura 3.12: Humbjet në Shpërndarje, Matjet dhe Arkëtimet.....	45
Figura 3.13: Oferta dhe Kërkesa e Parashikuar për Energjinë Elektrike në Shqipëri, Sipas Kuadrit të Ri Rregullator.....	47
Figura 3.14: Çmimi Mesatar për Energjinë Bazë në Bursën Europiane të Energjisë.....	47
Figura 3.15: Gjendja e Rrjetit Rrugor Dytësor/Tretësor.....	49
Figura 4.1: BEEPS 2005 dhe 2008: Përqindja e Firmave që Tregojnë se Ka një Problem.....	544
Figura 4.2: Shpeshësia dhe Madhësia e Rryshfeteve – Të Dhëna për Vendet nga Studimet BEEPS.....	55
Figura 4.3: Rregullimi Formal, Praktikant dhe Implementimit dhe Nivelet e të Ardhurave.....	55
Figura 4.4: Treguesit Botërorë të Qeverisjes për Shqipërinë.....	56
Figura 4.5: Krahasimi Rajonal për Tregues të Përzgjedhur të ËGI.....	56
Figura 4.6: Perceptimi i Interpretimeve Konsistente dhe të Parashikueshme të Ligjeve dhe Rregulloreve.....	599

KUTIA

Kutia 1.1: Popullsia, Fuqia Punëtore dhe Emigrimi.....	3
Kutia 1.2: Roli i Statistikave për Kredibilitetin e Politikave.....	1010
Kutia 1.3: Alternativat për Rregullin Fiskal.....	10
Kutia 2.1: Inovacioni dhe Rritja.....	144
Kutia 2.2: Mobilizimi i Rrjeteve Akademike përmes Programit të Kthimit të Trurit.....	19
Kutia 2.3: Sistemi Universitar në Shqipëri.....	222
Kutia 2.4: Fakulteti i Studimeve Profesionale, Universiteti i Durrësit.....	28
Kutia 3.1: Zhvillimi i TIK dhe Kapitali Human.....	35
Kutia 3.2: Praktika të Mira për Promovimin e Aksesit me Brez të Gjerë.....	37
Kutia 3.3: Prodhuesit me Përdorim Intensiv të Energjisë Elektrike në Shqipëri.....	422
Kutia 3.4: Rregullimet e Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri.....	46
Kutia 4.1: Vendimet Arbitrare dhe Veprimet e Pa Koordinuara.....	57

PËRMBLEDHJE

Hyrje

1. **Që prej 1998, Shqipëria ka përjetuar një transformim të rëndësishëm që e ka ngritur renditjen e saj në nivelin e sipërm të vendeve me ardhura të mesme dhe ka mundur një ulje të ndjeshme të varfërisë.** Rritja ekonomike midis 1998 dhe 2010 arriti mesatarisht mbi 6 përqind në vit – performanca më e mirë në Evropë. Kjo ndihmoi në përgjysmimin e varfërisë absolute, që si numër individësh ra nga 25 përqind e popullsisë në 2002 në 12 përqind në 2008. Periudha e fundit e krizës globale e ka ngadalësuar disi rritjen ekonomike por jo aq ashpër si në shumë vende të tjera.

2. **Renditja mes vendeve në nivelin e sipërm me të ardhura të mesme sinjalizon një ndryshim të rëndësishëm të natyrës së sfidave me të cilat përballet Shqipëria në ecjen e saj përpara.** Rritja ekonomike e kohëve të fundit i atribuohet në masë të madhe lëvizjes së dukshme të punëtorëve nga bujqësia në sektorët e shërbimeve dhe prodhimit. Kjo rishpërndarje *ndër-sektoriale* e fuqisë punëtore nga aktivitete me produktivitet të ulët tek ato me produktivitet më të lartë është e mirëpritur, por kjo ka të ngjarë të jetë vetëm një mënyrë e përkohshme për të përmirësuar produktivitetin të përgjithshëm. Dikur, këtij procesi do ti vijë fundi në Shqipëri dhe rritja ekonomike do të duhet të gjenerohet gjithnjë e më shumë nga politikat që mbështesin rritjet *brenda-sektoriale* të produktivitetit.

3. **Sfidat e reja pasqyrohen gjithashtu dhe në natyrën e marrëdhënies së Shqipërisë me vendet e tjera në aspektin ekonomik global më të gjerë.** Vendet në nivelin e sipërm me të ardhura të mesme përballen me konkurrencën e vendeve si sipër ashtu dhe poshtë tyre në renditje. Poshtë tyre, vetëm pak nivele më poshtë në fazën e zhvillimit, janë konkurruesit me paga të ulëta, të cilët prodhojnë të njëjtat produkte dhe konkurrojnë nëpërmjet fuqisë së lirë punëtore. Sipër tyre në renditje janë vendet më të pasura të cilat prodhojnë produkte më komplekse, duke përdorur procese më të avancuara prodhimi dhe të cilat konkurrojnë në bazë të inovacionit, adaptimit dhe aftësive. Për rrjedhojë, vendet me të ardhura mesatare të larta si Shqipëria gjenden nën presion. Atyre u duhet të përparojnë ose do të kalohen nga vendet e tjera.

4. **Përveç kësaj, Shqipëria po integrohet gjithnjë e më shumë në sistemet globale të prodhimit, duke u bërë më e varur nga tregtia ndërkombëtare si dhe teknologjia dhe kapitali ndërkombëtar.** Në të ardhmen e afërt apo dhe afatmesme, rritja ekonomike globale ka gjasa të jetë më e ngadaltë duke i bërë më të vështira kushtet dhe disponibilitetin e kapitalit. Këta faktorë të jashtëm po bëhen gjithmonë e më të rëndësishëm për Shqipërinë ndaj duhen marrë parasysh dhe i duhet përshtatur.

5. **Këto sfida sugjerojnë nevojën për një “axhendë të re të rritjes ekonomike” e cila përbën edhe temën kryesore të këtij raporti.** Raporti është i organizuar në katër kapituj. Kapitulli 1 paraqet një vështrim të përgjithshëm makroekonomik, analizon rreziqet potenciale për ekonominë dhe propozon masat për ruajtjen e stabilitetit makro-financiar të saj. Ai shtjellon më tej sfidat e rritjes ekonomike me të cilat përballet Shqipëria si një vend i sapo klasifikuar me të ardhura mesatare të larta. Kapitulli 2 përshkruan nevojat për kapital njerëzor të axhendës së re të rritjes ekonomike duke u fokusuar te arsimi dhe aftësitë. Kapitulli 3 shqyrton sektorët kryesorë të infrastrukturës, ndërsa kapitulli i fundit trajton klimën e investimeve dhe faktorët që ndikojnë në kthimin e investimeve.

6. **Raporti paraqet një diagnozë të disa prej faktorëve kryesorë të cilët mund të nxisin rritjen ekonomike në të ardhmen por pa dhënë rekomandime për produkte apo fusha specifike për investimet private.** Raporti nuk sugjeron dhe nuk mund të sugjerojë se cilët sektorë (bujqësia, turizmi, shfrytëzimi i minierave, sektori bankar, etj) duhet të zhvillohen, pasi këto vendime do të merren nga investitorët privat. Por raporti argumenton se roli i qeverisë në këtë proces është ai i një

lehtësuesi, që heq pengesat ndaj investimeve, ndihmon në qarkullimin e informacionit dhe në krijimin e institucioneve të nevojshme për lulëzimin e firmave private.

Vështrim i Përgjithshëm Makroekonomik dhe Sfidat për Rritjen Ekonomike në të Ardhmen

7. **Rritja e lartë ekonomike në dekadën e fundit u mbështet nga politika të shëndosha fiskale dhe monetare si dhe një luhatje e ulët makroekonomike.** Mjedisi i qëndrueshëm i krijuar nga kuadri politikave të shëndosha mbështeti një transformim të madh të ekonomisë ku burimet u zhvendosën nga sektori i bujqësisë dhe industrisë së vjetruar në sektorin e ndërtimit dhe atë të shërbimeve. Integrimi i Shqipërisë me ekonominë e vendeve fqinje erdhi në rritje, me rritjen e fortë të eksporteve, por dhe me thellimin e deficit tregtar të financuar nga remitancat, të ardhurat nga privatizimet si dhe nga financime të huaja koncesionare dhe investime të huaja direkte (IHD). Megjithëse ritmi i rritjes ekonomike u zbeh disi për shkak të krizës ekonomike globale, efektet negative të saj u lehtësuan pjesërisht nga përsheptimi i shpenzimeve publike në vitet 2008 dhe 2009.

8. **Dy vitet e fundit, nxorën në pah rreziqet për shkak të pasigurisë në mjedisin e jashtëm dhe nevojës për parashikime të kujdesshme për qëllime të planifikimit buxhetor.** Nënvlërësimi fillestar i rrjedhojave të krizës së fundit globale ekonomike dhe financiare për Shqipërinë (ashtu si në rastin e shumë vendeve të tjera) çoi në parashikime mbi-optimiste të rritjes ekonomike dhe të ardhurave. Si rezultat, realizimi i të ardhurave nga taksat më të ulëta nga sa ishin parashikuar çoi në rritje të deficitit buxhetor apo në nevojën për përshtatjen e planeve të shpenzimeve gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Ndryshimet e paparashikuara në deficit apo në shpenzime mbartin rrezikun e humbjes së besimit nga ana e huadhënësve dhe investitorëve të huaj, burimet e të cilëve janë të domosdoshme për të realizuar aspiratat e Shqipërisë në lidhje me rritjen ekonomike. Për më tepër, kriza botërore ka ndryshuar ndjeshëm sjelljen e investitorëve të huaj ndaj rrezikut. Në vitet e ardhshme, kapitali pritet të jetë më i kufizuar për të gjitha vendet në zhvillim. Vendet që gëzojnë besueshmëri makroekonomike më të lartë do jenë ato që do të kenë mundësinë për të përfituar më shumë nga kapitali i kufizuar në dispozicion.

9. **Politika fiskale ka nevojë për një spirancë – në mënyrë që tregjet dhe investitorët të binden për qëndrueshmërinë e saj afatgjatë.** Kjo spirancë është veçanërisht e rëndësishme në situatën kur nivelet e borxhit janë relativisht të larta, dhe në kushtet aktuale të shqetësimeve ndaj borxheve sovraane. Për shumë vite, Shqipëria përfitoi nga një politikë fiskale e kujdesshme, me deficite në një trend rënës dhe me vendosjen e një objektiivi për reduktimin e borxhit i cili garantonte qëndrueshmërinë fiskale. Këto politika mbështeteshin dhe nga programe të FMN.

10. **Ky raport mbështet propozimin e autoriteteve për përcaktimin e një rregulli fiskal si një spirancë për politikën.** Ky rregull fiskal nënkupton përdorimin e supozimeve realiste për kuadrin afat-mesëm makroekonomik dhe lehtësimin e angazhimit të qeverive për qëndrueshmërinë fiskale. Për rrjedhojë kjo duhet të rrisë hyrjen në tregjet financiare me norma interesi relativisht më të ulëta. Gjithashtu, ajo do të ndihmonte në konsolidimin e arritjeve pozitive makroekonomike në të kaluarën dhe përmirësimin e besueshmërisë të kuadrin afat-mesëm të buxhetit.

11. **Gjithashtu vlen të vihet në dukje se kursimet dhe ndërmjetësimi financiar nuk kanë qenë kufizim serioz për investimet dhe rritjen ekonomike.** Kursimet kanë qenë të mjaftueshme për të financuar investime në nivele relativisht të larta, dhe ndërmjetësimi financiar ka pasur një rritje të jashtëzakonshme, megjithëse për shumë ndërmarrje të vogla dhe të mesme aksesit për kredi mbetet i kufizuar. Qëndrueshmëria e sistemit financiar reflekton zbatimin e një regjimi të fortë dhe efikas mbikëqyrës gjatë dekadës së fundit.

12. **Së fundmi, Shqipëria përballet me një sfidë që është rrjedhojë e suksesit të zhvillimit ekonomik të saj.** Progresi i arritur gjatë dekadës së fundit tregon se kërkesa për inpute të nevojshme për procesin e zhvillimit është duke u rritur dhe natyra e saj po ndryshon. Analiza në raport tregon se, pavarësisht progresit të arritur (për shembull në reformat në arsim dhe investimet në infrastrukturë), kufizimet më të mëdha për rritjen e mëtejshme ekonomike duket se janë në fushat e kapitalit njerëzor

(veçanërisht aftësitë e tregtueshme), dhe infrastrukturë (konektiviteti, furnizimi me energji elektrike dhe, në një shkallë më të vogël, transporti). Këto kufizime pasqyrojnë rritjen e nivelit të të ardhurave që ka çuar në rritjen e sofistikimit të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara dhe të kërkuara. Në fakt, rritja e kërkesës ka qenë më e shpejt se sa oferta për kapital njerëzor, për aftësi menaxhuese dhe për një infrastrukturë të sofistikuar. Për ti mbajtur tërheqëse kthimet nga investimet dhe për të mbështetur rritjen ekonomike në të ardhmen hendeku i krijuar duhet të zvogëlohet. Për më tepër, në një mjedis më kompleks, kuadri institucional së bashku me zbatimin e ligjeve dhe politikave (efektiviteti i institucioneve publike) marrin një rëndësi të veçantë.

Arsimi, Aftësitë dhe Inovacioni

13. **Shqipëria e filloi tranzicionin me një popullsi me më shumë vite shkollimi se vendet e tjera me nivel të ngjashëm të ardhurash për frymë.** Megjithatë, të arsimuarve para periudhës së tranzicionit, dhe për shumë vite më pas, ju mungonin aftësitë dhe mënyra e të menduarit që i përshtaten një ekonomie tregu me zhvillim të shpejtë. Edhe pse janë iniciuar reforma të mëdha arsimore, firmat tregojnë se shumë të diplomuar në universitete, por edhe në shkollat e mesme, ende nuk i kanë njohuritë e duhura për vendet e sotme të punës.

14. **Me progresin dhe zhvillimin e Shqipërisë, sfidat në sistemin arsimor janë bërë më imediate.** Ndër sfidat më të rëndësishme janë nevoja për mekanizma efikas në sektorin privat për të komunikuar kërkesat e tij në sistemin arsimor, dhe nevoja për zhvendosjen e theksit nga *inputet* në arsim drejt *rezultateve* të arsimit. Disa prej këtyre problemeve janë duke u trajtuar aktualisht nëpërmjet reformave të iniciuara në arsimin e mesëm dhe të lartë, por ato duhet të shihen si prioritet kryesor në vitet e ardhshme, pasi përpjekjet e reformave mund të duan shumë vite për të ndryshuar rrënjësisht strukturën dhe cilësinë e forcës së punëtore.

15. **Rëndësia e konsolidimit të aftësive dhe arsimit është pranuar dhe po realizohet përmes reformave të gjera që qeveria ka iniciuar në arsimin e ulët, të mesëm dhe të lartë.** Këtu bëjnë pjesë reformat e kurrikulave në arsimin e ulët dhe të mesëm me qëllim për t'i bërë kurset më modulare dhe për të ofruar më shumë zgjedhje dhe pjesëmarrje aktive në një ambient të përmirësuar mësimi. Me rëndësi të veçantë në këtë fushë është futja e lëndës së TIK në programin e shkollave të mesme, së bashku me ri-trajnimin e mësuesve dhe pajisjen e disa shkollave me laboratorë kompjuterash dhe internet. Në arsimin e lartë është duke u ndërmarrë një proces për reformimin e standardeve të kurrikulave, për garantimin e cilësisë dhe ristrukturimin sipas kartës së Bolonjës. Përveç kësaj, në universitetet e rretheve janë duke u prezantuar edhe programe kualifikimi me cikël të shkurtër, nën nivelin e diplomës.

16. **Rëndësi ka jo vetëm sasia por edhe cilësia.** Shqipëria ka ndërmarrë hapa në rritjen e numrit të të diplomuarve në arsimin e lartë. Programi i qeverisë për zgjerimin e arsimit të lartë ka bërë që numri i studentëve të diplomuar të rritet me mbi 14,000 në vitin 2009 krahasuar me 6,000 në vitin 2003. Me nivelet aktuale të pranimit, numri i të diplomuarve në vit ka mundësi të arrijë në 25,000 në vitin 2012. Megjithatë, përfitimet e të pasurit të një numri të lartë të diplomuarish do të humbin nëse cilësia është e ulët dhe metodat e mësimdhënies nxisin të mësuarit rutinë. Kjo do të thotë se duhet të bëhen përpjekje për të garantuar një zgjerim të arsimit të lartë pa kompromentuar cilësinë e tij.

17. **Për të rritur gjasat që të diplomuarit në sistemin arsimor Shqiptar të përvetësojnë me sukses ato njohuri që do të rrisnin produktivitetin e ndërmarrjeve Shqiptare, mund të merren një sërë masash.** Këto masa do të plotësonin dhe do të mbështesnin proceset e reformave aktuale në arsimin e lartë. Masat e propozuara përfshijnë hapat për përmirësimin e mëtejshëm të përgjegjshmërisë në arsimin e lartë dhe lidhjen më mirë të tij me kërkesat e tregut. Një hap tjetër do të ishte bërja e arsimit të mesëm të përgjithshëm universal dhe forcimin e tij duke i kushtuar më shumë vëmendje cilësisë së mësimdhënies, duke ndihmuar ata që kanë vështirësi për të mbajtur ritmin me të tjerët, dhe në veçanti, duke përshpejtuar dhe konsoliduar reformat aktuale për kurikulën e TIK.

18. **Reformat aktuale në sistemin arsimor vënë theksin dhe mbi rëndësinë e përgjegjshmërisë.** Përvoja ndërkombëtare tregon se kur performanca është e vëzhgueshme, atëherë do të krijohen stimujt dhe mekanizmat për përmirësimin e saj. Për këtë arsye, raporti rekomandon mbledhjen dhe publikimin e informacionit të detajuar në lidhje me: (i) Rezultatet e provimeve të maturës për secilin rreth dhe shkollë; (ii) rezultatet mesatare të maturës për studentët e pranuar në të gjitha degët dhe në të gjitha universitetet; (iii) rezultatet e provimeve përfundimtare, dhe normat e plotësimit për secilën degë; (iv) sondazhe për punësimin e të diplomuarve; (v) një sondazh i përvitshëm nga ana e punëdhënësve për të vlerësuar performancën e të diplomuarve nga universitete të ndryshme; dhe (vi) një sondazh i përvitshëm nga ana e punëdhënësve mbi aftësitë që kërkohen dhe që disponohen.

19. **Publikimi i informacionit do të shërbente si baza e nevojshme për politikbërësit për të gjykuar se në cilat fusha funksionojnë reformat dhe se ku kërkohet forcimi i tyre.** Ky informacion është po aq i rëndësishëm edhe për studentët dhe familjet e tyre të cilët do të ndërgjegjësoheshin për dallimet në cilësi dhe oportunitete. Kjo do të krijonte një shtysë më të madhe për reformimin e institucioneve me performancë të dobët, të paktën përmes kërkesave konkurruese për pranim në institucionet që qëndrojnë më mbi nivelin mesatar.

20. **Për të tërhequr studentët dhe për të drejtuar burimet drejt fushave ku ka mungesë aftësish mund të hartohen skema stimuluese.** Kjo mund të përfshijë ofrimin e bursave në fusha si inxhinieria apo TIK. Një mundësi tjetër është që financimi të bazohet në regjistrimet aktuale me një diferencim i cili reflekton rëndësinë e një disipline të caktuar për zhvillimin. Kjo do të nxiste një konkurrencë më të madhe midis universiteteve për thithjen e studentëve dhe do të siguronte stimujt për përmirësimin e cilësisë dhe eficiencës. Së fundmi, tarifat e shkollës mund të rriten me 15-20 përqind të kostos së shkollimit (rritje më të lartë për disiplinat ku ka një tepëri të diplomuarish), por e kombinuar me dhënie të kontrolluar të bursave dhe/ose huave për studentët e klasifikuar me të ardhura të ulëta. Këto reforma do të rrisnin financimet në këtë sektor, do të ofronin stimujt për studentët dhe prindërit e tyre për të kërkuar vlera për atë që paguajnë, si dhe do të përmirësonin nivelet e diplomimit.

21. **Ekonomia do të përfitonte nga masat që nxisin kthimin e Shqiptarëve të mirë-arsimuar nga diaspora.** Rreth 40 përqind e stafit të universiteteve dhe instituteve shkencore ka emigruar, me humbje edhe me të mëdha për shkencat natyrore, inxhinieritë dhe fizikën. Pa dyshim që pjesa më e madhe e këtij largimi të trurit ndodhi gjatë viteve të para të tranzicionit por tashmë ekziston mundësia për shfrytëzimin e qarkullimit të trurit pasi shumë prej këtyre emigrantëve mendojnë të kthehen në atdhe. Për këtë qëllim, forcimi dhe zgjerimi i programit Brain Gain të Shqipërisë do të ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm. Vazhdimi i reformave në mjedisin universitar dhe shkencor, të cilat do t'i bënin kushtet e punës më tërheqëse, do të nxiste gjithashtu kthimin e akademikëve dhe profesionistëve të kualifikuar shqiptarë, dhe do të ofronte një stimul për t'i shtyrë individët me kualifikim shumë të lartë të qëndrojnë në Shqipëri.

Modernizimi i Infrastrukturës

Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit

22. **Qeveria është e angazhuar për zhvillimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimeve (TIK) dhe ka bërë përpjekje të mëdha për të krijuar një kuadër të përshtatshëm institucional për TIK.** Qeveria krijoi një organ të pavarur rregullator, që tani njihet si AKEP. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit u krijua në vitin 2007, për të koordinuar zhvillimin, administrimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe për promovimin e shoqërisë së informacionit. Në vitin 2009, qeveria nisi “Iniciativën e Shqipërisë Dixhitale”, dhe në të njëjtën kohë u krijua një Ministri e re për Inovimin dhe Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimeve (me kompetenca për komunikimet elektronike dhe shërbimet postare), për menaxhimin e dixhitalizimit të shoqërisë, dhe për reformat në fushën e shoqërisë së informacionit si edhe dhe menaxhimin dhe implementimin e strategjisë. Gjithashtu, shumica e elementëve bazë të kuadrit rregullator për

telekomunikacionet janë efektiv. Tregu i telekomunikacioneve në Shqipëri është plotësisht i liberalizuar, dhe në Qershor 2007, qeveria privatizoi operatorin shtetëror të telefonisë fikse, Albtelecom.

23. **Infrastruktura e TIK në Shqipëri ende perceptohet nga firmat si e pamjaftueshme për të plotësuar sfidat e axhendës së re të rritjes ekonomike.** Përçindja e firmave që raportuan se telekomunikacionet përbëjnë një pengesë për të bërë biznes u rrit nga 21 përçind në 2005 në 56 përçind në 2008. Kjo rritje nuk do të thotë se ka përkeqësim në infrastrukturë, por më tepër një rritje kërkesë e cila ka tejkaluar përmirësimin e shpejtë në infrastrukturën e telekomunikacioneve në vitet e fundit. Përdorimi i infrastrukturës moderne të TIK është i ulët; në fakt, vetëm 2.5 përçind e popullsisë ka lidhje me brez të gjerë në 2009, që është një fraksion shumë i ulët në krahasim me vende të tjera Evropiane apo me shumicën e vendeve fqinje.

24. **Për të arritur një rritje të shpejtë të TIK ka nevojë si për politika dhe për investime që rrisin konkurrencën dhe kapacitetin e infrastrukturës.** Hapat më të rëndësishëm për arritjen e një tregu konkurrues do të jenë zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Shqipërisë për Integrim dhe Zhvillim, dhe zbatimi i ligjit të ri të komunikimeve elektronike. Zbatimi i ligjit duhet të çojë drejt futjes së teknologjive dhe shërbimeve të reja me çmime më të lira.

25. **Për futjen e teknologjive të reja në treg, Shqipëria duhet të zgjerojë më shpejt teknologjitë alternative të rrjeteve, të tilla si 3G celular, DLS, TV kabllor dhe WiMax.** Për shembull, Shqipëria është i vetmi vend në Evropë (së bashku me Kosovën) që nuk ka dhënë akoma asnjë licencë 3G. Në këtë aspekt, përfundimi me sukses i tenderit të hapur kohët e fundit për një licencë 3G duhet t'i hapë rrugën ofrimit të këtyre shërbimeve në vitin 2011. Dokumenti i politikës së sektorit ka parashikuar futjen e teknologjive të tjera, si TV kabllor dhe internet dhe WiMax – që duhet të kryhen pa vonesë.

26. **Për shkak të kapaciteteve të kufizuara të infrastrukturës, qarqet lokale duhen ndarë dhe të jepet me qera me tarifa të arsyeshme për operatorët e rrjeteve alternative¹.** Kjo do të kontribuonte në rritjen e rrjetit tradicional DSL dhe do të kërkojë ribalancimin e tarifave të Albtelecom. Në Shqipëri ky segment vazhdon të jetë pak i zhvilluar dhe pothuaj tërësisht i monopolizuar nga Albtelecom. Gjithashtu tarifat e linjave me qera duhet të bazohen në kosto. Aktualisht, tarifat për lidhje me shpejtësi të lartë janë shumë të shtrenjta, duke dekurajuar hyrjen e agjentëve të rinj në këtë segment të tregut.

27. **Kapaciteti i ulët i rrjetit parësor me fibër optike tokësore do të duhet të zgjidhet në periudhë afatmesme, nëpërmjet investimeve të reja.** Suksesi i internetit me brez të gjerë është i lidhur ngushtë me infrastrukturën mbështetëse të nevojshme të rrjetit parësor. Albtelecom është i vetmi operator që ka lidhje kombëtare (ndër-urbane dhe urbane) dhe ndërkombëtare, por rrjeti i tij është i kufizuar vetëm në disa akse kryesore. Më shumë përpjekje duhen bërë për të përmirësuar nxitjet për të investuar në infrastrukturë urbane dhe ndër-urbane si edhe në lidhjet ndërkombëtare. Gjithashtu duhet të përcaktohen rregulla të qarta për “të drejtën e ndërtimit të rrjetit” (rights of way) të tilla si planifikimi paraprak i kanaleve/tubacioneve në rrugë të reja dhe shtrirjen e tyre në rrugët ekzistuese dhe krijimin e një kuadri për përdorimin e përbashkët të faciliteteve. Për shkak të kostove të larta fillestare, shteti mund të kontribuojë nëpërmjet shtrimit të fibrës apo tubacioneve në projektet e infrastrukturës (p.sh. rrugët, linjat e transmetimit të energjisë elektrike).

28. **Së fundmi, Shqipëria mund të ketë nevojë për një “shtytje të fortë kërkesë” për tu futur në një rreth virtual që rrit ndjeshëm tregun e shërbimeve të lidhura me internetin.** Kjo është e nevojshme për shkak se tregjet e TIK priren të zhvillohen me shpejtësi pasi arrihet një nivel kritik. Në botë ekzistojnë shumë përvoja në lidhje me politikat që nxisin adoptimin e shërbimeve me brez të

¹ Qarku lokal i referohet lidhje së “miljes së fundit” që lidh telefonat individual fikse me rrjetin e ofuesit të shërbimeve të telekomunikacioneve. Pronarët e qarkut lokal janë në pozitë të një monopoli natyror dhe mund të nxjerrin fitime shumë të larta dhe të pengojnë zhvillimin nëse nuk rregullohen në mënyrën e duhur.

gjerë. Veçanërisht të dobishme për këtë janë politikat e 'rrethit virtual' të BE. Tregjet e lidhura me TIK në Shqipëri, janë ende të pazhvilluar, përveç telefonisë celulare 2G. Qeveria ka mundësinë e marrjes së rolit drejtues në krijimin e një kërkesë të tillë nëpërmjet zbatimit të qeverisjes-elektronike, duke filluar me prokurimin elektronik të blerjeve dhe punëve publike. Përvoja e ekonomive të tjera në tranzicion dëshmon rëndësinë që ka rritja e kërkesës në tregjet e TIK.

Energjia elektrike

29. **Pothuajse e gjithë energjia elektrike e prodhuar në vend, e shpërndarë nëpërmjet rrjetit kombëtar të Shqipërisë, prodhohet prej hidrocentraleve të saj.** Në vitet me reshje të ulëta, kombinimi i motit i thatë, i tarifave nën-kosto të pakicës, i humbjeve të mëdha në rrjet (teknike apo jo-teknike), i niveleve të ulëta të arkëtimeve, dhe i kërkesës në rritje, bëri që Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) mund të realizonte furnizimin me energji elektrike vetëm duke pësuar humbje ose duke zbatuar ndërprerjet të energjisë në masë. Kjo situatë rezultoi në një furnizim të paqëndrueshëm dhe ndonjëherë me cilësi të dobët (luhatje tensioni) të energjisë.

30. **Duke reaguar ndaj kësaj situate, autoritetet shqiptare ndërmorën një sërë reformash të rëndësishme në sektorin e energjisë.** Në dy vitet e fundit, sektori ka pasur përparime shumë pozitive, sidomos pas zbatimit të një modeli të ri tregu në 2008. Si rezultat i kushteve të përmirësuar hidrike, ndërtimit të TEC-it të Vlorës (i cili do të nisë punën së shpejti), krijimit të entit të pavarur rregullator, si dhe i privatizimit të operatorit të shpërndarjes me pakicë, sektori Shqiptar i energjisë ka bërë përpara drejt përmirësimit të besueshmërisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

31. **Vitet në vijim janë vendimtare që modeli i ri i tregut të bëhet plotësisht efektiv.** Kjo do të kërkojë: (i) përmirësimin e gjendjes financiare, menaxheriale dhe teknike të kompanive energjitike shtetërore në zinxhirin e furnizimit dhe reduktimin e borxheve të prapambetura ndaj kompanive të lidhura me to; (ii) reduktimin e detyrimeve të kontigjencës ndaj qeverisë; (iii) zhvillimin e sektorit të shpërndarjes në mënyrë që ai të bëhet sa më efikas dhe funksional, përfshirë kompaninë e shpërndarjes të privatizuar kohët e fundit, si dhe kryerjen e investimeve të nevojshme për të reduktuar humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes nga nivelet aktuale tejet të larta rreth 32 përqind në 15 përqind; dhe (iv) gjetjen e mënyrave të tjera për rritjen e kapacitetit prodhues nga ana e qeverisë, sidomos nëpërmjet projekteve të vogla por eficiente të energjisë hidrike dhe erës, dhe duke ruajtur kapacitetet e saj prodhuese më të kushtueshme për prodhimin e energjisë si rezerva në kushte të jashtëzakonshme.

32. **Reforma e tarifave duhet të mbajë parasysht ndikimin mbi të varfrit dhe grupet në nevojë të popullsisë.** Deri më sot, përpjekjet për të garantuar një nivel minimum të konsumit të energjisë për të varfrit janë si përmes (i) strukturës së tarifave ashtu dhe (ii) subvencioneve të ofruara nga sistemi i mbrojtjes sociale. Struktura e tarifave siguron që nivelet i ulët i konsumit të energjisë të kenë tarifa më të lira. Në rastin e Shqipërisë, blloku i parë i konsumit duket të jetë tepër i lartë për të garantuar "kufirin jetësor", ndërsa subvencionet e ofruara përmes sistemit të mbrojtjes sociale, megjithëse janë të orientuara mirë, kanë mbulim relativisht të ulët (nga sistemi i ndihmës sociale përfitojnë vetëm 12 përqind e të varfërve). Ndaj është i nevojshëm, në kuadrin e reformës, vlerësimi i alternativave të mundshme për të garantuar nivelet bazë të konsumit të energjisë. Nga dy instrumentet aktual, struktura e tarifave duket të jetë tepër e kushtueshme për të mbrojtur të varfrit (për shkak të rrjedhjes së lartë tek grupet me të ardhura më të larta).

33. **Kalimi drejt një Tregu Rajonal të Energjisë në një periudhë afatmesme është gjithashtu i rëndësishëm.** Me rritjen e mëtejshme të ekonomisë, lind nevoja e disa kapaciteteve të reja prodhuese në vend, por akoma më e rëndësishme është pjesëmarrja në Shkëmbimet Rajonale të Energjisë. Për rrjedhojë, nevojitet krijimi i një mjedisi të përshtatshëm institucional, çmimesh dhe investimesh. Kjo do të tërhiqte dhe do të lehtësonte investimet në sektorin e prodhimit duke përfutur nga pozita gjeografike e Shqipërisë për të maksimizuar Tregtinë Rajonale të Energjisë. Përfitimet nga furnizimi i sigurt ("24/7") dhe me cilësi të lartë të energjisë nuk do të ishin vetëm për sektorin e energjisë, por mund të kenë një efekt pozitiv edhe në sferat e tjera të veprimtimit të qeverisë. Kalimi drejt

tregut rajonal të energjisë nënkupton dhe transformimin e KESH për të zhbllokuar vlerën e pasurisë të tij dhe për ta shndërruar atë në një kompani moderne të energjisë elektrike.

Transporti

34. **Sigurimi i një infrastrukture të mirë transporti përbën një komponent jetësor dhe kritik për zgjerimin e tregtisë dhe konkurrueshmërisë më të lartë.** Infrastruktura e dobët e transportit përkthehet në kosto më të larta dhe një disavantazh konkurrues për prodhuesit vendas në tregjet ndërkombëtare, si dhe në çmime më të larta për mallrat e importuar.

35. **Në përmirësimin e rrjetit rrugor është bërë shumë progres përmes investimeve të reja të cilat kapin shumën 1.4 miliard Euro në katër vitet e fundit.** Gjithashtu, gjendja e rrjetit është përmirësuar ndjeshëm. Aktualisht, dy të tretat e rrugëve kombëtare kryesore dhe gjysma e rrugëve kombëtare dytësore janë në gjendje të mirë, me një përmirësim të dukshëm që nga viti 2005.

36. **Në sektorin rrugor, çështja kryesore është përcaktimi i kujdesshëm i fazave të zhvillimit të rrjetit.** Lidhjet rajonale të ofruara nga rrjeti kryesor rrugor nuk janë plotësisht të mjaftueshme. Pothuaj 95 përqind e rrugëve rajonale dhe lokale janë në gjendje të keqe. Faza tjetër në sektorin e transportit kërkon ruajtjen e një ekuilibri të vështirë ndërmjet vazhdimin të zhvillimit të rrjetit aty ky është ekonomikisht e mundur, dhe forcimit të kuadrit institucional për të garantuar ruajtjen e asetëve, rrugëve të reja dhe të përmirësuara.

37. **Gjithashtu Durrësi, porti kryesor me lidhje të mira me rrjetin kombëtar rrugor dhe hekurudhor, ka mundësi të konkurrojë në nivel rajonal.** Por autoritetet portuale duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje mirëmbajtjes së pajisjeve, mjediseve dhe strukturave të portit, si dhe zgjerimin e portit. Kjo do të mundësojë hyrjen në port edhe të anijeve më të mëdha, duke rezultuar në një shfrytëzim më optimal të investimeve të bëra në vendet e reja të ankorimit dhe zonat e magazinimit. Që porti i Durrësit të bëhet konkurrues në nivel rajoni, Shqipërisë do t'i duhet të hartojë një plan veprimi shumë vjeçar të menduar mirë dhe me koston përkatëse, i cili do u jap mundësi autoriteteve të portit të konkurrojnë për fondet e kufizuara buxhetore si dhe të përfitojnë nga partneritetet publike/private.

38. **Së fundmi, hapat e ndërmarrë për uljen e kostove të transaksioneve tregtare për firmat tregtare shërbejnë për t'i bërë produktet e eksportit më konkurruese dhe investimet e huaja direkte më tërheqëse.** Disa masa specifike për forcimin e logjistikës tregtare mund të jenë (i) rritja e numrit të licencave për transportin në vendet e BE; (ii) përmirësimi i kushteve për përpunimin e ngarkesave të përziera; dhe (iii) futjen e teknikave për menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, me një konkurrencë që nuk ka objektiv vetëm çmimin. Për sa i përket lehtësimit të tregtisë, ndërkohë që aspekte të tilla si koha mesatare e zhdoganimit të mallrave janë përmirësuar shumë (koha e zhdoganimit është reduktuar në një apo dy ditë), një ulje e mëtejshme e kohës do të kërkonte (i) kalimin në sistemin elektronik të të gjitha dokumenteve; (ii) zbatimin e analizës efektive të rrezikut në mënyrë që të kontrollohet vetëm një sasi e vogël mallrash; dhe (iii) rritjen e përgjegjësisë të importuesve për deklarimin e saktë të mallrave.

Institucionet Publike dhe Qeverisja në lidhje me Investimet

39. **Zhvillimi i ekonomisë Shqiptare është mbështetur nga një program i rëndësishëm reformash strukturore.** Gjatë 10 viteve të fundit Shqipëria ka pasur një qeverisje të përgjithshme më të mirë, ulje të korrupsionit dhe një mjedis biznesi të përmirësuar ndjeshëm. Për shembull, midis 2007 dhe 2009, pozicioni i Shqipërisë në listën e të Bërit Biznes (Doing Business) u përmirësua nga vendi 136 (nga 178 gjithsej) në vendin e 82. Ky është pasqyrim i programeve të qeverisë të cilat kanë pasur sukses në përmirësimin e cilësisë së institucioneve dhe klimës së investimeve. Shembuj të këtyre masave të rëndësishme përfshijnë futjen e taksës së sheshtë prej 10 përqind për bizneset dhe individët, përmirësimin e procesit të regjistrimit të tokës dhe konsolidimin në një institucion të vetëm të regjistrimit të bizneseve.

40. **Por sigurisht ka ende shumë vend për përmirësim.** Shqipëria ende është disi mbrapa vendeve të tjera Evropiane në lidhje me qeverisjen e përgjithshme (e matur nga Treguesit e Qeverisjes Mbarëbotërore (WGI) për efektivitetin e qeverisë dhe forcën e ligjit) me gjithë përmirësimet e vazhdueshme të bëra gjatë pesë viteve të fundit (nga 2004 deri në 2009, treguesit e qeverisjes së Shqipërisë u përmirësuan në të gjashtë fushat e WGI). Ndryshimi i kësaj situatë është tashmë një nga prioritetet kryesore të Shqipërisë, si për axhendën e rritjes ekonomike afatgjatë edhe për integrimin me sukses në BE.

41. **Një nga problemet kryesore për firmat është niveli i respektimit dhe i zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese.** Shqipëria ka bërë përpjekje të konsiderueshme në përmirësimin e klimës së investimeve nëpërmjet miratimit të një numri të madh ligjesh dhe rregulloresh (në përputhje me kërkesat për hyrjen në BE). Megjithatë, aty ku ligjet nuk janë të plota (mungojnë rregulloret e zbatimit) apo nuk përputhen me njëri-tjetrin, ekziston mundësia e krijimit të një hendeku midis strukturave formale dhe praktikave aktuale të zbatimit të cilat tentojnë të cenojnë forcën e ligjit dhe të rrisin pasigurinë për bizneset. Për shembull, pavarësisht se Shqipëria ka ngjitur disa shkallë në renditjen e të Bërit Biznes, vlerësimi i WGI në lidhje me efektivitetin e qeverisë e vendos Shqipërinë më poshtë se ç'pritet për një vend me nivelin e tij të të ardhurave. Në të vërtetë, e rëndësishme për investitorët është ajo çfarë ndodh në praktikë.

42. **Gjithashtu, nevojitet qartësi edhe në proceset e miratimit të ligjeve dhe rregulloreve të reja dhe në rishikimin e efikasitetit të atyre ekzistuese.** Kjo mund të arrihet nëpërmjet rritjes së rolit të Task Forcës së Reformës Rregullatore, e cila ka mandat për formulimin dhe monitorimin e planeve të reformave rregullatore, dhe duke i caktuar asaj një strukturë të përhershme nën përgjegjësinë direkte të Kryeministrit. Mbetet i rëndësishëm përfundimi i reformës së inspektimit dhe krijimi i një sistemi plotësisht funksional të Analizës së Impaktit Rregullator (AIR). Gjithashtu, mund të jetë i nevojshëm shqyrtimi i procesit nëpërmjet të cilit vendimet politike merren dhe përkthehen në ligj, pasi kjo do të ndihmonte për të planifikuar dhe siguruar kohën dhe burimet e nevojshme përpara se legjislativi i ri të hyjë në fuqi.


43. **Për të përmirësuar transparencën dhe parashikueshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve të Shqipërisë, mund të konsiderohen dy masa.** Së pari, mund të krijohet një **mekanizëm formal për konsultime periodike** midis sektorit privat dhe qeverisë në lidhje me të gjitha masat e rëndësishme që prekin bizneset. Për këtë do të ndihmonte ekzistenca e një kushti ligjor për publikimin e një përmbledhjeje të çështjeve të ngritura nga sektori privat dhe sesi këto çështje do të trajtohen përpara miratimit të legjislativin e ri. Një mekanizëm i tillë do të shërbente për ndërgjegjësimin e zyrtarëve rreth problemeve të mundshme me legjislativin e ri. Si masë e dytë për të mbështetur procesin mund të ishte krijimi i një **gjykate të apelit administrativ**. Kjo do të jepte siguri individëve dhe firmave që ata i kanë mjetet për të apeluar ndaj vendimeve zyrtare kur këto duket se bien ndesh me ligjet dhe rregulloret ekzistuese. Sigurisht, respektimi i procesit të konsultimeve dhe vendimeve të gjykatës administrative të apelit janë thelbësore për efektivitetin e këtyre masave.

KAPITULLI 1: PERFORMANCA MAKROEKONOMIKE, KRIZA GLOBALE DHE MË PAS

I. HYRJE

1.1 Gjatë 10 viteve të fundit, Shqipëria ka arritur një progres ekonomik të dukshëm duke lënë pas me rritjen e saj ekonomike të gjitha vendet e tjera Evropiane në tranzicion. Që prej 1998, ekonomia Shqiptare është rritur mesatarisht me 6 përqind në vit duke kaluar nga një vend me të ardhura të ulëta në një vend me të ardhura të mesme sipërore. Për pasojë, të ardhurat për frymë u rritën në \$3950 në 2010, një rritje më e shpejtë se në çdo shtet tjetër të Evropës Qendrore dhe Juglindore (Figure 1.1). Kjo rritje ekziston pavarësisht ngadalësimit të ritmit për shkak të krizës ekonomike globale. Megjithatë, në rang rajonal niveli i të ardhurave të Shqipërisë mbetet i ulët; në 2009, PBB e saj për frymë ishte vetëm 27 përqind i mesatares së BE në terma të fuqisë blerëse. Për rrjedhojë, këto nivele të larta të rritjes ekonomike duhet të ruhen për shumë dekada për të arritur nivelin e të ardhurave të BE.

Figura 1.1: Performanca Ekonomike e Ekonomive të Evropës Qendrore dhe Juglindore



1.2 **Bumi ekonomik i 10 viteve të shkuara erdhi prej transformimit të ekonomisë Shqiptare si pasojë e zhvendosjes së fuqisë punëtore nga sektorët me produktivitet të ulët tek ata me produktivitet më të lartë.** Në Memorandumin e mëparshëm Ekonomik të Vëndit (Banka Botërore, 2005) u vu në dukje se rritja ekonomike ka ardhur kryesisht si rezultat i transformimit strukturor nëpërmjet të cilit u krijuan vende të reja pune në sektorët e prodhimit dhe të shërbimeve ndërsa roli i bujqësisë erdhi duke u zbehur. Kjo është ende e vërtetë dhe për rritjen ekonomike të pesë viteve të fundit. Nisur nga përvoja e ekonomive të tjera me rritje të shpejtë ekonomike në botë, një transformim i tillë sektorial me ndikim mbi rritjen ekonomike zgjat për një periudhë të kufizuar. Megjithëse potenciali rritës i këtij burimi ende nuk ka shteruar, konvergjenca në nivelet e të ardhurave Evropiane duhet të vijë nëpërmjet përmirësimeve në produktivitetin brenda sektorit dhe nga akumulimi i kapitalit.

1.3 **Transformimi i suksesshëm ekonomik është mbështetur nga politikat e qëndrueshme makroekonomike dhe reformat strukturore.** Rritja ekonomike është përforcuar nga kuadri i shëndoshë makroekonomik së bashku me përmirësimet e dukshme të mjedisit të biznesit, të energjisë, të sektorit financiar, të administrimit tatimor dhe të menaxhimit të financave publike. Pa dyshim që këto politika, në kombinim me një përshpejtim të investimeve publike në 2008 dhe 2009, shërbyen për zbutjen e ndikimit të krizës ekonomike (Tabela 1.1). Ndërkohë mbetet e paqartë se sa do të zgjasë periudha e rigjenerimit nga kriza botërore, dhe ka një konsensus të gjerë se rikthimi në nivelet e rritjes ekonomike të para krizës do të kërkojë përpjekje shtesë. Shqetësim për Shqipërinë përbëjnë

veçanërisht zhvillimet në ekonominë e disa prej importuesve kryesorë të mallrave Shqiptare dhe të vendeve burim kryesor i remitançave të punëtorëve. Këto zhvillime të jashtme e kanë bërë më të vështirë detyrën e ruajtjes së rritjes së lartë ekonomike për vendim-marrësit Shqiptarë, dhe do të nevojiten përpjekje shtesë për të garantuar një kuadër të qëndrueshëm makroekonomik dhe për të mbështetur më tej investimet dhe rritjen ekonomike.

Tabela 1.1: Treguesit Kryesorë Makroekonomikë
(në përqindje ndaj PBB, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Rritja reale e PBB	2.9	5.7	5.9	5.5	5.0	6.0	7.5	2.5
Inflacioni IÇK (mesatarja vjetore)	5.2	2.4	2.9	2.4	2.6	2.9	3.4	2.2
Norma e interesit të huave (nominale, e.o.p.)	16	10.5	13.7	12.2	11.1	13.6	11.1	12
Norma e interesit të depozitave (nominale, e.o.p.)	9.3	7.6	6.0	5.6	5.5	6.3	6.9	6.8
Niveli i papunësisë (mesatarja vjetore.)	15.8	15	14.4	14.2	13.8	13.5	12.8	12.8
Kursimet bruto	17.4	17.9	20	17.1	23.3	21.3	19.1	16.7
Publike	0	-0.1	0.1	1.2	4.2	2.9	3.4	1.8
Private	17.4	18	19.9	15.9	19.1	18.4	15.7	14.9
Investimet bruto	24.5	23.4	23.8	23.6	29.3	29.9	32.5	29.5
Të ardhurat totale dhe grantet	24.7	24.5	24.1	24.4	25.3	25.6	27.1	26.1
Shpenzimet dhe huadhënia neto totale	31.4	29	29.2	27.4	28.5	29.1	32.7	33
o/ë Pagesat e interesit	4.0	4.4	3.7	3.1	2.8	2.6	2.9	..
Bilanci i përgjithshëm fiskal	-6.6	-4.5	-5.1	-3.4	-3.2	-3.5	-5.6	-6.9
Borxhi publik dhe ai i garantuar publikisht	65	61.8	56.5	54.5	56	53.2	55	59.8
I brendshëm	41.7	41.1	38.5	37.9	39.1	37.7	36.5	35.6
I jashtëm	23.3	20.7	18.0	16.6	16.9	15.5	18.4	24.3
Eksportet	20.5	20.8	21.5	22.3	25.1	27.7	29.7	28.4
Importet	46.3	45.9	43.3	46.3	49.3	54.1	56.7	53.9
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	-9.1	-6.7	-4.8	-7.2	-7.3	-11.2	-15.1	-15.6
Investimet e Huaja Direkte, neto	3.0	3.2	4.6	3.3	3.6	6.0	6.7	8.2
Remitançat e punëtorëve	13	14.4	13.7	13.7	14.1	13.5	10.9	10.8
Paraja e gjerë	65.3	65	65.7	68.5	74.6	77.3	76.1	77.5
Kredia për sektorin privat	6.4	7.7	9.4	14.9	21.8	28.9	35	37.4
Në monedhë lokale	1.5	1.6	2.0	3.6	6.6	8	9.7	11.9
Në monedhë të huaj	4.9	6.1	7.3	10.9	15.1	20.9	25.3	25.7
Rritja e kredisë për sektorin privat	41	31	37	74.9	57.6	48.5	32.4	12.1

Shënim: shifrat sektorit reale për 2009 janë vlerësime paraprake të stafit


Burimet: të dhëna nga INSTAT, Ministria e Financës, Banka e Shqipërisë, Banka Botërore dhe FMN.

II. PERFORMANCA EKONOMIKE E SHQIPËRISË E KOHËVE TË FUNDIT

1.4 **Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, Shqipëria ka përjetuar rritje të fuqishme ekonomike si rezultat i zhvendosjes së burimeve nga sektori i bujqësisë në ato të shërbimeve dhe ndërtimit.** Ndërtimi dhe shërbimet kanë qenë kontribuesit kryesorë në rritjen ekonomike, dhe aktualisht ata përfaqësojnë më shumë se 60 përqind të PBB-së (Figura 1.2). Zgjerimi i këtyre sektorëve është nxitur

nga kërkesa e lartë e brendshme e mbështetur nga rritja e produktivitetit, remitancat e punëtorëve dhe prurjeve të tjera (Banka Botërore, CEM, 2005). Industria ka ruajtur pjesën e saj në PBB-së me rreth 9 përqind, fillimisht si rezultat i rritjes së prodhimit të tekstileve dhe këpucëve dhe më së fundi për shkak të zgjerimit të materialeve të ndërtimit (kryesisht prodhimit të çimentos). Brenda një dekade pjesa e bujqësisë në PBB është përgjysmuar, megjithëse në terma rajonalë mbetet ende e lartë.

Figura 1.2: Përbërja e PBB-së % (figura në të majtë) dhe Punësimi sipas Sektorëve % (figura në të djathtë)



Burimi: INSTAT.

1.5 Zhvendosja e vazhdueshme e fuqisë punëtore nga bujqësia drejt sektorëve të tjerë si shërbimet dhe industria ka rritur produktivitetin e përgjithshëm. Pjesa e popullsisë që merret me bujqësi ka pësuar një rënie në 45 përqind në 2008 sipas Anketës të Fuqisë Punëtore (SFP), të prezantuar së fundmi, krahasuar me 58 përqind që ishte në vitin 2001 (të dhëna nga i regjistrimit i përgjithshëm; shiko Kutinë 1.1).² Në sektorin e bujqësisë, rreth 70 përqind e prodhimit është përdorur për jetesë³ dhe vlera e shtuar për person ka qenë më pak se një e pesta e asaj të sektorëve të tjerë.⁴ Për rrjedhojë, zhvendosja drejt sektorëve të tjerë nënkupton rritje të numrit të vendeve të punës në sektorët me produktivitet më të lartë. Megjithatë, sektori i bujqësisë mbetet dominues, duke zënë 18 përqind të PBB dhe rreth 40 përqind të punësimit, çka do të thotë se ka ende mundësi për rritjen e produktivitetit të përgjithshëm dhe prodhimit përmes stimuljeve në bujqësi dhe lehtësimin e lëvizjes së vazhdueshme të fuqisë punëtore ndërmjet sektorëve.

Kutia 1.1: Popullsia, Fuqia Punëtore dhe Emigrimi

Popullsia e Shqipërisë nuk ka pësuar rritje të ndjeshme gjatë këtyre 20 viteve të fundit pavarësisht niveleve të larta të fertilitetit. Nga viti 1989 deri në vitin 2008, rritja natyrore e popullsisë duket se ka qëndruar në vend për shkak të emigrimit. Rrjedh se rreth 1 milion Shqiptarë jetojnë aktualisht jashtë vendit. Deri në vitin 2000, pati një rënie të lehtë të numrit të popullsisë, por niveli i emigrimit është ngadalësuar mjaftueshëm për të pasur një rritje të vogël në numrin e popullsisë me rreth 3.2 milion njerëz (niveli i vitit 1989). Humbja e aftësive të vendit nga emigrimi ka qenë e konsiderueshme. 47 përqind e emigrantëve të përhershëm gjatë viteve 1990-2002, kishin arsim të mesëm ose të lartë, krahasuar me 31 përqind të popullsisë jo-emigruese.

Menjëherë pas tranzicionit dhe me rënien e thellë ekonomike, për shumicën e njerëzve emigrimi shihej si mundësi mbijetese dhe si strategji për zbutjen e rrezikut (shiko për shembull Miluka & Dabalen, 2008 Carletto

² Për fat të keq për vitet e ndërmjetme nuk ka të dhëna të besueshme. Ecuria e të dhënave në SFP mbështetet edhe nga ato të Studimit për Matjen e Standarteve të Jetesës (LSMS) të cilat tregojnë shifrat në rënie të punësimit në bujqësi gjatë periudhës 2002-2008.

³ Shiko Banka Botërore, 2007.


⁴ Të gjitha këto shifra duhet të merren si tregues pasi shifrat për punësimin në bujqësi nuk janë të sakta

& Kilic, 2008 Vullnetari, 2007). Më tej, mungesa në këtë fazë të hershme e aftësive organizative dhe sipërmarrëse për krijimin e vendeve të punës për personat me arsim të mesëm apo të lartë i nxiti këta të fundit drejt emigrimit. Konsolidimi i rrjeteve jashtë vendit përmirësoi dukshëm informacionin rreth mundësive relative në vende të tjera, duke bërë të mundur në këtë mënyrë reduktimin e rreziqeve dhe kostove të emigrimit. Në të njëjtën kohë, mundësia për emigrim zbehu stimujt për vazhdimin e shkollës. Megjithatë, pavarësisht shkollës së lartë të emigrimit, nivelet e papunësisë janë ende në vlera dyshifrore (12.8 përqind në 2008).

1.6 Rritja e fuqishme ekonomike u mbështetet nga një rritje e qëndrueshme e investimeve.


Investimet totale bruto janë rritur nga 24.6 përqind e PBB në 2000 në 29.5 përqind në 2009, dhe investimet private nga 18 në 21.4 përqind gjatë së njëjtës periudhë (Figura 1.3). Këto nivele të investimeve agregate përfaqësojnë një arritje të konsiderueshme në përputhje me rekomandimet e raportit të Komisionit për Rritjen Ekonomike (Banka Botërore, 2008) i cili konstatoi se të gjitha ekonomitë me rritje të lartë ekonomike në gjysmën e dytë të shekullit kanë pasur investime mbi 25 përqind të PBB⁵. Megjithatë, në Shqipëri deri në vitin 2006, struktura e investimeve anonte nga sektori i ndërtimit, dhe vetëm rreth 10 përqind e PBB shkonte për investime në sektorin e prodhimit. Që atëherë, investimet në fusha të tjera jo-ndërtim janë rritur, megjithatë pjesa e investimeve në ndërtim mbetet e lartë. Me ngadalësimin e kërkesës për ndërtime banesash, ekziston një potencial i madh që disa nga kursimet që shkojnë aktualisht në ndërtim të drejtohen për në fusha të tjera të prodhimit (Figura 1.4). Në fakt, kthimi i Shqipërisë në nivelet e larta të rritje së qëndrueshme ekonomike lidhet ngushtësisht me rritjen e investimeve në aktivitetet jo ndërtuese.

Figura 1.3: Kursime dhe Investime (% e PBB)



Burimi: Të dhëna nga INSTAT, Banka Botërore dhe FMN.

Figura 1.4: Kursimet e Brendshme vs. atyre Kombëtare (% e PBB)



Burimi: Të dhëna nga INSTAT, Banka Botërore dhe FMN.

Rritja Ekonomike dhe Ulja e Varfërisë

1.7 Si rezultat i rritjes ekonomike të qëndrueshme, varfëria ka rënë ndjeshëm në Shqipëri.

Niveli i përgjithshëm i varfërisë absolute⁶ ra nga 25.4 përqind në 2002 në 18.5 përqind në 2005 dhe në 12.4 përqind në 2008. Kjo do të thotë se afërsisht 200,000 nga 575,000 të varfër që ishin në 2005 dolën nga varfëria në 2008, dhe ky numër mund të jetë edhe më i lartë në vitin 2010 pasi ekonomia ka vazhduar të rritet. Numri i personave në varfëri ekstreme, ku hyjnë ata që kanë vështirësi në plotësimin e nevojave më elementare të ushqimit, ra nga 5 përqind në 2002 në 3.5 përqind në 2005 dhe në 1.2 përqind në 2008. Kjo ulje është më e theksuar se në shumë vende të tjera në tranzicion apo me të ardhura të mesme.

⁵ <http://www.growthcommission.org>.

⁶ Fraksioni i popullsisë, konsumi real për frymë i të cilëve është nën 4891 Lek me çmimet e vitit 2002.


Tabela 1.2: Nivelet e Uljes së Varfërisë në Zonat Rurale dhe Urbane

Varfëria sipas zonës Rurale/Urbane	Ndryshimi në Varfëri				
	2002	2005	2008	% ndryshim 2002-2005	% ndryshim 2005-2008
Numri total i popullsisë në varfëri	813,196	575,659	373,137	-29	-35
Urbane	257,690	151,811	150,052	-41	-1
Rurale	555,506	423,848	223,085	-24	-47

Burimi: LSMS, 2002 2005 dhe 2008

1.8 **Reduktimi i varfërisë në zonat rurale ka qenë i konsiderueshëm.** Tabela 1.2 tregon se varfëria në zonat rurale ka rënë me rreth 47 përqind, që në nivel të përgjithshëm do të thotë se ajo ka rënë nga 24.2 përqind në 2005 në 14.6 përqind në 2008. Ulja ka ardhur si rezultat i kombinimit të flukseve të remitancave drejt zonave rurale dhe zhvendosjes të punësimit nga sektori i bujqësisë në punë më të mirëpajuar në sektorë të tjerë. Krahasuar me vitin 2002, kur varfëria ishte prezent në të gjithë vendin (me përjashtim të jugut), në vitin 2008 niveli i varfërisë ishte i lartë vetëm në disa rrethe në kufirin lindor.


Figura 1.5: Raporti i Varfërisë së Përgjithshme sipas Rretheve në përqindje 2002 2008



Politika Fiskale dhe Monetare – Shtyllat e Stabilitetit Makroekonomik


1.9 **Politikat e shëndosha fiskale dhe monetare kanë qenë shtyllat kryesore të stabilitetit makroekonomik.** Konsolidimi gradual fiskal u bazua në një kombinim të përmirësimit të administrimit të të ardhurave dhe uljes së shpenzimeve të interesave të borxhit. Si rezultat, duke pasur parasysh dhe rritjen e forte të PBB, borxhi publik ra nga 62 në 53 përqind të PBB midis viteve 2003 dhe 2007. Megjithatë, kjo prirje rënëse ndryshoi në 2008 me rritjen e investimeve publike (Figura 1.6 dhe 1.7). Në një pjesë të madhe kjo lidhej me rrugën Durrës-Kukës, vepra më e madhe e investimeve publike e ndërmarrë gjatë periudhës së tranzicionit. Sfidat për Shqipërinë është kthimi drejt një situatë fiskale të kujdesshme në përputhje me uljen graduale në nivelet e borxhit publik.

Figura 1.6: Bilanci Fiskal (% e PBB)



Burimi: Ministria e Financës.


Figura 1.7: Të ardhurat Fiskale dhe Shpenzimet (% e PBB)



Burimi: Ministria e Financës.

1.10 Politika monetare ka kontribuar me sukses duke mbajtur inflacionin në nivele të ulëta. Pas viteve të trazuara '90, inflacioni u mbajt përgjithësisht brenda objektivit të bankës qendrore prej 2-4 përqind në vit. Regjimi fleksibël i kursit të këmbimit ka rezultuar të jetë një zbutës i mirë goditjesh. Megjithëse Shqipëria fillimisht zbatoi një regjim të targetimit agregat monetar, në praktikë vendimet mbi ndryshimin e qëndrimit të politikës monetare janë marrë në bazë të një game më të gjerë informacioni përveç M3, si: presionet e ardhura si pasojë e luhatjeve në kursin e këmbimit, ndryshimet e çmimeve në tregje të ndryshme, si dhe presionet e kërkesës. Ky kuadër tashmë ngjason me atë të regjimit të targetimit të inflacionit të cilin Banka e Shqipërisë (BSh) synon ta adoptojë në mënyrë formale në të ardhmen.

Figura 1.8: Kreditë për Sektorin Privat dhe Depozitat (% e PBB)



Burimi: Banka e Shqipërisë; Shiritat – Kreditë për sektorin privat, pjesa e poshtme e shiritave është kredia në monedhë të huaj; Vija – Depozitat.

1.11 Politikat e kujdesshme fiskale dhe monetare mundësuan rritjen e shpejtë të sektorit bankar. Privatizimi i bankës më të madhe (Bankës së Kursimeve) i dha shtysë një sërë ndryshimesh pozitive në këtë sektor. Ritmi i thellimit financiar ishte i jashtëzakonshëm: kreditë si raport ndaj PBB u rritën nga 4.7 përqind në vitin 2001 në 37 përqind në 2009 (Figura 1.8) megjithëse kreditë vazhdojnë të jenë të përqendruara në kompanitë e mëdha.

1.12 Reformat strukturore ishin po aq të rëndësishme në zhvillimin e sektorit bankar. Kredia konsumatore dhe tregu i kredive hipotekare janë zgjeruar, por jo jashtë mase. Përfaqja konservatore e mbikëqyrjes e adoptuar pas rënies së skemave piramidale ka dhënë frytet e saj. Me gjithë rritjen e kohëve të fundit të huave të këqija si rezultat i shtrëngimit të situatës ekonomike ndërkombëtare dhe në vend, sistemi financiar mbetet i shëndoshë dhe ka provuar se është rezistent edhe ndaj një stresi më të madh.

1.13 Pavarësisht periudhës së gjatë të stabilitetit makroekonomik, niveli i eurozimit/dollarizimit mbetet i lartë duke zvogëluar hapësirën e manovrimit të politikave. Ndryshimet në perceptimet dhe preferencat mes agjentëve ekonomik shpesh ndodhin me vonesa të gjata kohore, gjë që ka ndodhur dhe në rastin e Shqipërisë. Ndaj, me gjithë inflacionin e ulët, pjesa e huave në monedhë të huaj (FX) mbetet mbi 70 përqind, gjë që mund të pengojë përshtatjen e

mundshme të kursit të këmbimit, në varësi të shkallës së mospërputhjes midis aseteve dhe detyrimeve të monedhë të huaj. Për fat të keq, statistikak në lidhje me shkallën e saktë të mospërputhjeve në monedhë të bilanceve të debitorëve janë shumë të kufizuara.⁷ Sipas BSH, kredia për sektorin e shërbimeve përbën më shumë se 50 përqind të numrit total të kredive, e ndjekur nga ndërtimi me 20 përqind. Fondet në monedhë të huaj janë burim i rëndësishëm financimi për ndërtimin dhe disa sektorë shërbimesh (si p.sh. pikat turistike), megjithëse të ardhurat në monedhën vendase nuk janë të papërfillshme (Luci etj, 2006).

Sektori i Tregtisë nuk është Ende një Faktor Kryesor në Rritjen Ekonomike

1.14 **Deri tani, eksportet nuk kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike, por financimi i deficitit të lartë tregtar nuk ka qenë problem.** Që nga viti 1998, eksportet e mallrave dhe shërbimeve janë rritur nga 10 përqind në 30 përqind të PBB, ku eksportet e prodhuara (kryesisht tekstilet dhe këpucët) kanë pasur rritjen më të shpejtë.⁸ Megjithatë, eksportet neto të Shqipërisë nuk janë përmirësuar shumë pasi rritja e eksporteve është shoqëruar dhe me rritjen e importeve (Tabela 1.3). Deficiti tregtar ka qëndruar mbi 20 përqind të PBB. Pothuajse gjysma e tij është mbuluar nga remitanca. IHD, me përjashtim të të ardhurave nga privatizimet, kanë qenë modeste, duke financuar mesatarisht vetëm një të pestën e deficitit tregtar. Prurjet e tjera kapitale, shumica nga burime të paidentifikuara, të cilat mund të përfshijnë remitanca të paregjistruara, mbulojnë një të tretën e deficitit të llogarisë rrjedhëse kurse pjesa e mbetur është financuar kryesisht nga huatë koncesionare.

Tabela 1.3: Shqipëria – Bilanci i Pagesave (% i PBB)

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Llogaria rrjedhëse	-4.7	-6.9	-9.1	-6.7	-4.8	-7.2	-7.3	-11.2	-15.4	-15.6
Bilanci tregtar	-21.7	-22.8	-26.2	-25.3	-21.8	-23.8	-24.0	-27.2	-27.0	-25.6
Mallra	-22.2	-25.0	-26.0	-23.8	-21.1	-21.7	-23.1	-27.2	-27.8	-27.1
Shërbime	0.5	2.2	-0.1	-1.5	-0.7	-2.1	-0.9	0.0	0.8	1.4
Remitanca	11.7	11.9	13.3	14.4	13.7	13.7	14.1	13.5	10.3	10.7
Llogaria kapitale	4.8	3.4	7.4	6.4	7.0	6.5	7.6	10.7	12.7	13.1
IHD	3.9	5.0	3.0	3.2	4.6	3.3	3.5	5.9	8.0	8.2
Kapitale të tjera	1.4	-1.1	2.0	1.5	1.1	2.4	3.2	3.9	0.6	-0.1
Hua	-0.5	-0.6	2.3	1.7	1.3	0.7	0.8	0.8	-0.9	5.0

Burimi: Banka e Shqipërisë. Shënim: Të dhëna paraprake 2009.

III. KRIZA DHE SFIDAT E REJA

1.15 **Shqipëria ka qenë e suksesshme në menaxhimin e impaktit fillestar të krizës ekonomike globale dhe është një ndër vendet e pakta në Evropë që arriti të ruajë një nivel pozitiv të rritjes ekonomike.** Mbështetja e kufizuar e sektorit publik dhe privat në financime të huaja ka eliminuar nevojën për një përshtatje të fortë ndaj ngrirjes së menjëhershme të tregjeve financiare ndërkombëtare. Periudha e gjatë e stabilitetit financiar dhe makroekonomik i ndihmoi autoritetet të ruajnë besimin e publikut duke lehtësuar ndërkohë situatën e likuiditeteve. Gjithashtu, politika fiskale ekspansioniste e dy viteve të fundit e cila konsiston në investime më të mëdha publike si dhe rritja e rrogave dhe pensione, ka lehtësuar rënien e konsumit.⁹

⁷ Shiko për shembull Luci, Muco, dhe Sojli, 2006, të cilët vlerësojnë se mospërputhja e përgjithshme në monedhë e kompanive Shqiptare mund të kapi 41 përqind e aseteve të tyre.


⁸ Në 2008, tekstilet dhe këpucët përbënin 43.3 përqind të eksporteve totale dhe mbi 60 përqind të eksporteve të prodhuara.

⁹ Megjithëse me sa duket pjesa e shpenzimeve të personelit në llogaritë fiskale është zvogëluar nga 6.2 në 5.5 përqind të PBB, kjo i atribuohet kryesisht reformës në sistemin financiar të shëndetsisë sipas të cilit shpenzimet e personelit nuk veçohen dhe nuk klasifikohen në të njëjtën kategori si më parë. Pra, shpenzimet për sigurimin shëndetsor janë rritur nga 1 në 2 përqind të PBB.

1.16 **Megjithatë, recesioni ekonomik në vendet e tjera dhe situata e pasigurt për daljen nga kriza, ndikojnë në disa aspekte edhe perspektivën ekonomike afatmesme të Shqipërisë.** Ekonomia e Shqipërisë ndikohet nga ekonomitë e vendeve të BE, në veçanti ato të Greqisë dhe Italisë, nëpërmjet dy kanaleve me efekte të drejtpërdrejta: (i) remitancat; dhe (ii) mallrat e tregtueshme, si në sasi dhe në çmime.

1.17 **Remitancat nga emigrantët Shqiptarë varen nga performanca ekonomike e vendeve të BE.** Në vitin 2009, prurjet ranë me 3 pikë përqind të PBB krahasuar me 2007 (shiko tabelën më sipër). Në anën tjetër remitancat janë një faktor shtytës kritik për kërkesën e brendshme të Shqipërisë. Vlerësimet ekonometrike sugjerojnë se për ekonominë (duke përjashtuar bujqësinë) një rënie prej 10 përqind në remitancat do të çonte në një ulje prej 3.6 përqind në kërkesën e brendshme, e përafëruar me indeksin e shitjeve.¹⁰ Sektorët më të prekur nga remitancat janë ndërtimi, shërbimet dhe ushqimet, të cilët janë edhe kontribuesit kryesorë në PBB e Shqipërisë. Mendohet se turrja e madhe në ndërtim ka ardhur pjesërisht si rezultat i rënies së prurjeve nga emigrantët që punojnë jashtë vendit.

Figura 1.9: Normat e Rritjes së Tendencës së Prodhimit



— Shqipëri (boshti majtas), —Itali, —Gjermani (Ifo) (Boshti djatas dhe t-2)

Burime: Banka e Shqipërisë, Instituti IFO (Gjermani), si dhe Instituti për Studime dhe Analiza Ekonomike (Itali)

1.18 **Gjithashtu, performanca e vendeve të BE ndikon mbi Shqipërinë edhe nëpërmjet sektorëve të tregtueshëm.** Lidhjet e industrive përpunuese dhe ndërtimit në Shqipëri duket të jenë veçanërisht të forta me ekonomitë e vendeve të BE. Elasticiteti i reagimit të industrisë ndaj niveleve të rritjes ekonomike të BE është 4 ndërsa ndërtimi ka një elasticitet prej afro 8. Rëndësia e këtyre lidhjeve është gjithashtu e dukshme po të përdoren indekset e besimit të bizneseve. Tendanca për prodhimin e Italisë ka një lidhje të forte me indeksin e besimit të prodhimit të Shqipërisë me një vonesë 6 mujore (Figura 1.9). E njëjta gjë evidentohet edhe për shërbimet.

1.19 **Vendet Evropiane kaluan një periudhë recesioni të rëndë dhe rigjenerimi mund të jetë i ngadaltë.** BE-ja është tregu më i rëndësishëm për eksportet e Shqipërisë kështu që recesioni në Evropë pati pasojë serioze për eksportuesit Shqiptar. Për shembull, deri në fillim të vitit 2008, industritë nxjerrëse karakterizoheshin nga një valë e madhe eksportesh, por rënia e kërkesës së jashtme dhe rënia e çmimeve në fillim të krizës shkaktoi një turrje të madhe si në prodhim dhe në punësimin (ndërkohë që rikuperimi i kohëve të fundit është premtues).

IV. REAGIMI I POLITIKAVE NDAJ KRIZËS

1.20 **Për zbutjen e efekteve negative të krizës financiare, në shumë vende është rekomanduar stimuli fiskal.** Për vende si Shqipëria, përshtatshmëria dhe madhësia e stimilit fiskal duhet të vlerësohen duke marrë parasysh katër faktorë: (i) rrezikun e vështirësisë të sektorit financiar; (ii) shkallën dhe shpërndarjen e turrjes së kërkesës së brendshme; (iii) efektshmërinë e stimilit fiskal;

¹⁰ Megjithëse pranohet se Indeksi i Shitjeve nuk është një tregues i përkryer i kërkesës (si dhe nuk përfshin bujqësinë), ai është i lidhur ngushtë me kërkesën agregate dhe përdoret në mungesë të një treguesi tjetër tremujor të kërkesës.

dhe (iv) hapësirën fiskale në dispozicion. Në të njëjtën kohë, politikat e stimullit fiskal duhet të jenë në përputhje me procesin e axhendës të reformave strukturore.

1.21 Fatmirësisht, Shqipëria nuk ndodhet në një pozicion që kërkon politika ekspansioniste të konsiderueshme si ato të aplikuara në shumë vende të Evropës. Gjatë krizës së fundit, Shqipëria nuk është përballur me rrezikun e një katastrofe financiare, që do të kërkonte një plan shpëtimi nga ana e qeverisë siç ndodhi në shumë pjesë të Evropës. Kjo qëndron akoma edhe më sot. Për më tepër, ka dhe arsye të tjera pse nuk duhet nxituar në krijimin e programeve të reja shpenzimesh për të pasur një ndikim afatshkurtër. Së pari, programet e zbatuara në mënyrë të shpejtë rrezikojnë të targetohen keq ndaj grupeve dhe sektorëve të cilët kanë vërtet nevojë për to, duke harxhuar në këtë mënyrë burimet. Së dyti, efektiviteti i një stimuli të gjerë fiskal do të cenohej nga rrjedhjet në importe, të cilat në rastin e Shqipërisë përfaqësojnë rreth gjysmën e PBB. Së treti, nëse nuk mbështetet nga financimet e jashtme, një politikë ekspansioniste fiskale mund të çojë në një zhvlerësim real të monedhës, në formën e çmimeve më të larta relative, apo një zhvlerësimi nominal (ose të dyja). Këto mbartin pasojat negative për sektorin financiar dhe të varfrit. Të gjithë këta faktorë nxjerrin në pah nevojën për vlerësim të kujdesshëm të të gjitha kostove dhe përfitimeve të çdo mase ekspansioniste fiskale.

1.22 Shqipëria mund të përballë edhe me kufizime më të mëdha të financimeve të huaja në të ardhmen, çka përforcon nevojën për menaxhim të kujdesshëm të fondeve publike. Përveç tkurrjes së përgjithshme të resurseve të disponueshme në të gjithë botën, ekzistojnë edhe disa faktorë specifik për Shqipërinë të cilët mund të paraqesin probleme për financime të mëtejshme të mëdha të huaja. Duke përjashtuar të ardhurat nga privatizimet, IHD në Shqipëri nuk kanë lëvizur shumë përtej kufirit 3 përqind të PBB. Në 2007 dhe 2008, ato arritën respektivisht në 4.5 dhe 5.5 përqind të PBB si rezultat i rritjes së kapitalit të disa bankave të huaja. Tërheqja e IHD në sektorë të tjerë përveç bankave dhe telekomunikacioneve, ka rezultuar e vështirë. Gjithashtu, mundësitë për privatizime po pakësohen. Për më tepër, zgjerimi i huamarrjes është i kufizuar për shkak të nivelit tashmë të lartë të borxhit dhe tavanit prej 60 përqind të PBB (të borxhit publik) të përcaktuar në ligjin organik të buxhetit të vitit 2008.

Rritja e Besueshmërisë të Politikave

1.23 Një nga mësimet më pozitive nga menaxhimi makroekonomik i Shqipërisë ka qenë rëndësia e ruajtjes së besueshmërisë. 10 vjeçari kaluar tregoi qartë se mbikëqyrja e kujdesshme bankare, politika monetare, dhe politika fiskale rrisin besimin e investitorëve e për rrjedhojë stimulojnë rritjen ekonomike. Për shumë vite deri në 2007, Shqipëria përfitoi nga një politikë e matur fiskale në bazë të së cilës u arrit reduktimi i deficitit, si dhe u vendos një objektiv për uljen e borxhit gjë i cili dha siguri për qëndrueshmërinë fiskale. Kjo politikë, e mbështetur dhe nga programet e FMN, kontribuoi në rritjen e përgjithshme të besueshmërisë duke mundësuar financime me kosto relativisht të ulët si dhe në një kurs të qëndrueshëm këmbimi.

1.24 Kuadri makroekonomik kërkon parashikime të besueshme në situatën e pas-krizës. Një buxhet i bazuar në ekstrapolim të prodhimit dhe të ardhurave prej prirjeve rritëse të viteve të mëparshme, rrezikon mbivlerësimin e të ardhurave nga tatimet e për rrjedhojë nënvlerësim të deficiteve buxhetore. Kjo do të shkaktonte çrregullim të programit të investimeve publike, rritjen e normës së interesit dhe ulje të fleksibilitetit të autoriteteve për menaxhimin e goditjeve të papritura. Për shembull, buxheti i propozuar fillimisht për vitin 2010 përmbante parashikime tejet optimiste të të ardhurave të cilat i tejkalonin të ardhurat faktike në pjesën e parë të 2010 me 20 përqind. Duke pranuar problemet e buxhetit fillestar për vitin 2010, rishikimi i mes-vitit të buxhetit nga ana e qeverisë bëri shumë ndryshime dhe kuadri fiskal u përshtat në ulje. Nëse supozimet fillestare do të kishin qenë më realiste, atëherë do të ishin evituar ndryshimet drastike të mes-vitit, duke ruajtur në këtë mënyrë besimin dhe sigurinë e ambientit ekonomik. Duke qenë se kriza globale ka ndikuar ndjeshëm preferencën e investitorëve të huaj ndaj rrezikut, parashikimet realiste marrin një rëndësi të veçantë.

1.25 **Ndaj, në të ardhmen, ruajtja e një kuadri të besueshëm makroekonomik mbetet thelbësore.** Në këtë aspekt, mund të zbatohet një rregull fiskal që të shërbejë si një spirancë për rritjen e efektivitetit dhe kredibilitetit të kuadrit buxhetor afatmesëm. Një rregull i tillë sinjalizon angazhim për një përqsaje të bazuar në rregulla në të gjitha sferat e politikës ekonomike. Megjithëse zbatimi i tij nuk do të sjellë përfitime të menjëhershme (p.sh. norma më të ulëta në huamarrje) pasi pritshmëritë e tregut duan kohë të ankorohen (siç ka qenë në Shqipëri rasti i politikës monetare), ai gjithsesi përbën një hap në drejtimin e duhur që sinjalizon angazhimin e Shqipërisë për ruajtjen e eksperiencës së mëparshme pozitive makroekonomike. Për të pasur peshën e duhur, ai duhet të shoqërohet dhe nga rritja e besimit të statistikave kombëtare, pasi këto përbëjnë bazën për monitorimin e çdo rregulli fiskal (Kutia 1.2).

Kutia 0.2: Roli i Statistikave për Besueshmërinë e Politikave

Statistikat e plota dhe në kohë janë thelbësore si për politikë-bërjen makroekonomike ashtu edhe për ruajtjen e besimit të vendimeve të politikave. Statistikat u shërbejnë agjentëve të ndryshëm në mënyra të ndryshme: politikë-bërësit kanë nevojë për to në mënyrë që të kuptojnë kur është e nevojshme për të vepruar dhe sa mund të ndikojnë, firmat vendase kanë nevojë për to në mënyrë që të ndjekin tendencat e tregut, ndërsa kompanitë e huaja kanë nevojë për to me qëllim që të jenë në gjendje për të marrë vendime për të investuar.

Shqipëria ka bërë progres të dukshëm në përmirësimin e statistikave të saj kombëtare. Publikimi së fundi i të dhënave tremujore të PBB, anketimit të fuqisë punëtore dhe zhvillimi i statistikave sociale janë arritje të mëdha të cilat kanë bërë që Shqipëri t'i afrohet nivelit të vendeve të tjera të rajonit. Disa nga fushat ku nevojitet progres i mëtejshëm janë llogaritë kombëtare në anën e shpenzimeve si dhe të dhëna më të detajuara të investimeve, veçanërisht në lidhje me përbërjen investimeve.

Ashtu siç doli në pah edhe gjatë krizës së fundit, besimi në saktësinë dhe afatet kohore të statistikave është me rëndësi kritike. Përvoja ndërkombëtare (Fellegi, 2004) tregon se disa nga masat të cilat ndikojnë në rritje të dukshme të besimit në statistikat kombëtare janë:

1. Garantimi i pavarësisë zyrtare të agjencisë së statistikave, përfshirë emërimet në bazë të meritave dhe një mandat të qartë për bërjen e të dhënave publike.
2. Publikimin sistematik të statistikave sipas afateve kohore të paracaktuara.
3. Publikimin e metodologjisë për llogaritjen e statistikave.

1.26 **Disa aspekte të rregullave fiskale janë përfshirë tashmë në ligj.** Aktualisht ekzistojnë kufizime për huamarrje nga banka qendrore, dhe kohët e fundit Ligji i ri Organik i Buxhetit të vitit 2008 përfshin një tavan për borxhin publik në raport me PBB prej 60 përqind (në përputhje me kriteret e Bashkimit Evropian dhe atij Monetar).¹¹ Por ende nuk ka një mekanizëm se si duhet korrigjuar prirja e borxhit publik përpara se të arrihet tavanit 60 përqind. Ndërkohë, Shqipëria ka bërë dhe një progres të mirë në vendosjen e një kuadri buxhetor me shtrirje tre vjeçare përmes Ligjit Organik të Buxhetit të 2008. Ky është një parakusht kryesor për adoptimin e suksesshëm të një rregulli fiskal efikas. Por për ta bërë atë efikas, duhet të merret në konsideratë përfshirja e tij në një ligj kushtetues siç është Ligji Organik i Buxhetit ose të paktën kthimi i tij në një komponent bazë dhe të përhershëm të Planit Buxhetor Afatmesëm. Shembuj të mundshëm të një rregulli fiskal janë treguar në Kutinë 1.3.

Kutia 1.3: Alternativat për Rregullin Fiskal

Në një dokument të kohëve të fundit i FMN, Jonas (2010) sugjeron dy alternativa të rregullave fiskale që mund të merren në konsideratë për Shqipërinë.

Rregulli i Borxhit

Mundësia e parë është zbatimi i një rregulli borxhi i cili konsiston në përcaktimin e deficiteve për të garantuar një normë rritjeje të borxhit nominal publik më të ulët se niveli i rritjes potenciale të PBB nominale.

¹¹ Neni 58 i Ligjit Nr. 9936, dt. 26.6.2008 “Mbi Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Shqipëri”.

$$\frac{\Delta D_{t+1}}{D_t} = \alpha \left(\frac{\Delta Y^p}{Y^p} \right) \text{ dhe } 0 < \alpha < 1$$

ku: D është borxhi nominal publik i matur në Lek, Y^p është PBB nominale e parashikuar ndërsa α përfaqëson shpejtësinë me të cilën autoritetet duan të reduktojnë përqindjen e borxhit në kohë. Në qoftë se α është e barabartë me 1 raporti i borxhit ndaj PBB duhet të mbetet i pandryshuar në të kundërt sa më afër 0 aq më i fortë rregullimi i borxhit në ulje.

Objektivi operativ me të cilin autoritetet do të kontrollojnë rritjen e dëshirueshme të borxhit është bilanci primar. Në praktikë, meqenëse normat e interesit janë deri diku më të parashikueshme dhe duke supozuar një kurs të qëndrueshëm këmbimi, kjo do të përkthehet në një objektiv deficiti nominal. Duke pasur parasysh nivelet relativisht të larta të rritjes në Shqipëri, në periudhë afatgjatë ky rregull nuk duhet të jetë shumë shtrëngues për sa i përket krijimit të borxhit të ri. Në të njëjtën kohë ai mundëson uljen e raportit të borxhit publik përkundërt PBB në nivele të krahasueshme me nivelet e ekonomive në zhvillim të cilat janë mesatarisht poshtë 50 përqind e PBB krahasuar me 60 përqind të Shqipërisë në këtë moment. Duke supozuar një skenar neutral të normave të interesit dhe kursit të këmbimit që qëndrojnë pandryshuar në nivelet aktuale, bilanci primar në përputhje me një koeficient të pandryshuar borxh ndaj PBB ($\alpha=1$) duhet të jetë rreth -1 përqind e PBB. Një reduktim i moderuar i borxhit publik ($\alpha=0.8$) rezulton në bilancin primar të barabartë me 0. Një reduktim më ambicioz i koeficienteve të borxhit do të kërkonte që qeveria të kishte bilance primare pozitive.

Rregulli i Shpenzimeve

Mundësia e dytë e propozuar është një rregull shpenzimesh i cili ngrin raportin e shpenzimeve totale ndaj PBB në një nivel të caktuar në vazhdimësi, së bashku me një mekanizëm korrigjimi për të rregulluar luhatjet e të ardhurave. Me fjalë të tjera, shpenzimet nominale do të rriteshin me të njëjtin ritëm si dhe PBB nominale potenciale.

$$\frac{\Delta G}{G} = \left(\frac{\Delta Y^p}{Y^p} \right)$$

Fiksimi i këtij raporti nuk është i mjaftueshëm për disiplinimin e deficiteve dhe borxhit nëse ai nuk shoqërohet dhe me një mekanizëm korrigjues që merr parasysh ndryshimet e të ardhurave përtej arsyeve ciklike. Prandaj, nëse koeficienti i borxhit shmanget nga objektivi, rritja e shpenzimeve mund të korrigjohet me një fraksion të nivelit të rritjes potenciale: $\beta(\Delta Y^p / Y^p)$ me $0 < \beta < 1$. Sipas përllogaritjeve të Jonas (2010), për të ulur raportin e borxhit ndaj PBB pa qenë i detyruar të korrigjohet niveli i rritjes së shpenzimeve ($\beta=1$) elasticiteti i të ardhurave ndaj rritjes së PBB do të duhet të rrinte gjithmonë mbi një, gjë që është e vështirë për shkak se përmirësimet në administrim dhe mbledhjen e taksave nuk janë të pafundme. Një tjetër problem i rregullit të shpenzimeve është zbatimi i tij kur shpenzimet kanë ndjeshmëri ciklike apo duhet të mbrohen nga ndryshimet e shpeshta. Në rast se reduktimi i borxhit është një objektiv i rëndësishëm, shkalla e mbulimit duhet të jetë e gjerë.

Duke qenë të lidhur me nivelet e mundshme të rritjes së PBB, të dy rregullat lejojnë që stabilizuesit automatikë të funksionojnë mirë. Gjithashtu, rregullat fiskale nuk përjashtojnë fleksibilitetin e rregullimeve kundërciklike nëse ata kanë arritur besueshmëri të mjaftueshme dhe ekziston një mekanizëm i para-shpallur për të. Në kohë, besueshmëria e çdo rregulli fiskal varet shumë nga angazhimi i fortë politik ndaj disiplinës fiskale.

V. PËRSHPEJTIMI I RITJES EKONOMIKE AFATGJATË

1.27 Transformimi i Shqipërisë nga një vend me ekonomi bujqësore dhe të ardhura të ulëta në një vend me të ardhura të mesme ka ardhur kryesisht si rezultat i ri-shpërndarjes së fuqisë punëtore nga bujqësia në sektorë të tjerë. Procesi i ri-shpërndarjes së burimeve nga bujqësia drejt shërbimeve, ndërtimit dhe manifakturës mund të vazhdojë dhe për një periudhë të limituar, por në të ardhmen kalimi nga njëri sektori në tjetrin do vijë duke u bërë më pak i rëndësishëm dhe rritja ekonomike duhet të mbështetet në përmirësimet e produktivitetit brenda sektorit si dhe nëpërmjet akumulimit të kapitalit fizik dhe njerëzor.

1.28 Siç u theksua edhe më lart, rritja ekonomike në 10 vjeçarin e fundit është mbështetur si nga kuadri i fortë dhe i qëndrueshëm makroekonomik ashtu edhe nga progresi i madh në

reformat strukturore. Ndër reformat më të rëndësishme të ndërmarra gjatë viteve të fundit mund të përmenden:

- **Klima e biznesit:** shërbimi me një ndalesë (one-stop-shop) i quajtur Qendra Kombëtare e Regjistrimit, regjistri i kredive dhe futja e taksës së sheshtë, së bashku me thjeshtimin administrativ të regjimit të taksave.
- **Spektori financiar:** Konsolidimi i mbikëqyrjes financiare dhe ndryshimet në kuadrin ligjor dhe rregullator të sistemit bankar për përmirësimin e ekzekutimit të kolateralit dhe menaxhimit të rrezikut të kredisë.
- **Infrastrukturë:** ndarja e rrjetit elektrik, privatizimi i sistemit të shpërndarjes, dhe krijimi i një kuadri ligjor bazuar në praktikatat më të mira për telekomunikacionet.
- **Administrimi publik:** futja e prokurimit elektronik në sektorin publik dhe miratimi i ligjit mbi koncesionet.

1.29 **Gjithashtu, kanë filluar të ndërmerren një sërë reformash të tjera.** Ndër to janë propozimi për krijimin e sistemit të Vlerësimit të Impaktit Rregullator për ligjet e reja, Ligji për Falimentimin dhe reforma e Sistemit të Inspektimit. Këto reforma janë ndërthurur me një përmirësim në qeverisjen e përgjithshme krahasuar me një dekadë më parë, e cila ka qenë e favorshme për mbështetjen dhe ruajtjen e procesit të rritjes ekonomike.

1.30 **Një element i domosdoshëm për mbështetjen e rritjes së shpejtë ekonomike dhe konvergencës me nivelet Evropiane të të ardhurave është trajtimi me një prioritet më të lartë të faktorëve plotësues të prodhimit për të hapur rrugë përmirësimeve të vazhdueshme të produktivitetit.** Në një kuptim të gjerë, këta “faktorë plotësues të prodhimit” ndahen në tre grupe:

- (i) kapitali njerëzor,
- (ii) kapitali fizik (telekomunikacionet, energjia elektrike, dhe infrastruktura e transportit), dhe
- (iii) cilësia e institucioneve.

1.31 Dy grupet e para mund të përshkruhen si inpute në procesin e prodhimit, ndërsa grupi i tretë ndikon normën e kthimit të investimeve dhe të prodhimit. Zhvillimi i këtyre faktorëve do të rriste kapacitetin dhe nxitjen për adoptimin e teknologjisë dhe metodave organizative të cilat do të rrisnin produktivitetin dhe konkurrencën. Nevoja e ndërsjellët e këtyre faktorëve vërtetohet nga fakti se ata nuk janë lehtësisht të zëvendësueshëm, dhe se mungesa e një apo më shumë faktorëve (për shembull fuqia punëtore e kualifikuar, infrastruktura e qëndrueshme e energjisë elektrike apo telekomunikacioneve) do të çonte në një rënie të produktivitetit të faktorëve të tjerë.

1.32 **Analiza i këtij raporti synon të identifikojë politikat që mund të kontribuojnë në drejtim të “Axhendës së Re të Rritjes Ekonomike” të Shqipërisë në lidhje me këta tre faktorë të rëndësishëm plotësues.** Kapitulli i dytë analizon faktorin ndoshta më të rëndësishëm për rritjen e qëndrueshme ekonomike: formimin e **kapitalit njerëzor** përmes arsimit dhe aftësive. Kapitulli i tretë synon të ilustrojë nevojën për garantimin e furnizimit me **energji elektrike** si dhe të japë disa drejtime për mënyrën e përfshirjes së **teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK)** në axhendën e rritjes. Ndërsa, kapitulli i fundit shpjegon rëndësinë e **institucioneve formale dhe informale** në promovimin e investimeve dhe rritjen e produktivitetit.

KAPITULLI 2: ARSIMI DHE AFTËSITË PËR NJË EKONOMI INOVATIVE

I. HYRJE

2.1. **Rritja e produktivitetit përmes investimeve dhe adoptimit të teknologjisë varet nga gjendja e kapitalit të duhur njerëzor – i cili krijohet nëpërmjet arsimit dhe aftësive.** Duhet vënë në dukje se sidomos në vendet në zhvillimi, inovacioni nuk ka të bëjë me procesin bazë të kërkimit dhe zhvillimit, por më shumë me përdorimin e njohurive të reja në fushën e biznesit nga individë të arsimuar dhe me aftësi, për të menduar në mënyrë krijuese dhe për zgjidhjen e problemeve.¹² Në Sondazhin për Mjedisin e Biznesit dhe Performancën e Ndërmarrjeve (BEEPS) të vitit 2008, më shumë se gjysma e firmave raportuan se mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar përbën një pengesë në bërjen e biznesit dhe kjo prapë mund të mos tregojë shkallën e vërtetë të problemit.¹³ Megjithatë shumë firma pranojnë se kanë nevojë për një menaxher, specialist IT, ekonomist apo inxhinier, ato mund të mos vlerësojnë faktin se po humbasin mundësitë për riorganizim të proceseve të prodhimit, futjen e produkteve të reja apo hyrjen në tregjet e reja (shiko Kutinë 2.1 mbi Inovacionin dhe Rritjen). Gjithashtu, në Studimin për Klimën e Biznesit (ICS) të vitit 2009, 51 përqind e firmave të mëdha, 41 përqind e eksportuesve, dhe 48 përqind e firmave të huaja raportonin aftësitë si pengesën kryesore. Përqindjet ishin më të larta se ato në vendet e tjera në tranzicion. Firmat më inovatore shprehnin shqetësim më të madh për arsimimin e fuqisë punëtore. Mbi 35 përqind e firmave që kishin adoptuar teknologji të re citonin se arsimimi i fuqisë punëtore përbente një kufizim të madh. Ky përfundim ka një rëndësi të veçantë pasi kjo kategori firmash përbën burimin kryesor të rritjes së produktivitetit dhe punësimit në të ardhmen.

2.2. **Rëndësia e arsimit dhe fuqisë punëtore të kualifikuar për vendin dhe për zhvillimin ekonomik është pranuar gjerësisht në Shqipëri.** Për rrjedhojë, në vitin 2006 janë iniciuan një sërë reformash arsimore të rëndësishme dhe me shtrirje të gjerë. Në *arsimin e ulët dhe të mesëm*, ato përfshinin:

- i) reformën e kurrikulave, për t'i bërë ato më modulare dhe më të përshtatshme, duke përfshirë në mënyrë të veçantë futjen e një programi modern të TIK në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, si dhe pajisjen e të gjitha shkollave me laboratorë informatike dhe internet,
- ii) përmirësimin e trajnimit të mësuesve, në mënyrë që metodat e mësimdhënies të fokusohen më tepër mbi krijimtarinë dhe diskutimin sesa në dhënien mekanike të njohurive,
- iii) shpërndarjen më të barabartë të burimeve midis rretheve,
- iv) përmirësimin e kushteve të të mësuarit, me klasa më pak të mbingarkuara dhe zvogëlimin e mësimin me turne në shkolla,
- v) rritjen e pagave mesatare të mësuesve me 67 përqind (apo 49 përqind në terma real) nga 2005 në 2009, dhe

¹² Për shembull, një studim i fundit për praktikën inovative vëren se “inovacioni nuk duhet të identifikohet domosdoshmërisht me futjen e teknologjive të reja por mund të rezultojë edhe nga inovacioni jo-teknologjik (si praktikën e reja të biznesit) dhe mekanizmat për të nxitur përhapjen teknologjike. Kjo është edhe më e dukshme kur merret parasysh roli i teknologjive për qëllime të përgjithshme si TIK.” Shiko Chandra, Eröcal, Padoan, & Braga, 2009.

¹³ BEEPS, i kryer në bashkëpunim midis Bankës Botërore dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), është një studim i disa mijëra firmave në vendet në tranzicion (përfshirë 300 firma Shqiptare) që analizon një gamë të gjerë çështjesh rreth mjedisit të biznesit.

- vi) ripërtëritjen e përmbajtjes dhe administrimit të provimeve të Maturës për të rritur rëndësinë e shkollave të mesme dhe për të siguruar rezultate objektive.

2.3. **Gjithashtu, edhe në arsimin e lartë janë iniciuar reforma të rëndësishme.** Në arsimin e lartë fokusi është vendosur mbi adoptimin e sistemit të Bolonjës për arsimin modular të njëjtë me atë të vendeve të tjera Evropiane, shtimin e numrit të studentëve në arsimin e lartë dhe futjen e programeve me cikël të shkurtër, nën nivelin e diplomës në universitetet e rretheve. Gjithashtu, janë parashikuar reforma në programin mësimor të universiteteve dhe reforma për t'i bërë ato më të përgjegjshme. Reforma në arsimin e lartë është *bazuar* në lidhjen me strategjinë Evropiane të arsimit siç përmendet edhe në Strategjinë e Evropës 2020. Kjo strategji synon një rritje të bazuar mbi inovacionin, arsimin, trajnimin dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës si dhe shoqërinë dixhitale. Në fakt, integrimi i Shqipërisë në ekonominë ndërkombëtare do të varet nga këta faktorë. Për këtë strategji thelbësore mbetet ideja e rritjes së performancës të institucioneve të arsimit të lartë të Evropës si dhe promovimi i lëvizjes dhe punësimit të studentëve në të gjitha vendet.¹⁴ Kjo nxit njohjen e të mësuarit jo-formal dhe informal, ashtu siç është parashikuar në Sistemin Shqiptar të Kualifikimit. Gjithashtu, ajo është e lidhur ngushtë me procesin e Bolonjës për zhvillimin e një Zone Evropiane të Arsimit të Lartë, ku kualifikimet janë të transferueshme dhe të njohura nga të gjitha vendet. Shqipëria iu bashkua këtij procesi në vitin 2003 duke u angazhuar në këtë mënyrë për të garantuar që diplomat e saj (Bachelor, Mastera dhe Doktoratura) të jenë të strukturuar dhe të kenë programe mësimore në përputhje me ato të vendeve të tjera Evropiane.

Kutia 2.1: Inovacioni dhe Rritja

Inovacioni nuk duhet të kuptohet si krijim i njohurive të reja por më tepër duhet të shikohet në lidhje me produktet, proceset dhe mënyrat e organizimit të cilat janë të reja për firmat Shqiptare. Një studim për mënyrën se si vendet, si Korea, arritën të konvergjonin me botën e zhvilluar veçon tre burimet kryesore të inovacionit. Burimi i parë është përvetësimi i teknologjisë që ekziston jashtë vendit. I dyti, është krijimi në vend i njohurive të reja përkatëse. I treti, është përhapja dhe përdorimi efikas i njohurive të reja në të gjithë sektorët e ekonomisë, pavarësisht nëse janë krijuar brenda vendit apo janë importuar nga jashtë (Dahlman, 2009). Në këtë mënyrë, inovacioni varet kryesisht nga krijimi dhe përcjellja e njohurive që në fakt do të vërehet edhe në rastin e një vendi si Shqipërisë ku krijimi i një kuadri inovativ lidhet ngushtësisht me përhapjen e njohurive dhe informacionit, në të cilin shteti luan një rol të rëndësishëm lehtësues. Përhapja e njohurive merr një rëndësi të veçantë duke pasur parasysh që në shumë vende në zhvillim shpesh ekziston një pabarazi e madhe në produktivitetin e firmave të një sektori të caktuar të industrisë. Dahlman citon studime në Brazil dhe Indi të cilat tregojnë se produktiviteti mesatar në shumë sektorë të industrisë është vetëm sa një e dhjeta e produktivitetit të firmës kryesuese në të njëjtën fushë.

Inovacioni varet nga kapitali njerëzor dhe përvetësimi i aftësive përkatëse sesa në procesin kërkimor bazik. Për shembull, Lundvall (2008) argumenton se rikuperimi i suksesshëm i Japonisë, Koresë dhe Tajvanit vuri një theks të fuqishëm mbi aftësitë inxhinierie të nevojshme për të thithur teknologjinë ndërkombëtare nëpërmjet të mësuarit duke vepruar. Prandaj, një detyrë parësore për arsimin e lartë është të kontribuojë për sipërmarrjen kolektive – që do të thotë përgatitjen e të diplomuarve me aftësitë e duhura. Një konkluzion të ngjashëm arrin dhe një studim zyrtar për inovacionin në Britaninë e Madhe, në të cilin argumentohet se roli më i rëndësishëm i kërkimeve për inovacion nuk është njohuritë e reja që ato prodhojnë, por aftësia në përdorimin e njohurive të reja (shiko Salter & etj, 2000).

II. HENDEKU I AFTËSIVE

Arritjet e Arsimit


2.4. **Shqipëria e filloi tranzicionin me një popullsi me më shumë vite shkollimi krahasuar me vendet e tjera në zhvillim me nivele të ngjashme të ardhurash për frymë.** Megjithatë, në vitet e para të tranzicionit, burimet që i kushtoheshin arsimit dhe cilësia e tij pësuan rënie. Vetëm gjatë viteve

¹⁴ Shiko Europa 2020: Një Strategji Europiane për një Rritje të Zgjuar, të Qëndrueshme dhe Gjithëpërfshirëse (Komisioni Evropian, 2010).

të fundit këto tendenca kanë nisur të ndryshojnë përmes reformave të rëndësishme që janë ndërmarrë në të gjitha nivelet e sistemit arsimor. Shqipëria shpenzon më pak për arsimin si përqindje të PBB në krahasim me vendet e tjera në rajon (3.5% të PBB në vitin 2009), krahasuar me mesataren prej 4.6 përqind në vendet e Evropës Lindore. Gjithashtu, shpenzimet për nxënës në nivelin 9 vjeçar dhe të mesëm janë ndër më të ulët në rajon. Në 2005, fëmijët shqiptarë kryenin mesatarisht 8.6 vite shkollë, një nivel i ulët në krahasim me mesataren prej 12 vite në dhjetë vendet e BE-10,¹⁵ dhe mesataren prej 14 vitesh të OECD. Kjo situatë po ndryshon gradualisht me shkollimin mesatar të pritur 12.2 vite për ata që aktualisht hyjnë në sistemin arsimor.

2.5. Shqipëria ka përqindjen më të ulët të individëve që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe të lartë (48.7%) krahasuar me mesataren prej 62 përqind të vendeve të Ballkanit.¹⁶ Edhe pse nivelet e regjistrimeve në shkollat e mesme dhe të larta janë rritur gjatë viteve të fundit (nga 51 në 60 përqind nga viti 2005 në vitin 2009 për arsimin e mesëm dhe nga 22 në 37 përqind në arsimin e lartë), ato janë ende më të ulëta se në pjesën tjetër të rajonit.¹⁷ Për më tepër, shifrat agregate fshehin një pabarazi të madhe midis arsimit të mesëm në fshat dhe atij në qytet pasi në zonat rurale regjistrimi në arsimin e mesëm mbetet në nivelin 26 përqind ndërkohë që ka arritur 88 përqind në zonat urbane në 2009. Gjithashtu, studentët që vijnë nga fshatrat kanë rezultate më të ulëta se bashkëmohatarët e tyre nga qyteti duke regjistruar mesatarisht 7 pikë më pak në provimin e letërsisë të Maturës Shtetërore.¹⁸

Figura 2.1: Shpenzimet Publike për Arsimin dhe Nivelet e Arritjeve Arsimore



Burimi: sistemi qendror i të dhënave i BB, treguesit social, shpenzimet në arsim për Shqipërinë i referohen vitit 2009, ndërsa për vendet e tjera, të dhënat më të fundit të disponueshme (zakonisht 2007 ose 2006).

Burimi: Analizat e Tregut të Punës, Treguesit Kryesor të ETF, Eurostat.

2.6. Të dhënat e vendeve të ndryshme sugjerojnë se Shqipëria ka një hendek të konsiderueshëm për të mbushur në lidhje me aftësitë njohëse.¹⁹ Studimi i Hanushek dhe

¹⁵ BE-10 i referohet 10 qendrore dhe vendeve të Evropës Lindore që u bashkuan me BE në 2004 dhe 2007.

¹⁶ Rezultate paraprake nga Studimi për Matjen e Standarteve të Jetesës, 2008.


¹⁷ Burimi: kuadri i EEE-P M&E, Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

¹⁸ Konferenca e Maturës 2009, Qendra Kombëtare e Vlerësimit.

¹⁹ Në një studim empirik ku krahasohen rezultatet arsimore, Hanushek dhe Woessmann, 2008, dhe Hanushek dhe Woessmann, 2009, paraqesin një evidencë bindëse se problem thelbësor për rritjen dhe inovacionin mbetet zhvillimi i aftësive njohëse (d.m.th. rezultati i arsimit) në krahasim me masat për arritjet e shkollës apo të numrit të regjistrimeve. Rezultatet e tyre tregojnë se “aftësitë njohëse kanë një ndikim të rëndësishëm mbi rritjen ekonomike” (Hanushek & Woessmann, 2008). Ata tregojnë se nëse merren parasysh aftësitë njohëse, vitet e shkollimit nuk kanë ndikim mbi rritjen në vlerësimet empirike. Ata arrijnë në përfundimin se aftësitë njohëse empirike kontribuojnë më shumë për rritjen ekonomike në vendet me institucione të shëndosha ekonomike. Ata arrijnë gjithashtu në përfundimin se cilësia e arsimit ka një ndikim të rëndësishëm në arritjet arsimore dhe


Woessmann ofron një indeks vlerësues të rëndësishëm për cilësinë e përgjithshme të arsimit të ulët dhe të mesëm për vende të ndryshme. Kjo u arrit nëpërmjet standardizimit të të gjitha testeve të krahasueshme në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë në mënyrë të veçantë PISA (Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve) si dhe TIMSS (Prirjet në Studimin Ndërkombëtar të Matematikës dhe Shkencës). Në vitin 2000, u vlerësuan indekse për vende të ndryshme.²⁰ Rezultatet dëshmojnë se në atë kohë ekzistonte një hendek i konsiderueshëm midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit për sa i përket aftësive njohëse. Në renditje, Shqipëria kishte rezultatin më të ulët për aftësitë njohëse dhe vetëm 40 përqind e studentëve Shqiptarë kishin arritur njohuritë bazë në matematikë dhe shkencë (20 pikë përqind më pak se Maqedonia e cila është në vend të parafundit; shiko Figurën 2.2 dhe Figurën 2.3 poshtë). Megjithatë të dhënat tashmë janë të vjetra, ato përsëri kanë vlerë pasi ilustrojnë sfidën e madhe me të cilën përballohet Shqipëria në reformat arsimore. Edhe me përpjekjet e mëdha të reformave të bëra gjatë viteve të fundit, ka gjasa që këta tregues të ndryshojnë ngadalë. Gjithashtu, është e rëndësishme të shikohen rezultatet e studimit PISA 2009 në të cilin ka marrë pjesë edhe Shqipëria dhe i cili do të publikohet në fund të 2010. Po aq e rëndësishme është për Shqipërinë marrja pjesë në studimet e ardhshme krahasuese ndërkombëtare në mënyrë që të jetë në gjendje të masë progresin dhe të hartojë reforma më të detajuara që do ndihmonin në ngushtimin e hendekut të aftësive.

Figura 2.2: Treguesi i Aftësive Njohëse (2000)



Shënime: Rezultati mesatar në matematikë dhe shkencë, shkolla fillore deri në përfundim të shkollës së mesme, të gjithë vitet (renditur sipas shkallës së PISA, ku 500 është mesatarja për vendet e OECD).

Figura 2.3: Përqindja e Studentëve me Shkollimin Bazë (2000)



Shënime: Përqindja e nxënësve që arrijnë shkollimin bazë (bazuar në rezultatet mesatare të testeve në matematikë dhe shkencë, shkolla fillore deri në përfundim të shkollës së mesme, të gjithë vitet).

Burimi: Të dhëna nga Eric A. Hanushek dhe Ludger Woessmann, 2009, “A Sjellin Shkollat më të Mira Rritje më të Madhe? Aftësitë Njohëse, Rezultatet Ekonomike, dhe Shkaqet.”

2.7. Për më tepër, në periudhën post tranzicion, përveç cilësisë së ulët të arsimit në disa aspekte (si aftësitë njohëse), edhe përshtatja ndaj ekonomisë të tregut shpesh linte për të dëshiruar. Studimet mbi ekonominë në tranzicion sugjerojnë përmes evidencës empirike se cilësia e arsimit dhe e kapitali njerëzor priret të mbivlerësohet për ekonominë socialiste para tranzicionit (Beirne & Campos, 2007), ndërkohë që një studim i detajuar për mungesën e aftësive në ndërmarrjet Ruse (Tan, Gimpelson, Kapelyushnikov, Lukyanova, & Savchenko, 2007) evidentoi se ndërmarrjet raportojnë mungesën e aftësive si një pengesë të madhe për prodhimin, pavarësisht faktit që Rusia ka një ndër përqindjet më të larta të popullsisë së rritur me arsim të lartë. Studimet e ndërmarrjeve

numrin e regjistrimeve pasi cilësia më e ulët rrit nivelet e lënies së shkollës. Prandaj, ata argumentojnë që kanalizimi i burimeve për përmirësimin e cilësisë do të ndihmonte në përmirësimin e pjesëmarrjes. Nga ana tjetër, ata raportojnë se “ duke tentuar thjesht zgjerimin e aksesit dhe të pjesëmarrjes, le të themi përmes hapjes së një numri të lartë shkollash me cilësi të ulët, do të ishte vet-shkatërruese.” Këto argumente mbështesin theksin e programit aktual të reformave për përmirësimin e cilësisë dhe përmbajtjes së programeve mësimore dhe metodave të mësimdhënies.

²⁰ Duhet theksuar se Shqipëria nuk mori pjesë në studimin PISA 2005 apo në TIMSS. Megjithatë, Shqipëria mori pjesë në studimin PISA 2009, rezultatet e të cilit do të jenë të disponueshme në fund të 2010.

Shqiptare japin një opinion të ngjashëm se të diplomuarit e universiteteve nuk kanë një përgatitje të mirë për punë.

2.8. **Kjo mund të reflektojë deri diku metodat e të mësuarit në Shqipëri.** Për shembull, disa studime tregojnë për një prirje të mësuesve për të dominuar diskutimin dhe mungesën e inkurajimit për të menduar në mënyrë kritike. Këto konkluzione përputhen me një studim të fundit të metodave të të mësuarit të kryer me disa shkolla të mesme të zgjedhura rastësisht: “Shqipëria: Arsimit i Mesëm dhe i Lartë – Si Japin Mësim Mësuesit në Shkollat e Mesme” (Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë & Banka Botërore, 2008), i cili tregon se procesi i mësimdhënies dominohet nga mësues që u flasin nxënësve të cilët nga ana e tyre kanë pak kohë në dispozicion për të kryer vëzhgime të pavarura apo për të bërë pyetje. Studimi vë gjithashtu në dukje se pjesa më e madhe e pyetjeve që bëjnë mësuesit kërkojnë përgjigje rutinë që zakonisht kanë vetëm një përgjigje të saktë. Kjo, së bashku me sasinë e madhe të kohës së harxhuar për mësimdhënien dhe marrjen e informacionit, sugjeron se studentët përballen me një mjedis mësimor të mbyllur si në aspektin intelektual dhe në atë shoqëror i cili ofron një hapësirë të kufizuar për aktivitete si puna në grup apo të menduarit në mënyrë të pavarur. Një kritikë e ngjashme del edhe në një material të Fondacionit Evropian të Trajnimit (ETF) për zhvillimin e burimeve njerëzore në Shqipëri “Përgjithësisht mësuesit e shohin punën e tyre si ‘dhënie mësimi’, dhe jo për të lehtësuar procesin e të mësuarit të nxënësve. Strategjia e Arsimit të Lartë e Ministrisë së Arsimit është gjithashtu shumë e qartë kur pranon se mësimdhënia në universitete vuan nga i njëjti problem.

E parë me gjerë, detyra kryesore për arsimin e mesëm të përgjithshëm është lëvizja me shpejtësi në drejtim të reformës të programeve mësimore të iniciuar nga MASH në 2009. Me rëndësi të veçantë do të jetë monitorimi i progresit të reformës dhe të sigurojë që ajo përfshin edhe reformën e metodave të mësimdhënies. Kjo do të kërkojë alokimin e më shumë burimeve për përgatitjen profesionale, zhvillimin dhe mbështetjen e mësuesve. Në këtë mënyrë, duhet të bëhen përpjekje serioze për të lidhur më mirë matematikën dhe shkencat në shkolla me jetën reale, ku përmbajtja matematikore dhe shkencore e programit mësimor të shkollës të fokusohet më shumë në zgjidhjen e problemeve, si dhe në kuptimin dhe zbatimin e tyre. Këto janë karakteristika të ambientit mësimor në vende si Korea dhe Singapori, të cilët arrijnë në mënyrë të vazhdueshme rezultate të larta në testet e TIMSS dhe PISA.

III. NGA LARGIMI I TRURIT NË QARKULLIMIN E TRURIT


2.9. **Zhvillimet në arsimin e lartë nuk mund të kuptohen plotësisht pa merre parasysh ndikimi i emigrimit në këtë sektor.** Gjatë periudhës midis viteve 1990 dhe 2008, rreth 40.6 përqind e stafit të universiteteve publike dhe institucioneve kërkimore emigroi jashtë Shqipërisë. Madhësia dhe intensiteti i këtij fenomeni është kaq i lartë sa që Horvat (2004) e përcaktoi Shqipërinë si një nga vendet me “nivelin më të lartë të emigrimit të *trurit* në botë.”

2.10. **Në shumë institucione Shqiptare, emigrimi preku pjesën më dinamike dhe elitare të stafeve akademike dhe kërkimore të Shqipërisë.** Të dhënat tregojnë se universiteti shtetëror dhe institucionet kërkimore të Tiranës, sidomos ato që lidhen me shkencat natyrore, inxhinierinë, fizikën bërthamore dhe artet, ishin më të prekurat.²¹ Shumica e emigrantëve nga këto institucione ishin të gjinisë mashkullore ((59.4 përqind), në moshë relativisht të re (rreth 35 vjeç) dhe, në dallim me modelet e emigrimit në masë, ata emigruan përmes rrugëve të ligjshme dhe me familjet e tyre. Të larguarit kishin mesatarisht 8 vite eksperiencë pune në institucionet kërkimore/universitetet, dhe 43 përqind e tyre kishin përfunduar specializime jashtë shtetit. Pra, problemi nuk është thjesht humbja e kapitalit njerëzor por edhe dobësimi i kapacitetit për trajnimin e brezave të rinj.

²¹ Nga Universiteti Politeknik i Tiranës, ikja e trurit llogaritet në 58.2 përqind, nga Instituti i Fizikës Bërthamore rreth 76 përqind, dhe nga Akademia e Arteve është 60 përqind.

2.11. **Fatmirësisht, emigrimi i individëve me kualifikim të lartë është zvogëluar ndjeshëm që nga viti 2000 dhe madje ka edhe shenja të kthimit të emigrantëve.**²² Emigrimi i akademikëve dhe kërkuesve shkencor nga universitetet dhe institucionet kërkimore arriti kulmin gjatë periudhës 1991-93 menjëherë pas hapjes fillestare të vendit, me një kulm të dytë në 1997-99 si rezultat i kaosit politik dhe social në këtë periudhë (Kutia 2.2 dhe Figura 2.4). Që nga ajo kohë,

Figura 2.4: Dinamika e Emigrimit të Trurit: përqindja e Akademikëve të larguar jashtë shtetit si % e numrit total të Akademikëve



Burimi: Studimi QSES, 2008.

emigrimi ka ardhur duke u ulur si rezultat i një sërë faktorësh, përfshirë përmirësimin e situatës ekonomike dhe sociale në Shqipëri (rroga më të larta dhe përmirësime në universitete), rritja e moshës mesatare të punonjësve të universiteteve, dhe vështirësia në rritje për të emigruar në Vendet e Evropës Perëndimore.

2.12. **Sfida e re për Shqipërinë është kalimi drejt qarkullimit të trurit.** Në fakt, kthimi i emigrantëve me kualifikim të lartë mund të sjellë përfitime të konsiderueshme për vendet e tyre: aftësitë e reja të përftuara prej tyre, burimet financiare dhe lidhjet e tyre me rrjetet mund të rrisin produktivitetin dhe zhvillimin ekonomik (Lowell, Findlay, & Stewart, 2004). Deri tani, vetëm 9.7 përqind e emigrantëve të kualifikuar gjatë dy dekadave të fundit janë kthyer në Shqipëri. Një e treta e tyre punojnë në të njëjtat institucione akademike/shkencore në të cilat punonin përpara emigrimit ndërsa pjesa tjetër punon kryesisht në sektorin privat. Në 2008, Universiteti i Tiranës pranoi, nëpërmjet konkurseve, 400 lektorë të rinj, por më pak se 5 përqind e tyre kishin përfunduar Ph.D (Doktoraturë) jashtë shtetit.

2.13. **Cilët faktorë shpjegojnë qarkullimin e ulët të trurit?** Anketimet rëndom kanë evidentuar faktorët ekonomikë si përcaktues të rëndësishëm të emigrimit, si dhe pengesat si rezultat i kushteve të dobëta të punës dhe perspektivën e kufizuar për karrierë të punonjësve të aftë. Në fakt, pas arritjes së stabilitetit ekonomik dhe politik, tre faktorët më të rëndësishëm të cituar që do të nxisnin kthimin në Shqipëri janë reforma në universitete dhe institucionet kërkimore, ulja e korrupsionit, si dhe investimet në arsim dhe punë kërkimore – në thelb, të gjitha janë të lidhura me kushtet e punës në universitete. Të anketuarit dëshirojnë që këto institucione të drejtohen nga individë të zgjedhur në bazë merite, të cilët vlerësojnë dhe motivojnë kërkimin dhe mësimdhënien.

2.14. **Një faktor pozitiv është gatishmëria e diasporës Shqiptare për të punuar me universitetet dhe institucionet kërkimore në vend.** Sipas studimit, rreth 97 përqind e personave me Ph.D. të cilët punojnë në vendet e industrializuara dëshirojnë të bashkëpunojnë me universitetet Shqiptare dhe institucionet kërkimore. Sfida qëndron në ofrimin e stimujve dhe tek institucionet për ta bërë të mundur këtë bashkëpunim.

²² Për të kuptuar sesi emigrimi ka ndikuar në arsimin e lartë, Banka Botërore financoi anketime me institucionet e arsimit të lartë, akademikët dhe kërkuesit shkencor në Shqipëri si dhe me akademikët shqiptar jashtë vendit. Anketimi i parë mbuloi të gjitha universitetet publike dhe institucionet kërkimore në Shqipëri me qëllim marrjen e informacionit historik mbi emigrimin e personelit të tyre. Anketimi i dytë i kërkoi stafit ekzistues akademik të shprehnin interesin e tyre në lidhje me emigrimin, ndërsa anketimi i tretë u fokusua në Shqiptarët me Ph.D. të cilët jetojnë jashtë shtetit. Të treja studimet u kryen në 2008 nga Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale (QSES), dhe citohen në të gjithë kapitullin si studimi QSES 2008. Përveç kësaj, QSES ka kryer anketime të ngjashme në 2000 dhe 2002 të cilat dhanë mundësinë e krahasimeve ndërkohore.

2.15. **Një mundësi tjetër e shkëlqyer vjen nga politikat e hedhura nga qeveria për të ndryshuar rrjedhjen e emigrantëve të kualifikuar dhe për të nxitur kthimin e atyre që janë larguar – Programi për “Kthimin e Trurit”.** Objektivi i programit (shiko Kutinë 2.3) është zhvillimi i stimulëve dhe mekanizmave politike për të promovuar angazhimin e Diasporës në zhvillimin shkencor, administrativ dhe ekonomik të vendit. Programi u krijua në Korrik 2008 me një buxhet fillestar prej një milion Euro për të garantuar mbështetje financiare ndaj individëve të kthyer të kualifikuar (të cilët plotësojnë një sërë kriteresh, p.sh. të paktën një diplomë masteri të kryer jashtë shtetit) si një stimul për të qëndruar dhe punuar në Shqipëri. Programi ka vendosur një bashkëpunim të ngushtë me institucionet e arsimit të lartë dhe administratën publike dhe jep njoftime për vendet e lira që ofrohen në këto institucione. Përmes iniciativës së Kthimit të Trurit, është krijuar një bazë të dhënash për studentët dhe akademikët jashtë vendit, e cila përmban aktualisht informacione të detajuara kontakti për rreth 400 persona. Deri tani, programi ka tërhequr rreth 150 individë për t’u kthyer, prej të cilëve 82 janë akademikë. Përveç kësaj, programi synon të krijojë rrjetet akademike me ata që ndodhen jashtë vendit.

2.16. **Një parakusht për të mbajtur akademikët dhe për të nxitur kthimin e tyre nga jashtë është reformimi i universiteteve në mënyrë që të përmirësohet cilësia e punës kërkimore.** Në shumë fusha kërkimore, cilësia është larg standardeve ndërkombëtare. Alternativat e mundshme për nxitjen e një bashkëpunimi të tillë nën mbështetjen e një programi të gjerë të Kthimit të Trurit do të ishin: (i) fitimi i akademikëve Shqiptarë që ndodhen jashtë për të mbajtur leksione në universitetet Shqiptare, për të recensuar punët kërkimore të publikuara në Shqipëri, si dhe për të marre pjesë në komisionet e reformave të universiteteve dhe të sigurimit të cilësisë; (ii) krijimi i mundësive të trajnimit dhe konsulencës, sidomos për qeverinë; dhe (iii) promovimit të projekteve të përbashkëta kërkimore midis kërkuesve lokal dhe atyre jashtë vendit. Gjithashtu, duhet të zgjerohet dhe të rritet aksesimi i bazës së të dhënave të programit të “Kthimit të Trurit” për studentët dhe akademikët Shqiptarë në mënyrë që ai të shërbejë si burim informacioni për universitetet, institucionet kërkimore dhe joqeveritare, administratën publike, dhe sektorin privat për të gjetur akademikët e kualifikuar.

Kutia 2.2: Mobilizimi i Rrjeteve Akademike përmes Programit të Kthimit të Trurit

Programi i “Kthimit të Trurit (Brain Gain)” po mbështet Bordin e Arsimit të Lartë në Shqipëri për të zhvilluar dhe zbatuar Ligjin e ri të Arsimit të Lartë, i cili do ta bënte më fleksibël procesin e kthimit të studiuesve dhe profesorëve. Komponenti akademik i Programit të Kthimit të Trurit është duke u pilotuar në Universitetin e ri “Aleksander Moisiu” në Durrës, dhe është duke mbështetur ekipin drejtues akademik për identifikimin e profesorëve apo individëve që janë të angazhuar në fushën e arsimit, qoftë në SHBA apo Kanada, apo në vende të tjera. Tashmë ka filluar procesi i leksioneve afatshkurtra ku lektorë me eksperiencë vijnë nga Shtetet e Bashkuara për të dhënë mësim në universitetet Shqiptare. Mbështetje jepet gjithashtu edhe për një sërë stimulësh për të krijuar një model të ri të drejtimit akademik.

Këto përmirësime pritet të rrisin mundësinë e lëvizjes së akademikëve dhe studiuesve Shqiptarë brenda komunitetit shkencor ndërkombëtar për projekte të përbashkëta, për punësime të përkohshme në universitetet dhe institucionet kërkimore jashtë shtetit, për pjesëmarrje në konferenca dhe seminare, për shkëmbime informacioni dhe publikime të përbashkëta, nga një bazë në Shqipëri.

Burimi: <http://www.braingain.gov.al/>

2.17. **Të gjitha aktivitetet e mësipërme kërkojnë stimuj dhe financim.** Të gjithë përputhen me hapat e parë të propozuar nga programi për “Kthimin e Trurit”. Ata do të kërkojnë burime shtesë financiare dhe menaxhuese të alokuara nëpërmjet programit të “Kthimit të Trurit”, në mënyrë që ai të mos mbetet thjesht një program pilot me vlerë. Programet e punës kërkimore dhe mësimdhënies së përbashkët mund të jenë të suksesshme vetëm nëse vetë universitetet janë pjesë dhe përfshihen në mënyrë aktive në hartimin e tyre. Prioriteti për Shqipërinë më pas është gjetja e rrugëve se si mund të optimizohen përfitimet nga emigrimi, duke arritur tek individët e arsimuar dhe të aftë si jashtë dhe brenda vendit, përmes krijimit të institucioneve dhe stimulëve.

IV. NJË SISTEM ARSIMOR MË I MADH DHE MË I MIRË

2.18. Sistemi arsimor është nën presionin e plotësimit të kërkesave të një ekonomie që po ndryshon me ritme të shpejta. Në vitet e fundit, shpenzimet e arsimit kanë pasur një tendencë drejt rritjes (nga 3.2 përqind në 2006 në 3.5 përqind në 2009). Gjithashtu, shpërndarja e shpenzimeve për nivelet e ndryshme të arsimit ka mbetur përgjithësisht e qëndrueshme (Tabela 2.1).²³ Megjithatë, ndërkohë që numri i studentëve ka pësuar rënie të ngadaltë (veçanërisht në grup-moshat më të vogla në arsimin 9-vjeçar), numri i studentëve në arsimin e lartë (publik) është rritur me rreth 50 përqind gjatë pesë viteve të fundit (Tabela 2.2) në linjë me Strategjinë e qeverisë për Arsimin e Lartë për të zgjeruar hyrjen për të gjithë ata që dëshirojnë të ndjekin studimet (shiko Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë, 2008). Kjo ka bërë që financimi për student në arsimin e lartë të bie me kalimin e kohës nga 25 përqind të PBB për frymë në 20 përqind midis viteve 2004 dhe 2009 (Tabela 2.3). Gjithashtu, siç shikohet nga këto të dhëna kostoja për nxënës në shkollat e mesme profesionale është rreth 2.6 herë më e lartë se kostoja për nxënës në shkollat e mesme të përgjithshme.

Tabela 2.1: Shpenzimet për Arsimin (Struktura në Përqindje)

	2006	2007	2008	2009
Total	100.0	100.0	100.0	100.0
I ulët dhe Parashkollor	61.7	58.5	60.4	62.0
I mesëm i Përgjithshëm	12.1	13.0	12.7	11.7
I mesëm Profesional	6.6	6.7	6.2	5.8
Arsimi i lartë	16.6	17.2	16.4	16.8
Administrata dhe Shkenca	3.0	4.6	4.3	3.6
Total % ndaj PBB	3.2	3.3	3.5	3.5

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Thesari i Shtetit

Tabela 2.2: Numri i nxënësve sipas Niveleve të Arsimit Publik (Mijë)

	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Arsimi 9-vjeçar	541.1	501.3	501.8	483.7	512.0	494.8
Total i Arsimit të Mesëm	131.1	150.1	155.4	159.3	118.1	124.0
I mesëm i Përgjithshëm	107.7	120.8	124.9	129.6	96.3	104.0
I mesëm Profesional	23.4	29.4	30.5	29.7	21.8	20.0
Arsimi i Lartë	62.3	73.0	81.1	80.7	80.0	95.8

Burimi: Vlerësimet e stafit bazuar në të dhënat nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Thesari i Shtetit. Shiko shënimin ²⁴ në fund të faqes për një shpjegim të ndërprerjes së të dhënave midis 2007 dhe 2008 si rezultat i ristrukturimit të arsimit të mesëm.

Tabela 2.3: Shpenzimet për Student si % e PBB për Frymë

	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Arsimi 9-vjeçar	10.2	10.6	12.5	12.4	14.0	14.7
Total i Arsimit të Mesëm	13.3	12.2	12.2	12.9	17.9	15.9
I mesëm i Përgjithshëm	10.3	9.8	9.9	10.5	14.7	12.6
I mesëm Profesional	26.6	22.1	22.0	23.5	32.1	32.7
Arsimi i Lartë	25.4	22.4	20.9	22.3	23.0	19.7

Burimi: Vlerësimet e stafit bazuar në të dhënat nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Thesari i Shtetit.

2.19. Siç mund të pritet, kthimi nga arsimimi, sidomos i atij pas shkollës së mesme, është i dukshëm dhe ka nxitur regjistrimin e të rinjve në universitete. Vlerësimet e ndikimit të nivelit të arsimit mbi nivelin e pagës në Shqipëri u bënë përmes përdorimit të Anketës për Matjen e Standardeve të Jetesës (LSMS) të kryer në 2005 dhe 2008. Për të ndarë efektet specifike të nivelit arsimor mbi nivelin e pagës, u përdorën ekuacione të tipit të Mincer me variabla diskretë (dummy) për të

²³ Duhet theksuar që në tabelat në këtë seksion, të dhënat janë të ndikuara nga reforma në arsim, e cila duke nisur nga viti shkollor 2008/09, rriti numrin e viteve të shkollës në arsimin e ulët nga tetë në nëntë dhe uli vitet e arsimit të mesëm nga katër në tre. Për pasojë, ka një rritje prej një viti në arsimin e ulët dhe një ulje korresponduese në nxënësit e arsimit të mesëm.

kontrolluar ndryshimet rajonale, ndryshimet sektoriale dhe moshën si dhe numrin e viteve të përvojës së punës apo shkollim të avancuar përpara tranzicionit. Për krahasim janë dhënë gjithashtu edhe rezultatet e tre vende fqinje. Rezultatet në Tabelën 2.4 tregojnë se koeficientët janë përgjithësisht brenda pritshmërive. Në shumicën e rasteve ata me arsim të mesëm profesional fitojnë më shumë se ata me arsim 9-vjeçar, megjithëse nuk ndodh gjithmonë kështu me arsimin e mesëm të përgjithshëm. Në të gjithë rastet personat me arsim të lartë fitojnë shumë më tepër se ata me arsim të mesëm.

2.20. **Një prirje që meriton analizë më të thelluar është rënia e kthimeve nga arsimit i lartë për të rinjtë.** Përlogaritjet në tabelën e mëposhtme tregojnë se kthimet nga arsimit i lartë përkundrejt atij të ulët u rritën nga 47.7 përqind në vitin 2005 në 51.9 përqind në vitin 2008. Po ashtu, kthimet nga arsimit profesional u rritën nga 13.5 përqind në 21.3 përqind në të njëjtën periudhë. Kjo është në përputhje me të dhënat e anketave të ndërmarrjeve që raportojnë se mungesa e aftësive është një pengesë gjithnjë e më e madhe për realizimin e investimeve dhe veprimtarive të biznesit. Megjithatë, vërehet një prirje e kundërt për njerëzit nën 35 vjeç: në 2005 shpërblimi shtesë për arsimin e lartë për personat nën 35 vjeç ishte 62.2% përkundrejt 47.7% për totalin, por në vitin 2008 ai ishte më i ulët se totali (46.9% përkundrejt 51.9%). Kjo do të thotë ose që rrogat e punëtorëve të rinj me arsim të ulët apo të mesëm janë rritur më shumë se rrogat e të diplomuarve në universitete, ose që rrogat e të diplomuarve në universitete kanë pësuar ulje (gjë që është e pamundur). Ndryshimi mund të shpjegohet edhe nga të dhënat e kufizuara për një analizë të tillë të anketës.

Tabela 2.4: Rroga shtesë për Kategori të Ndryshme të Arsimit

	<i>Shqipëria 2008</i>	<i>Shqipëria 2005</i>	<i>BH 2004</i>	<i>Maqedoni a 2005</i>	<i>Serbia 2005</i>
<i>Të gjithë individët në moshë pune</i>					
I mesëm i Përgjithshëm	11.4	-0.2	-1.2	5.3	13.3
I mesëm Profesional	21.3	13.5	7.4	19.2	31.0
Arsim mbi atë të mesëm	51.9	47.7	32.6	57.4	70.5
<i>Personat më pak se 35 vjeç</i>					
I mesëm i Përgjithshëm	6.4	2.3	-1.3	-4.1	12.7
I mesëm Profesional	12.1	14.7	9.9	7.6	27.6
Arsim mbi atë të mesëm	46.9	62.2	45.6	49.2	66.1

Shënim: Koeficientet tregojnë shpërblimin (rrogën) shtesë në përqindje për nivelin e arsimit mbi ata me arsim të ulët ose më pak. Për Maqedoninë dhe Serbinë, shifrat janë për 1-3 vjet dhe 3-4 vjet arsim i mesëm, në vend të arsimit të përgjithshëm apo profesional.

Burimi: Për Shqipërinë, vlerësime të stafit nga LSMS 2005 dhe 2008, duke përdorur ekuacione të tipit Mincer me variabla diskret (dummies) shtesë për rajonet, sektorët dhe moshën. Për vendet e tjera nga Linden, Arnhold, dhe Vasiliev, 2008.

2.21. **Arsimi i lartë publik dhe privat në Shqipëri është zgjeruar me shpejtësi, veçanërisht gjatë tre viteve të fundit (Kutia 2.4).** Qeveria u angazhua në dhënien e mundësisë së hyrjes në universitete për të gjithë ata që dëshirojnë ta ndjekin atë. Për rrjedhojë, numri i studentëve u rrit në rreth 100,000 në 2008 dhe vazhdon të rritet; numri i studentëve në universitetet publike është rritur me 50 përqind në pesë vjet (Tabela 2.5). Regjistrimet në universitetet private kanë pasur gjithashtu një rritje të madhe; aktualisht, 17 përqind e studentëve të arsimit të lartë janë regjistruar në universitetet private dhe 25 përqind e regjistrimeve në vitin 2009 ishin në universitete private. Nëse ruhen nivelet aktuale të pranimit, në 2012 numri i të diplomuarve në vit do të jetë tre herë më i lartë se ai në 2005.

2.22. **Ndërkohë, duke pasur parasysh cilësinë relativisht të ulët të sistemit të lartë arsimor, ekziston shqetësimi se rritja e numrit të regjistrimeve mund të mos japë përfitimet e dëshiruara.** Përmirësimi i cilësisë të sistemit është më i vështirë kur ai është në një proces zgjerimi, nëse më parë nuk konsolidohen mekanizmat për rikualifikimin e mësuesve dhe rekrutimin e mësuesve të rinj nga jashtë (p.sh. përmes zgjerimit të programit për Kthimin e Trurit). Problemi vështirësohet dhe prej faktit se megjithë rritjen e financimit ai nuk po ecën me të njëjtat ritme si rritja e numrit të studentëve.

Kjo do të thotë se rritja e numrit të studentëve duke ruajtur cilësinë e duhur, është e qëndrueshme nëse universitetet rrisin të ardhurat nga burime të tjera (përfshirë tarifën e shkollimit).

Kutia 2.3: Sistemi Universitar në Shqipëri

Sistemi arsimor i lartë në Shqipëri bazohet kryesisht në programet akademike tradicionale, dhe ka një hapësirë të konsiderueshme për rritjen e larmisë institucionale. Shqipëria ka vetëm një universitet publik të përgjithshëm; Universiteti i Tiranës dhe dy universitete të tjera publike të specializuara (Universiteti Politeknik i Tiranës, dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës) të cilët ndodhen në kryeqytet dhe dominojnë sistemin për sa i përket regjistrimeve dhe burimeve. Gjashtë universitetet publike në rrethe filluan si institucione të vogla me regjistrime të ulëta, dhe programe akademike tradicionale me lidhje të dobëta me nevojat e ekonomive rajonale. Megjithatë sistemi ka filluar të zhvillohet në mënyrë të konsiderueshme dhe disa nga universitetet rajonale kanë filluar të zhvillojnë profile të specializuara akademike. Për shembull, Universiteti “Ismail Qemali” në Vlorë është fokusuar kryesisht në zhvillimin e programeve të TIK, matematikës dhe shkencave. Universitete të tjera po përpiqen të zhvillojnë lidhje më të forta me ekonomitë rajonale dhe tregjet e punës.

Gjithashtu, Shqipëria ka tashmë 35 institucione private të arsimit të lartë (20 nga të cilat janë themeluar gjatë dy viteve të fundit): 32 prej tyre ndodhen në Tiranë dhe 3 në qytete të tjera. Ndërkohë, vetëm 12 prej tyre janë plotësisht të akredituar ndërsa 3 të tjerë pjesërisht të akredituar. Të gjithë të tjerët janë në proces të marrjes së akreditimit, ose janë akoma shpejt për të filluar procesin. Janë hedhur dyshime në lidhje me cilësinë e të diplomuarve në institucionet private, por kjo është e vështirë të gjykohet në mungesë të akreditimit apo informacionit për performancën e studentëve. Shumë nga studentët që janë regjistruar në universitetet private të paakredituar besojnë se akreditimi do të merret ose nuk do të ketë rëndësi në të ardhmen. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka pranuar shqetësimet e ngritura për cilësinë e mësimdhënies dhe mësimin në institucionet private të arsimit të lartë, dhe për këtë arsye Ministria ka filluar procesin e kontraktimit të një agjencie të huaj akreditimi për të vlerësuar dhe klasifikuar programet e studimit në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë.

Tabela 2.5: Zgjerimi i Arsimit të Lartë në Shqipëri (Mijë)

Viti akademik	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Norma bruto e regjistrimeve (%)	18.4	21.6	24.7	28.2	29.2	29.9	37.3
Studentë të regjistruar	53.3	63.3	74.8	86.9	90.2	92.7	116.1
Kohë e plotë (publik)	36.2	42.2	50.6	58.9	62.3	61.3	76.8
Kohë e pjesshme (publik)	16.6	20.1	22.5	22.2	18.4	18.6	19.0
Privat	0.4	1.0	1.7	5.8	9.5	12.7	20.3
Hyrjet e reja	13.9	14.1	16.5	21.0	21.0	25.0	26.8
Publik	13.7	13.5	15.7	16.7	17.2	19.2	19.9
Privat	0.3	0.6	0.8	4.4	3.8	5.8	6.9
Numri i studentëve që diplomohen	6.0	6.3	8.4	9.9	14.2	14.8	n/a
Publik	6.0	6.3	8.4	9.6	13.9	14.4	n/a
Privat	0.0	0.0	0.0	0.3	0.4	0.4	n/a
Personeli mësimdhënës	4.0	4.5	5.5	5.8	6.1	6.9	7.6
Studentë private si % e totalit	0.8	1.5	2.3	6.6	10.5	13.7	17.5
Regjistrime private si % e totalit	1.9	4.2	4.8	20.7	18.2	23.3	25.6

Shënim: Përqindja bruto e regjistrimeve tregon studentët si një përpjesëtim të popullatës 18-25 vjeç.

Burimi: Baza e të dhënave e Ministrisë së Arsimit.

2.23. Duhet të mbahet një ekuilibër i kujdesshëm i shpërndarjes të burimeve ndërmjet zgjerimit të sistemit ekzistues dhe rritjes së cilësisë. Nëse sistemi zgjerohet me ritme shumë të shpejta, atëherë ekziston rreziku i shpërdorimit të burimeve nëse stafet e reja të rekrutuara janë më pak të kualifikuara apo kur zgjerimi çon në pranimin e studentëve me përgatitje të pamjaftueshme.

Megjithëse zgjerimi i arsimit të lartë është një objektivi i dëshirueshëm afatgjatë, përmirësimi i cilësisë së tij duhet të jetë gjithashtu një prioritet. Zgjerimet e përshpejtuara çojnë në rënie të cilësisë, nivel të lartë lënie studimesh dhe zgjatjen e kohës së diplomimit (duke harxhuar më shumë burime) si dhe në të diplomuar të zhgënjyer dhe të papunë. Gjithashtu, për të përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme cilësinë e arsimit të lartë, nevojitet një sistem më i mirë arsimor në nivelin e ulët dhe të mesëm.

2.24. Zgjerimi i arsimit të lartë po ndodh mbi një bazë që rrezikon shtrembërimin e shpërndarjes së studentëve jo në përputhje me nevojat e tregut të punës. Siç mund të shihet nga Tabela 2.6, më shumë se 60 përqind e studentëve në universitetet publike studiojnë për mësuesi, për shkencë humane apo sociale, ndërsa vetëm 10 për qind studion për shkencë të sakta, matematikë dhe informatikë, dhe 8 përqind në inxhinieri apo fushat e lidhura me të. Qeveria është e ndërgjegjshme për rëndësinë e ndryshimit të modelit të të diplomuarve me qëllim që ata të jenë më afër kërkesave të tregut të punës. Për këtë qëllim, Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me universitetet publike është duke përgatitur aktualisht një kuadër të ri politikash për regjistrimin e studentëve në universitete për vitin akademik 2010-11 i cili propozon një ulje të ndjeshme të numrit të studentëve në fushat me kërkesë të ulët të tregut të punës (siç janë shkencat shoqërore) dhe një rritje të shpejtë të numrit të studentëve në matematikë, shkencë dhe turizm me theks të veçantë në programet e TIK. Gjithashtu, MASH po inkurajon institucionet private të arsimit të lartë për të hapur programe të reja studimi në shkencë dhe TIK.

Tabela 2.6: Shpërndarja e Studentëve sipas Fushës së Studimit, 2006-2008

	2006		2007		2008	
	Publik	Privat	Publik	Privat	Publik	Privat
Totali (mijë)	81.1	5.8	81.1	9.5	79.8	12.2
Totali (%)	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Mësuesi	10.9	1.4	10.4	0.0	9.8	0.3
Shkencat humane dhe art	21.3	7.2	20.2	1.2	16.8	0.9
Shkencat sociale, biznes dhe juridik	28.2	63.1	33.6	65.4	32.4	66.0
Shkencat matematikore dhe kompjuterike	10.1	2.4	8.7	0.6	9.9	8.0
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	8.2	3.0	9.1	5.2	10.4	0.0
Bujqësi dhe veterinar	9.1	0.0	9.4	0.0	11.1	0.0
Shëndetësi dhe punë sociale	9.5	19.8	8.0	27.7	8.3	24.8
Turizëm	2.6	3.1	0.7	0.0	1.3	0.0

Burimi: Raporti Statistikor Vjetor i Arsimit 2006-2007 dhe baza e të dhënave të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë, 2009.

2.25. Gjithashtu, për të mbështetur cilësinë e zgjerimit të arsimit të lartë, sektori po kalon në një proces të madh reforme. Qëllimi i kësaj reforme është përmirësimi i cilësisë, përgjegjshmërisë dhe rëndësisë të universiteteve.²⁴ Megjithatë, siç u theksua dhe më parë, është e rëndësishme që procesi i reformës të mos dobësohet prej zgjerimit të shpejtë të universiteteve, sidomos me rritjen e universiteteve private që mund të tërheqin edhe një pjesë të stafit të kualifikuar të universiteteve publike. Deri tani, përpjekjet më të mëdha të reformës janë fokusuar në çështjet administrative dhe organizative lidhur me zbatimin e procesit të Bolonjës në arsimin e lartë. Reformat e rëndësishme, sidomos ato të programeve mësimore, të metodave të mësimdhënies dhe të menaxhimit transparent dhe të përgjegjshëm sa kanë filluar, dhe do të jenë përcaktuese për zhvillimin e sektorit në të ardhmen.

2.26. Në bazë të këtyre reformave, universiteteve do t'u kërkohet që të rishikojnë thellësisht programet dhe metodat e mësimdhënies. Universiteteve gjithashtu do t'u duhet të krijojnë sistemet e planifikimit dhe monitorimit të cilat ndjekin kërkesën për kualifikimin e studentëve dhe

²⁴ Në proces janë gjithashtu edhe reformat në qeverisje (bordi i administratorëve, përzgjedhja e drejtuesve, etj.) dhe reforma në financim (financimi për frymë). Reformat e tjera në drejtim të financimit duhet të fokusohen në faktorët e cilësisë dhe investimet në veprimtari, pajisje, dhe trajnim të avancuar të personelit meqënëse është pothuajse e pamundur që mekanizmat e tregut të stimulojnë investime të tilla me kaq lehtësi dhe shpejtësi.

performancën e secilit fakultet. Një element i rëndësishëm në çdo program zhvillimi gjithëpërfshirës për nxënësit e shkollave të mesme me prirje të kufizuara akademike është trajnimi për teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK). Në këtë drejtim, programi i qeverisë për pajisjen e të gjitha shkollave me kompjutera dhe internet është një hap i rëndësishëm përpara. Nga ana tjetër kjo do të lehtësojë adoptimin e gjerë të TIK nga firmat Shqiptare. Ai ofron gjithashtu fleksibilitet dhe aftësi në zgjidhjen e problemeve të cilat janë të domosdoshme në një ekonomi moderne të bazuar në inovacionin.

V. PËRMIRËSIMI I AFTËSIVE TË TREGTUESHME

2.27. **Hartimi i një kuadri institucional dhe politikash për të siguruar lidhjen e arsimit me nevojat e punëdhënësve përbën një sfidë të rëndësishme.** Aktualisht, punëdhënësit dhe/ose shoqatat profesionale nuk janë të përfshira në vendimet lidhur me përmbajtjen e programeve të universiteteve. Nuk ka komitete konsultimi për programet profesionale në universitetet publike, që duhet të ofrojnë inpute për hartimin dhe zhvillimin e programeve të shkencave, të TIK, të inxhinjerisë apo të mjekësisë. Gjithashtu, mekanizmi i financimit për programet e universiteteve nuk përmban kritere për të garantuar mbështetjen e një marrëdhënie të tillë, apo stimuj për të shpërblyer rezultatet pozitive të lidhjes me tregun e punës për të diplomuarit e universiteteve, për shembull, niveli i punësimit në profesione të lidhura me programin e studimeve pas diplomimit. Ndërkohë që, konsultimet me sektorin privat munguan edhe në reformën e fundit të ndërmarrë për programet mësimore të shkollave të mesme.

2.28. **Lidhjet e dobëta me tregun e punës pasqyrohen dhe në mungesën e programeve të arsimit të vazhdueshëm në universitetet publike Shqiptare.** Arsimi i vazhdueshëm dhe ai profesional është një nga detyrat kryesore të universiteteve në shoqëritë që drejtohen nga njohuritë. Arsimi i vazhdueshëm mund të përfshijë gjithashtu ofrimin e programeve të trajnimit për agjencitë qeveritare, korporatat dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Ofrimi i trajnimeve të përshtatshme për ndërmarrjet mund të jetë një burim i rëndësishëm të ardhurash për institucionet publike me burime të kufizuara, si dhe mund të rezultojë në përmirësimin e cilësisë dhe përmbajtjen e programeve mësimore në sistemet me kohë të plotë. Duke ndërvepruar me sektorin privat dhe duke i ofruar atij shërbime, programet mund të bëhen më i dobishëm (për shembull në përdorimin e aftësive të TIK), studentët marrin njohuritë e duhura dhe është më e lehtë të mbahet stafi akademik.

2.29. **Gjithashtu, duket se ka një kapacitet të kufizuar për vazhdimin e edukimit dhe trajnimit brenda firmave.** Mungesa e mundësive nga sistemi formal i arsimit nuk kompensohet gjithmonë nga trajnimi brenda firmave. Nga Anketa e Klimës së Investimeve (ICS) 2009 vetëm 19 përqind e firmave raportuan se ofrojnë trajnim formal. Duket se firmat hezitojnë të ofrojnë trajnime për të rritur kapitalin njerëzor të punëtorëve prej frikës se ata mund të largohen tek konkurrentët apo mund të emigrojnë. Megjithatë, disa firma ofrojnë trajnime në punë, por kjo është më e vështirë për fushat më të kërkuara të aftësive menaxhuese. Nga intervistat me firmat e mëdha doli se ato përpiqen të identifikojnë fillimisht “potencialin” përpara se të përdorin trajnim në punë për të ngritur kapacitetin menaxhues. Firmat me kapital të huaj në shumicën e rasteve rekrutojnë menaxherë nga jashtë vendit. Në të njëjtën kohë, shumë firma të përfshira në studimin e ICS treguan se janë të gatshme të pranojnë praktikantë dhe të marrin pjesë në zhvillimin e programeve dhe kurrikulave përkatëse.

2.30. **Përveç reformës së sistemit arsimor, mund të jetë me vlerë krijimi i stimujve nga ana e shtetit për të nxitur investimet në trajnimin e punëtorëve.** Ka një argument të fortë teorik për sektorin publik për të subvencionuar (të paktën përkohësisht) investimet private në kapital njerëzor, si p.sh. trainimin punëtorëve nga ana e firmave, duke pasur parasysh eksternalitetet pozitive. Pa një mbështetje të tillë, firmat dhe individët do të tentojnë të investojnë nivele më të ulëta se ai optimal në kapitalin njerëzor, me rrjedhoja negative si për rritjen agregate afatshkurtër ashtu dhe atë afatgjatë (Galor and Zeira, 1993). Avantazhi shtesë i këtyre mekanizmave, në rastet kur hartohen dhe zbatohen si duhet, është se ato mundësojnë ofrimin në periudhë afatshkurtër të trajnimit në aftësi që janë mjaft

të vlefshme për tregun e punës (me pjesëmarrjen e punëdhënësve), ndërkohë që ndërmerren reformat më afatgjata të sistemit arsimor.

2.31. Aktualisht, dy mekanizma të mbështetjes financiare nga qeveria kanë pasur një përdorim shumë të ulët nga firmat. Në mekanizmin e parë qeveria mbështet një skemë trajnimi në vendin e punës për të papunët, ku punëdhënësit që marrin në punë një kandidat për të paktën një vit dhe i ofrojnë trajnim, subvencionohen për nëntë muaj trajnim. I dyti ofron trajnim për punëtorët e kompanive që mund të tregojnë se trajnimi është i nevojshëm dhe garanton punësim pas trajnimit. Mungesa e suksesit të këtyre skemave është për shkak të i) ndërgjegjësimit relativisht të ulët në lidhje me ekzistencën e tyre; ii) procese dhe inspektime të mbingarkuara; iii) punëtorët e përfshirë në këto skema duhet të regjistrohen formalisht, dhe iv) një mosbesim i përgjithshëm ndërmjet qeverisë dhe firmave private.

2.32. Përvoja ndërkombëtare sugjeron që mbështetja e qeverisë për trajnimin funksionon më mirë kur firmat, qoftë në mënyrë individuale ose si anëtarë të shoqatave të biznesit, janë të përfshirë në hartimin dhe menaxhimin e programeve të trajnimit. Këto programe kanë shumë më pak gjasa të jenë të suksesshme nëse ofrohen vetëm nga shteti. Ato gjithashtu janë më të suksesshme nëse ndërmarrjet përfituese paguajnë të paktën një pjesë të kostove. Një nga mënyrat për të trajtuar çështjet e eksternaliteteve të trajnimit (p.sh. “vjedhjen” e punëtorëve të trajnuar) është të kërkohet nga një grup firmash të paguajnë në mënyrë kolektive kuotat për një fond të përbashkët trajnimi, nganjëherë i plotësuar pjesërisht nga kontributet e qeverisë.

VI. FUSHAT E REFORMAVE NË ARSIM

2.33. Analiza e mësipërme illustroi nevojat dhe sfidat për të siguruar arsimin dhe trajnimin e nevojshëm për një ekonomi inovative dhe të bazuar tek njohuritë. Ato janë: (i) mungesa e një mekanizmi sinjalizues efikas për sektorin privat për të evidentuar aftësitë e kërkuara, ndërsa studentët nuk kanë informacion real në lidhje me kërkesat e aftësive në treg; (ii) studentët potencial nuk disponojnë asnjë informacion mbi cilësinë e universiteteve dhe programeve të ndryshme; (iii) universitetet nuk disponojnë as mekanizmat dhe as stimujt për t’iu përgjigjur kërkesave të firmave për aftësi; dhe (iv) eksternalitetet e bëjnë shumë të kushtueshëm dhënien e mjaftueshme të trajnimit nga ana e firmave, ndërkohë që e kanë të pamundur të përballojnë subvencionimin e programeve profesionale me burime të pamjaftueshme përmes ofrimit të praktikës për studentët.

2.34. Zgjidhja e sfidave të mësipërme kërkon veprim në shumë fronte; është e nevojshme që të krijohen institucione, të ofrohen stimuj dhe të lehtësohet qarkullimi i informacionit. Pjesa tjetër e këtij kapitulli parashtron disa alternativa politikash që mund të merren parasysh nga ana e autoriteteve.

Mbështetja dhe Përmirësimi i Reformave në Vazhdim

2.35. Në dy vitet e fundit janë ndërmarrë një sërë nismash të rëndësishme për reformimin e arsimit të mesëm dhe të lartë dhe për përmirësimin e cilësisë dhe vlerave. Këto nisma duhet të vazhdojnë dhe të mbështeten më tej. Ato përfshijnë:

- i) Ristrukturimi i arsimit të ulët nga tetë në nëntë vjet, së bashku me reformën në proces të kurrikulave;
- ii) Reforma në vazhdim në arsimin e lartë, por me vëmendjen e duhur ndaj rreziqeve të zgjerimit të shpejtë për cilësinë e arsimit.
- iii) Adoptimi i konceptit të Sistemit Shqiptar të Kualifikimit (AQF) për të siguruar një udhërrëfyes për të gjitha kualifikimet akademike dhe profesionale dhe për të lehtësuar kalimin ndërmjet tyre, duke përfshirë që gjatë procesit të harmonizimit të kuadrit kualifikues të bashkohen sektorët privatë dhe publikë në një dialog mbi vlefshmërinë e kualifikimeve dhe aftësive;

- iv) Zbatimi i ligjit mbi arsimin e lartë (tretësor) dhe adoptimi efektiv i kuadrit me tre faza të *Procesit të Bolonjës* si një udhërrëfyes për ristrukturimin e arsimit të lartë në Shqipëri;
- v) Krijimi i Agjencisë së Akreditimit për Arsimin e Lartë (AAAL) përgjegjëse për garantimin e cilësisë dhe akreditimin e programeve dhe institucioneve akademike të arsimit të lartë;
- vi) Ristrukturimi i sistemit të kërkimit shkencor dhe zhvillimit, duke e larguar atë nga fokusi mbi Akademinë Shqiptare të Shkencave dhe institucioneve kërkimore bazuar në ministrinë e linjës drejt një sistemi më bashkëkohor të bazuar në universitete, dhe
- vii) Futja e programeve me cikël të shkurtër nën nivelin e diplomës në universitetet rajonale si p.sh. programet profesionale në Fakultetin e Studimeve Profesionale në Universitetin e Durrësit të përshkruar në Kutinë 2.4.

2.36. **Zbatimi i këtyre reformave kërkon përpjekje dhe angazhim të konsiderueshëm nga Qeveria si dhe mbështetje financiare dhe teknike nga organizatat ndërkombëtare përkatëse.** Një shembull i kësaj sfide është vlerësimi i përpjekjes që duhet për të akredituar të gjitha programet akademike në universitetet publike në vend. Deri tani, pas tre vitesh pune të vazhdueshme nga Agjencia e Akreditimit për Arsimin e Lartë (AAAL), vetëm 9 grupe programesh janë akredituar nga një total i vlerësuar prej 60 grupesh në 12 institucionet publike në vend. Ndaj nevojitet rritja e burimeve dhe ngritja e kapaciteteve të nevojshme për AAAL, dhe agjenci të tjera arsimore për të realizuar me efektivitet mandatin e tyre.

Fushat e Propozuara për Reformat e reja

(i) Shpërndarja e Informacionit

2.37. **Disa nga reformat më të rëndësishme lidhen me publikimin e informacionit dhe krijimin e institucioneve për nxitjen e dialogut lidhur me çështjet e arsimit dhe aftësive.** Reformat e arsimit aktualisht në proces theksojnë rëndësinë e përgjegjshmërisë, dhe përvoja ndërkombëtare tregon që kur performanca është e vëzhgueshme, krijimi i nxitjes dhe mekanizmave për përmirësim është më i lehtë. Prandaj propozohet që informacioni i mëposhtëm të bëhet i disponueshëm:

- i) Publikimi i rezultateve të provimeve të Maturës për çdo rreth dhe shkollë,²⁵
- ii) Publikimi i rezultateve mesatare të Maturës për studentët e pranuar në të gjitha degët dhe në të gjitha universitetet,
- iii) Publikimi i rezultateve përfundimtare, dhe normat e përfundimit për secilën degë program,
- iv) Realizimi i sondazheve për punësimin të të diplomuarve, dhe publikimi i rezultateve ,
- v) Realizimi i një sondazhi të përvitshëm nga ana e punëdhënësve për të vlerësuar performancën e studentëve të diplomuar nga universitete të ndryshme, dhe publikimi i rezultateve, dhe
- vi) Realizimi i një sondazhi të përvitshëm nga ana e punëdhënësve mbi aftësitë që kërkohen dhe që disponohen, dhe publikimi i rezultateve.

²⁵ Megjithëse rezultatet e provimeve të Maturës publikohen në internet dhe në gazeta, këto rezultate janë të disponueshme edhe në bazë individuale por nuk krijojnë mundësi për krahasim të performancës së shkollave dhe qarqeve.

2.38. **Një informacion më i zgjeruar pritet të mbështeste përgjegjshmërinë dhe të japë nxitjet e nevojshme për reforma.** Informacioni i prodhuar nga masat e mësipërme do t'u garantonte politikë-bërësve bazën e nevojshme për të gjykuar se në cilat fusha reformat po funksionojnë dhe se ku duhet të forcohen. Ky informacion ka po aq rëndësi edhe për nxënësit dhe familjet e tyre për t'i bërë të vetëdijshëm ndaj dallimeve në cilësi dhe oportunitete. Kjo do të krijonte një shtysë më të madhe për reformimin dhe institucioneve me performancë të dobët, dhe një kërkesë më të madhe për institucionet që qëndrojnë mbi nivelin mesatar. Pjesëmarrja në studimet e ardhshme PISA është pjesë e rëndësishme e këtyre përpjekjeve.

2.39. **Nëpërmjet përdorimit të informacionit të mësipërm, Qeveria do të kishte mundësi të hartonte skema nxitëse për të alokuar studentët në ato fusha ku ka mugesë aftësitësisht.** Për shembull, mund të ofrohen bursa të pjesshme në fusha si inxhinieri dhe TIK për nxënësit me rezultatet më të larta në Maturë (në mënyrë që të tërhiqen nxënësit më të kualifikuar). Universitetet dhe fakultetet mundet të pajisen gjithashtu me burime shtesë për të rritur numrin e nxënësve me aftësi të larta në këto kurse.

(ii) Tarifat e shkollimit dhe struktura

2.40. **Skemat e reja nxitëse mund të kombinohen me shkuarjen drejt financimit të universiteteve në bazë të regjistrimit faktik të studentëve.** Për të promovuar konkurrencën mes universiteteve dhe për t'ju dhënë atyre nxitje për të përmirësuar cilësinë dhe eficiencën, si një hap i parë do të ishte rregullimi i formulës ekzistuese të financimit, ku të ketë financim të diferencuar në varësi të rëndësisë së disiplinës për zhvillimin. Ndryshimi i formulës është vendimtar për rritjen e konkurrencës dhe krijimit të nxitjeve.

2.41. **Rritjet në tarifat e shkollimit, veçanërisht në disiplinat ku ka një fluks të madh të diplomuarish, mund të çojë në një rishpërndarje të degëve të kërkuara në universitetet dhe mund të rrisin fondet e universiteteve.** Këto rritje tani janë të lejuara me ligj. Ato do të krijojnë nxitje si për universitetet ashtu dhe për studentët. Përcaktimi i tarifave të shkollimit mundësisht në nivelin 15-20 përqind të kostos faktike të shkollimit, në kombinim me bursa për studentët në nevojë dhe/ose hua me qëllim që hyrja në universitete të mos të penalizojë padrejtësisht studentët e aftë por me të ardhura të ulëta. Të marra së bashku, këto reforma: (i) rrisin financimet në këtë sektor dhe mundësisht zgjerojnë hyrjet duke e bërë atë më të barabartë, (ii) krijojnë nxitje për studentët dhe prindërit e tyre që të rrisin kërkesën për cilësi ndaj asaj që paguajnë, dhe (iii) përmirësojnë nivelin e diplomave dhe përfundimin e universitetit. Përvoja në vende të tjera ka treguar se studentët që paguajnë apo marrin hua kanë më shumë gjasa ta përfundojnë arsimin e tyre në afatin e përcaktuar se sa bashkëmohatarët e tyre që arsimohen falas.

(iii) Diversifikimi i Programeve dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë

2.42. **Në të njëjtën kohë, ekziston nevoja e diversifikimit të arsimit të lartë, si në aspektin e programeve ashtu dhe atë të institucioneve. Në mënyrë specifike, krijimi i kolegjeve me orientim profesional në universitetet rajonale është thelbësor.** Kjo është e ngjashme me rastin e vendeve të tjera të BE dhe OECD, dhe do të plotësonte kërkesën arsim të lartë nga një popullatë më e larmishme nxënësish. Këtu do të përfshiheshin nxënës me nivel të pranueshëm të përgatitjes akademike, nxënës nga shkollat e mesme profesionale me përgatitje ndoshta më të kufizuar akademike, nxënës që kërkojnë kualifikime të arsimit të lartë dhe nxënës nga grupet pa përkrahje. Këto kolegje të reja do të vendosnin ura të rëndësishme ndërmjet arsimit të mesëm profesional dhe arsimit të lartë nga njëra anë, dhe ndërmjet dy sektorëve të arsimit të lartë në anën tjetër. Nxënësit e shkollave të mesme të përgjithshme dhe ata nga shkollat e mesme profesionale me ose edhe pa provim mature, do të jenë të pranueshëm për të hyrë në kolegjet e reja. Të diplomuarit nga këto institucione mund të vazhdojnë studimet e tyre drejt një diplome universitare. Këto institucione mund të modelohen mbi bazën e Fakultetit të Studimeve Profesionale (FSP) në Universitetin e Durrësit.

2.43. **Gjithashtu, do të kishte vlerë dhe zhvillimi i kapaciteteve për dhënien e programeve të arsimit të vazhdueshëm dhe arsimit për të rriturit.** Për këtë qëllim, është e nevojshme ngritja e kapaciteteve në të gjitha institucionet e arsimit të lartë për të zhvilluar programe trajnimit për organizatat publike dhe ndërmarrjet, që do gjeneronin të ardhura. Krijimi i një skeme nixtëse për të siguruar që institucionet kanë autonominë për të mbajtur dhe investuar të ardhurat e tyre për nisma të ngritjes së mëtejshme të kapaciteteve do t'i shërbente arritjes së këtij qëllimi.

Kutia 2.4: Fakulteti i Studimeve Profesionale, Universiteti i Durrësit

FSP u krijua në Universitetin e Durrësit, universiteti më i ri rajonal i Shqipërisë, në vitin 2007. Fakulteti ofron diploma dy-vjeçare dhe diploma 3- vjeçare profesionale në: Studime Paraligjore, Asistent Administrimi, Infermieri, Asistent Dentar, Teknologji Automobilistike, Menaxhim Ndërtimi, Menaxhim Transporti dhe, për tu theksuar, Zhvillim dhe Menaxhim TI. Modeli për zhvillimin e FSP është një kombinim i kolegjit komunitar të Amerikës së Veriut pasi përfshin programe profesionale në fusha të ndryshme studimesh në biznes, teknologji dhe shërbime shëndetësore, dhe modelit francez të *Institut Universitaire de Technologie (IUT)*, i cili është një institucion me bazë universitare që ofron kryesisht programe profesionale të bazuara në teknologji dhe biznes me një kohëzgjatje 2 dhe 3 vjet. Në zhvillimin dhe zbatimin e këtyre programeve, universiteti ka adoptuar një numër nismash premtuese reformuese. Së pari, mësimdhënia në shumicën e fushave të mësipërme ofrohet nga profesionistë që punojnë në fushën përkatëse të cilët punësohen me kohë të pjesshme. Së dyti, universiteti ka bërë një marrëveshje me shkollat e mesme profesionale, tregtarët e makinave dhe kontraktorët e ndërtimit në zonë për të përdorur mjediset e tyre për trajnimin praktik të studentëve. Së treti, struktura e kursit përdor një metodë modulare bashkëkohore ku secilit modul i përcaktohen kreditet përkatëse të ECTS. Së fundi, adoptimi i “coop mode” të strukturës së programit duke përdorur modelin gjerman të *Beruf Akademie.*, i cili përfshin alternimin e semestrave të studimit dhe punës me punëdhënësit pjesëmarrës në një program 3-vjeçar (180 kredite ECTS), do të ishte i pari i këtij lloji në Shqipëri.

Modeli i Universitetit të Durrësit ofron një shembull të rëndësishëm të orientimit të programeve për t'i bërë ata të vlefshëm për tregun e punësimit dhe mund të adoptohet në zona të tjera të vendit.

(iv) Përmirësimi i Cilësisë dhe Rëndësisë së Arsimit të Lartë

2.44. **Hapat për arritjen e një ekuilibri të saktë midis cilësisë dhe dobishmërisë kërkon një program veprim me disa shtylla, të cilat përfshijnë:**

- **Forcimin e lidhjeve me tregjet e punës.** Në shumë vende këto lidhje përfshijnë praktikën me punëdhënësit e sektorit privat dhe publik gjatë periudhës të studimeve, dhe krijimin e programeve dhe shërbimeve me orientim të qartë profesional. Këto masa u japin mundësi punëdhënësve të vlerësojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e studentëve, si dhe nxitjen për të dhënë në mënyrë aktive ide dhe këshilla për dobishmërinë e programeve akademike. Gjithashtu MASH mund të marrë në konsideratë krijimin e nxitjeve për institucionet në mënyrë që të krijohen Komitetet Këshilluese të Programeve (KKP), dhe përfshirjen e përfaqësuesve të punëdhënësve nga sektorë si inxhinieria, teknologjia inxhinierike, biznesi apo mjekësia. Mandati i KKP do të përfshinte: (i) konfirmimin e informacionit nga tregu rreth kërkesës aktuale dhe të ardhshme për të diplomuar nga disiplinat e ndryshme; dhe (ii) dhënien e këshillave mbi njohuritë dhe aftësitë që nevojiten. KKP dhe komitete të ngjashme përdoren me sukses në shumë vende të OECD.
- **Forcimin e akreditimit dhe garantimit të cilësisë së universiteteve dhe programeve të tyre.** Qeveria mund të marrë në konsideratë ndarjen e akreditimit të institucioneve nga akreditimi i programeve. Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë (AAAL) duhet të vazhdojë punën e saj mbi akreditimin e institucioneve duke përdorur kuadrin e hartuar. Megjithatë, akreditimi i programeve do të kërkonte përfshirjen e ekspertëve ndërkombëtarë dhe organizatave profesionale, të cilat mund të përmirësojnë vlerësimin e cilësisë së programeve dhe të sigurojnë përfshirjen e punëdhënësve apo shoqatave të punëdhënësve në procesin e vlerësimit. Vlerësimi nga një organ i jashtëm do ta bënte akreditimin e programeve më rigoroz si dhe do të reduktonte subjektivitetin e mundshëm kur punonjësit e fakulteteve janë të vetmit që kryejnë vlerësimin e kolegëve të tyre. Gjithashtu, rekomandohet që të krijohen

njësitë dhe procedurat e brendshme të garantimit të cilësisë në çdo institucion të arsimit të lartë, për të promovuar një kulturë të cilësisë dhe pronësinë e reformave të garantimit të cilësisë.

- **Trajnim i vazhdueshëm i mësuesve dhe i stafit pedagogjik.** Në mënyrë që reformat e sipërpërmendura të japin rezultatin më të mirë, ato duhet të shoqërohen me programe dhe masa për ngritjen e kapaciteteve të stafeve të universiteteve. Reformat e propozuara të qeverisjes duhet të shoqërohen me trajnim për leadershipin e stafit pedagogjik të universiteteve, zhvillimin e karrierës së mësuesve, dhe trainime hyrëse për mësuesit e rinj. Në mbështetje të këtyre objektivave, MASH mund të marrë në konsideratë krijimin e një Instituti të Zhvillimit të Stafit Pedagogjik në një nga universitetet kryesore.

(v) Konsolidimi i Kapaciteteve të Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Inovacionit

2.45. Me kalimin e Shqipërisë në nivele me të avancuara prodhimi, ajo ka nevojë të zhvillojë kapacitetet e saj për të adoptuar dhe zhvilluar teknologji të reja. Kjo do të kërkojë:

- **Ristrukturimin e sistemit të vjetruar të kërkimit dhe të zhvillimit dhe inovacionit.** Sfida kryesore me të cilën përballlet Shqipëria është vazhdimi i punës së nisur në 2006 për restrukturimin e sistemit të vjetruar të kërkimit dhe zhvillimit (R&D) dhe për t'i kthyer parimet e mëposhtme udhëzuese në realitet funksional:
 - i) krijimi i një sistemi të integruar të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Shqipëri përmes integritetit të instituteve kërkimore dhe njësive akademike universitare,
 - ii) krijimi i Qendrave Kërkimore pranë fakulteteve apo universiteteve, dhe
 - iii) secili punonjës shkencor i këtij sistemi duhet të japë mësim dhe të ndërmarrë kërkim shkencor.
- **Rritja e rolit të sektorit privat në kërkim, zhvillim dhe inovacion.** Për këtë qëllim, është e rëndësishme të bashkërendohen përpjekjet publike për R&D me nevojat e industrisë në mënyrë që rezultatet e tyre të mund të përkthehen në përfitime ekonomike. Gjithashtu, për të arritur këtë rezultat, duhet të përforcohet zbatimi i regjimit për të drejtat e pronës intelektuale, rritja e numrit të kërkuesve të përfshirë në R&D, dhe rritja e regjistrimeve në degët shkencore.

KAPITULLI 3: MODERNIZIMI I INFRASTRUKTURËS

I. HYRJE

3.1. **Për çdo ekonomi infrastruktura është një nevojë bazë e zhvillimit ekonomik, ndërkohë që për rritjen e qëndrueshme të ekonomive moderne faktor i rëndësishëm është infrastruktura TIK.** Gjatë dekadës së fundit Shqipëria ka përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën e saj. Në terma të infrastrukturës “tradicionale”, rreth 1.4 miliard Euro janë investuar në rrugë të reja dhe është bërë ristrukturimi i sistemit elektrik. Në terma të infrastrukturës “moderne”, në vitet e fundit ka pasur përdorim të gjerë të telefonisë celulare. Në kushtet kur integrimi me ekonominë Evropiane përbën tashmë *objektivin themelor* të Shqipërisë, zhvillimi i infrastrukturës po bëhet një prioritet akoma më i madh i *axhendës së re të rritjes ekonomike*. Ky kapitull shqyrton tre aspekte të infrastrukturës së Shqipërisë: TIK, energjinë elektrike dhe transportin. Aspektet e tjera të infrastrukturës si sektori i ujërave, megjithëse është i rëndësishëm për bujqësinë dhe turizmin, nuk janë përfshirë në këtë raport.

3.2. **Në dy dekadat e fundit, infrastruktura TIK, apo ‘konektiviteti’, ka qenë nxitësi kryesor i rritjes ekonomike për ato vende që kanë investuar në këtë infrastrukturë.** Përdorimi i rrjeteve dhe shërbimeve me brez të gjerë (broadband) po ndikon në mënyrë transformuese në aktivitetet ekonomike dhe përfshirjen sociale në të gjithë botën, duke krijuar themelin për rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë në periudhë afatgjatë, veçanërisht në vendet e vogla. Në vitet e fundit Shqipëria ka bërë progres të madh në zhvillimin e disa segmenteve të infrastrukturës TIK, veçanërisht në tregun e telefonisë celulare. Megjithatë, Shqipëria është ende shumë prapa në segmente të tjera të rëndësishme, sidomos për penetrimin e internetit, ku aksesit dhe përdorimi janë në nivel shumë të ulët krahasuar me BE dhe me vendet fqinje të Shqipërisë. Në vitin 2009, penetrimi i internetit me brez të gjerë ishte vetëm 2.5 përqind- që është më i ulët se në çdo vend të BE dhe shumë më i ulët madje edhe se vendi i parafundit (Kosova, që kishte 6.4 përqind penetrim në internet me brez të gjerë).²⁶ Është e qartë se Shqipëria duhet të rrisë adoptimin e internetit me brez të gjerë, veçanërisht nëse kërkon të përmirësojë konkurrueshmërinë e saj krahasuar me vendet fqinje. Seksioni II i këtij kapitulli synon të identifikojë shkaqet për zhvillimin e ulët të TIK dhe të ofrojë rekomandime për politikën se si të avancojë me shpejtësi në përmirësimin e “konektivitetit” të Shqipërisë.

3.3. **Për shumë vite, energjia elektrike ka qenë një faktor kufizues për investimet dhe rritjen ekonomike, por Shqipëria ka ndërmarrë disa reforma në vitet e fundit për të adresuar këtë problem.** Në këtë sektor janë ndërmarrë reforma të rëndësishme por objektivi i ofrimit të energjisë elektrike në mënyrë plotësisht të sigurt dhe me cilësi të lartë nuk është arritur ende. Meqenëse energjia elektrike përbën një input themelor për çdo aktivitet ekonomik, lehtësimi i kufizimit të energjisë elektrike është një nevojë themelore për Shqipërinë në transformimin e saj drejt një ekonomi moderne. Seksioni III i këtij kapitulli adreson sfidat e infrastrukturës në sektorin e energjisë elektrike.

3.4. **Së fundmi, problemet kryesore në transport tani janë sigurimi i mirëmbajtjes së duhur për investimet e mëparshme, pjesëmarrja në iniciativat rajonale për të forcuar lidhjet me vendet fqinje, dhe përmirësimi i cilësisë së rrjetit aktual të rrugëve në zonat rurale.** Investimet e mëdha në rrugë të reja duhet të analizohen me kujdes dhe të ndërmerren vetëm nëse mund të demonstrohen përfitime ekonomike të konsiderueshme. Megjithatë, në zonat rurale vetëm 46 përqind e rrugëve rajonale dhe lokale janë në gjendje të arsyeshme. Në këtë mënyrë, adresimi i këtyre problemeve do t'i mundësojë Shqipërisë shkurtimin e distancave për në tregjet kryesore të saj. Për rrjedhojë, fokusi në sektorin e transportit nuk duhet të jetë ndërtimi i rrugëve të reja, por përmirësimi i rrugëve aktuale dhe më pas mirëmbajtja e tyre. Ky në thelb është një problem menaxhimi ekonomik i cili kërkon mbajtjen e një balance të kujdesshme midis vazhdimit të zhvillimit të rrjetit ku është ekonomikisht e mundshme, dhe në të njëjtën kohë të sigurohet forcimi i kuadrit institucional dhe ruajtja e të gjitha rrugëve. Këto çështje trajtohen në Seksionin IV të këtij kapitulli.


²⁶ Sipas të dhënave të Cullen International, 2010.

II. PËRMIRËSIMI I KONEKTIVITETIT NËPËRMJET TIK

Konektiviteti dhe Lidhjet e Tij me Rritjen Ekonomike

3.5. Përfitimet ekonomike të rritjes së konektivitetit, veçanërisht nëpërmjet internetit me brez të gjerë, konfirmohen nga një numër i madh studimesh. Për shembull një studim i Bankës Botërore ²⁷, duke përdorur të dhëna nga 120 vende në botë gjatë viteve 1980-2006, gjeti një lidhje të ndjeshme pozitive midis penetrimit të internetit me brez të gjerë dhe rritjes së PBB. Në mënyrë më të detajuar, një rritje me 10 pajtimtarë me akses me brez të gjerë për 100 banorë shoqërohet me rritje me 1.4 pikë përqindje të PBB për frymë në vendet në zhvillim (Figura 3.1 dhe 3.2). Sigurisht që këto rezultate duhet të konsiderohen si ilustruese pasi në vitet e fillimit të periudhës së shqyrtuar telefonia fikse ishte teknologjia e vetme e disponueshme, dhe për vendet në zhvillim interneti me brez të gjerë është bërë më shumë i disponueshëm vetëm në pesë vitet e fundit.


Figura 3.1: Ndikimi i Rritjes së Penetrimit të ICT me 10 Pikë Përqindje në Rritjen e PBB për Frymë, 1980-2006



Burimi: Qiang & Rossotto, 2008.

3.6. Ndoshta jo rastësisht politik-bërësit në Evropë po fokusojnë vëmendjen e tyre gjithmonë e më shumë, në infrastrukturën e TIK. Komisioni Evropian (KE) ka vendosur si objektiv përsheptimin e shtrirjes së internetit me brez të gjerë dhe krijimin e një tregu të vetëm e konkurrues për shërbimet e informacionit dhe medias brenda BE. Sipas strategjisë së tij i2010, KE synoi që në vitin 2010 linjat me brez të gjerë me shpejtësi të lartë të ishin të disponueshme kudo në Evropë, dhe në vitin 2010 vendosi një objektiv të ri që në vitin 2020 të ketë kudo internet me brez të gjerë me shpejtësi minimale 30 Mbps. KE propozoi një rreth virtual me tre komponentë: “krijimi i shërbimeve të përbajtjes dhe pa kufij” që do çojë në “rritje të kërkesës për shërbime”, dhe për pasojë në “shtrirjen e rrjetit”.

Figura 3.2: Penetrimi i Internetit (për 100 banorë) ndaj PBB për frymë



Burimi: Përlllogaritje të bazuara në WDI, Eurostat, dhe Cullen International (2010).

²⁷ Shiko Qiang dhe Rossotto, 2008, *Economic Benefits of Broadband*, in *Information and Communications for Development 2009: Extending Reach and Increasing Impact*, Banka Botërore, Washington DC.

Infrastruktura TIK në Ekonominë Aktuale


3.7. Duke qenë se telefonia celulare, e-maillet, faqet e Internetit dhe tregtia elektronike po përdoren nga një numër gjithmonë e më i madh firmash, ka një rritje të numrit të firmave që perceptojnë se infrastruktura TIK në Shqipëri është e pamjaftueshme të mbështesë aspiratat e rritjes ekonomike të Shqipërisë. Rritja e numrit të firmave që perceptojnë se TIK është një problem për bizneset e tyre nuk do të thotë se ka përkeqësim në infrastrukturë, por më shumë ajo nënkupton se ka një rritje në kërkesë e cila ka tejkaluar zhvillimin e TIK në vitet e fundit. Për shembull, pjesa e firmave Shqiptare që përdorin e-mailin për komunikime periodike u rrit nga 37 përqind në 2002, në 71 përqind në 2008. Shqipëria gjithashtu renditet në një pozicion shumë të ulët në indeksin Gatishmëria e Rrjeteve në Raportin Botëror të Teknologjisë së Informacionit të Forumit Botëror Ekonomik (World Economic Forum Global Information Technology Report Networked Readiness (World Economic Forum & INSEAD, 2009)). Shqipëria zë vendin e 105 nga 134 vende në të gjithë botën, që është më e ulëta në Europë, përveç Bosnje dhe Hercegovinës. Ndërkohë, për të njëjtin indeks, Maqedonia renditet në vendin 79, Serbia 84, Kroacia 49 dhe Sllovenia 31.

3.8. Progresi më i madh në zhvillimin e TIK ka ndodhur në tregun celular. Aksesit në telefoninë celulare është përmirësuar, dha tani Shqipëria renditet në nivelet më të mira në rajon. Rritja e sektorit u nxit nga masat për rritjen e konkurrencës në treg nëpërmjet hyrjes në treg të një operatori të tretë në 2008 dhe licencimit të një operatori të katërt në 2009. Deri në fund të vitit 2009, norma e penetrimit arriti në 129 përqind duke çuar Shqipërinë shumë afër niveleve të vendeve të rajonit dhe BE (Figura 3.3). Për më tepër, sektori vazhdon të rritet pasi aksesit është i mundshëm edhe për pajtimtarë në zonat rurale.

3.9. Megjithatë sektori ka ngelur prapa në lidhje me teknologjinë e përdorur. Një shembull për këtë është fakti se shërbimet 3G nuk ofrohen ende për përdoruesit celularë Shqiptarë. Aktualisht, Shqipëria (si edhe Kosova) është i vetmi vend në Evropë që nuk ka dhënë ende një licencë 3G. Në Evropë, 3G po zëvendëson me shpejtësi komunikimet e Sistemit Global Celular (GSM) 2/2.5G, dhe në shumë vende ka tashmë dy ose më shumë operatorë që ofrojnë këtë shërbim. Si rezultat, rreth 35 përqind e numrit total të pajtimtarëve në BE tashmë përdorin 3G ose një gjeneratë më të lartë. Tenderi për dhënie të një licence 3G është publikuar në Shtator, kështu që shërbimi duhet të fillojë të ofrohet në 2011. Ky shërbim mund të bëhet një rrjet i rëndësishëm alternativ me brez të gjerë dhe ka mundësi disa vende në tranzicion ose në zhvillim që të shmangin disa forma ekzistuese të TIK.


3.10. Gjithashtu, Shqipëria ka nevojë të rrisë aksesin me brez të gjerë në internet. Vetëm 2.5 përqind e popullsisë së përgjithshme apo 10 përqind e familjeve kanë akses me brez të gjerë në

Figura 3.4: Penetrimi Celular në Vende të Rajonit dhe BE



Burimi: Cullen International, 2010.

Figura 3.3: Pjesa e Teknologjive 3G (përqindje)




Burimi: Baza e të dhënave Wireless Intelligence.

internet, e cila është shumë më e ulët se në BE apo rajonin e Ballkanit të cilët kanë akses në nivel 23.9 përqind dhe 7.7 përqind respektivisht. Shqipëria ndodhet shumë prapa edhe se vendet më pak të zhvilluara në këtë sektor (p.sh. Kosova). Përveç kësaj, pothuajse të 60.000 klientët me akses me brez të gjerë në internet ndodhen në qytete pasi në zonat rurale ky shërbim është ende i pazhvilluar. Megjithë rritjen e madhe të penetrimit të internetit me brez të gjerë në vitin 2009, hendeku (me vendet e tjera) ngelet ende i madh.

3.11. **Numri i pajtimtarëve në internet me brez të gjerë është në rritje si rezultat i rritjes së disponueshmërisë, reduktimit të tarifave, dhe prezantimit të lidhjeve ADSL nga Albtelecom në fund të vitit 2008.** Vazhdimi i rritjes së penetrimit në internet me brez të gjerë do të varet nga autoritetet nëse ato arrijnë të mbajnë një mjedis transparent dhe konkurrues midis Ofruesve të Shërbimit Internet (ISP-ve). Disponibiliteti i përmbajtjes së dobishme dhe tërheqëse do të jetë shumë e rëndësishme për zhvillimin e shërbimeve me brez të gjerë.

Figure 3.5: Teknologjitë Alternative me Brez të Gjerë




Burimet: KE (2008), dhe Cullen International (2007).

Gjithashtu, për rritjen e këtyre shërbimeve është e nevojshme krijimi i stimuljeve për investime në infrastrukturë të re (rrjeti kryesor (backbone) dhe në teknologjitë e aksesit në rrjetin fundor lokal) dhe detyrimi për të dhënë me qera dhe me tarifa të bazuara në kosto pjesë të infrastrukturës aktuale, si dhënia e qarkut lokal për operatorët alternativë.


3.12. **Aksesi në TV kabllor mund të jetë një teknologji alternative me brez të gjerë të cilën Shqipëria nuk e ka shfrytëzuar ende plotësisht (Figura 3.5).** Në Shqipëri ka rreth 38 kompani TV kabllor, por sistemi është i fragmentuar dhe shumica e kompanive u shërbejnë tregjeve të ndara lokale. Si rrjedhojë, numri total i pajtimtarëve kabllorë është shumë i vogël në raport me standardet rajonale dhe një numër akoma më i vogël i këtyre pajtimtarëve përdorin TV kabllorë për akses në Internet. Ndërkohë, në Bullgari, Maqedoni dhe Rumania më shumë se gjysma e familjeve janë të lidhur me TV kabllor, dhe shumë prej tyre përdorin edhe shërbimet e internetit dhe të telefonisë. TV kabllor mund të luajë një rol shumë më të madh si mënyrë alternative për aksesin në brez të gjerë i cili do të mund të rriste konkurrencën, reduktonte tarifat broadband dhe përmirësonte cilësinë e shërbimeve në treg (Figura 3.7). Nga ana tjetër, konkurrenca në tregun celular u rrit në vitin 2008, kur dy kompanive private ekzistuese (të cilat ndanin tregun në mënyrë pothuajse të barabartë) iu shtua edhe një hyrës i ri në treg, Eagle Mobile, kompani ku qeveria zotëron 24 përqind të pronësisë. Deri në Qershor 2009, Eagle kishte arritur të fitonte 15 përqind të tregut celular në Shqipëri. Gjithashtu rregullatori i telekomunikacioneve vendosi nën kontroll tarifat me pakicë të disa paketave të telefonisë celulare si dhe tarifat e interkoneksionit. Këto ndërhyrje, së bashku me rritjen e konkurrencës, duket se kanë qenë të suksesshme në drejtim të reduktimit të tarifave (Figura 3.6). Akoma më i rëndësishëm është fakti, se në përgjithësi, sektori pritet të ketë reduktime të vazhdueshme të kostove për shkak të përparimeve teknologjike dhe konkurrencës së lartë në treg. Për shembull, vendet e BE kanë përfituar 10-13 përqind reduktime në tarifat celulare gjatë vitit 2007 (KE, 2008).

Figura 3.6: Tarifat e Operatorëve të Telefonisë Celulare në Rajon



Burimi: Cullen International, 2010.


Figura 3.7: Tarifat e Telefonisë Fikse, Tetor 2009, Euro cent



Shënime: * çmimet për përdoruesit e biznesit
 ** tarifat jo të ponderuara të tre operatorëve kryesorë
 Burimi: Cullen International, 2010.

3.13. Në kontrast me këtë, tarifat për internetin me brez të gjerë vazhdojnë të jenë të larta dhe kjo përbën një shkak të rëndësishëm për numrin e kufizuar të përdoruesve të këtij shërbimi nga popullsia dhe bizneset e vogla. Sipas Cullen International (2010), pajtimi mujor për Internetin me brez të gjerë në Shqipëri është gjashtë herë më i lartë se në Kroaci, pothuajse dy herë më i lartë se në Malin e Zi, dhe 50 përqind më i lartë se në Kosovë (shiko Figurën 3.8). Përvoja nga vendet e rajonit tregon se niveli i lartë i penetrimit të internetit me brez të gjerë mund të arrihet vetëm nëpërmjet uljes së çmimit të këtij shërbimi.

Figura 3.8: Tarifat e Pajtitit Mujor për Internet me Brez të Gjerë 2 mbps, Euro në muaj



Burimi: Cullen International, 2010.

3.14. **Kostot e larta për shërbimet mund të shpjegohen pjesërisht nga mungesa, ose kapaciteti i kufizuar i infrastrukturës së rrjetit kryesor (backbone) me fibër optike tokësore.** Kapaciteti i fibrës optike është me rëndësi kritike për rritjen e shpejtë të internetit me brez të gjerë. Albtelecom është i vetmi operator që ka konektivitet (me fibër optike) kombëtar (ndër-urban dhe urban) dhe ndërkombëtar, por rrjeti i tij është i kufizuar vetëm në disa akse kryesore. Për rrjedhojë, tarifat për lidhje me shpejtësi të lartë janë tepër të larta, duke penguar hyrjen e rrjeteve të reja në këtë segment në terma konkurrues. Ndërsa operatorët e tjerë në Shqipëri kanë të drejtë të shtrijnë rrjet backbone kombëtar dhe ndërkombëtar, ata në pjesën më të madhe nuk e kanë përdorur këtë të drejtë-kjo përbën një problem që ka nevojë të analizohet. Gjithashtu, për shkak të rregullave të paqarta të “së drejtës për ndërtim (rights of way)”, ka mbivendosje (duplikime) të rrjeteve dhe shpenzime të panevojshme për to. Zhvillimi i infrastrukturës së internetit me brez të gjerë (si edhe celular) pengohet gjithashtu nga pasiguritë në lidhje me pronësinë e tokës, vështirësitë në marrjen e lejeve të ndërtimit dhe nevojës së mbajtjes së gjeneratorëve të vet për shkak të furnizimit të pasigurt me energji elektrike.

3.15. **Faktorët e kostove kanë e bërë tregun e Internetit një treg me përqendrim të lartë.** Përveç Albtelecom, në Shqipëri janë edhe rreth 90 ISP, por vetëm pak prej tyre janë lojtarë të rëndësishëm që mund të konsiderohen si konkurrentë të vërtetë. Shumica e ISP-ve në Shqipëri janë akoma lokal dhe të fragmentuar. Prej kësaj, krijohet një rreth vicioz ku në mungesë të aksesit me

çmime të përballueshme në infrastrukturë, vetëm pak ISP mund të ofrojnë shërbime interneti dhe në mënyrë të pashmangshme me kosto të larta; në mungesë të shërbimit me çmim të lirë të internetit, njerëzit mund të mos kenë informacion për gamën e përfitimeve të mundshme nga aksesimi në internet dhe në mungesë të shfaqjes së kërkesës, infrastruktura do të vazhdojë të mos zhvillohet mjaftueshëm dhe do të jetë me kosto të lartë (Kutia 3.1)

Kutia 3.1: Zhvillimi i TIK dhe Kapitali Human

Zhvillimi i sektorit TIK në Shqipëri mund të kufizohet, më shumë se në sektorët e tjerë, nga disponibiliteti i kufizuar i punonjësve shumë të aftë. Është përlogaritur se aktualisht vetëm rreth 10 përqind e studentëve që diplomohen nga degët e lidhura me TI janë të punësueshëm. Si rrjedhojë, firmat TIK ndeshen me kosto të larta të trajnimit pas-punësimit. Dy arsyt kryesore për këtë hendek të aftësive janë (i) përdorimi i kufizuar i TIK në edukim në përgjithësi dhe (ii) kufizimet në programet teknike të universiteteve përfshirë kurrikula të vjetruara dhe lidhje të kufizuara me sektorin privat. Kjo situatë krijon pasiguri të konsiderueshme për “punëdhënësit trajnues” pasi ata përballen me riskun e vjedhjes së të punësuarve nga punëdhënësit jo trajnues. Për rrjedhojë mund të krijohet një rreth jo-optimal me aftësi jo të mjaftueshme.

Rregullimi Institucional i Sektorit

3.16. **Tashmë shumica e elementëve bazë të kuadrit rregullator për telekomunikacionet janë efektiv. Në vitin 2008, qeveria krijoi një organ të pavarur rregullator- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).**²⁸ AKEP-i, i cili zëvendësoi organin e mëparshëm rregullator, Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, drejtohet nga një këshill me pesë anëtarë, të emëruar nga, dhe përgjegjës ndaj, Kuvendit. Pavarësia e tij forcohet gjithashtu nga fakti se ai është një organizatë vet-financuese, që mbështetet kryesisht në pagesat për frekuencat dhe licencat. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit u krijua nga qeveria në vitin 2007, për të koordinuar zhvillimin, administrimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe për promovimin e shoqërisë së informacionit. Në vitin 2008 u krijua Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE) për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji dhe për monitorimin e nënshkrimit elektronik në Shqipëri.²⁹ Në vitin 2008 u krijua Komisioneri për Mbrojtjen e Të dhënave Personale, me qëllim garantimin e menaxhimit të të dhënave personale duke ruajtur privatësinë e tyre.³⁰ Gjithashtu është krijuar një Këshill Kombëtar për Radio Televizionin i cili ka përgjegjësi për përmbajtjen e mediave. Së fundmi, është krijuar një Ministri për Inovimin dhe Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimeve, për menaxhimin e dixhitalizimit të shoqërisë, reformave në fushën e shoqërisë së informacionit dhe implementimin e Iniciativës së Medias Dixhitale. Në vitin 2009, qeveria nisi “Iniciativën e Shqipërisë Dixhitale”, dhe në Maj 2009 ajo miratoi një dokument të ri politike për sektorin e komunikimeve elektronike, i cili parashtron objektivat për sektorin e TIK.

3.17. **Në përputhje me angazhimet e GATS për telekomunikacionet të bëra nga Shqipëria në kohën e hyrjes në OBT,**³¹ tregu i telekomunikacioneve në Shqipëri është plotësisht i liberalizuar. Në Qershor 2007, qeveria privatizoi operatorin kombëtar Albtelecom, AKEP ka kryer tashmë analiza tregjesh dhe ka përcaktuar Albtelecom, AMC dhe Vodafone si operatorë me fuqi të ndjeshme në treg (FNT), në tregjet përkatës dhe ka zbatuar rregulla të transparencës, mosdiskriminimit për interkoneksionin. Në vitin 2003, Shqipëria krijoi edhe Autoritetin e Konkurrencës (AK). AK hetoi praktika të konsideruara anti-konkurrese në tregun celular dhe dënoi me gjobë dy operatorët celularë për abuzim me dominancën në tregun me pakicë celular.

²⁸ Sipas ligjit të komunikimeve elektronike.

²⁹ Sipas ligjit të nënshkrimit elektronik.

³⁰ Sipas ligjit të mbrojtjes së të dhënave personale.

³¹ Dokument i OBT GATS/SC/131, 22 Nëntor 2000.

3.18. **Ligji i vitit 2008 për komunikimet elektronike përcakton ‘rregullimin’ për sektorin e TIK dhe bazohet gjerësisht në legjislacionin e BE për këtë fushë.** Ligji forcon funksionet rregullatore të AKEP për përcaktimin e sipërmarrësve me FNT, për rregullimin e problemeve të interkoneksionit midis rrjeteve dhe imponimin e ofertave referencë për interkoneksionin dhe hapjen e qarkut lokal. Ligji ndihmon AKEP për të siguruar që operatorët konkurrues në pozicione të ndryshme në treg të ofrojnë linja komunikimi midis klientëve të ndryshëm të tyre mbi baza jo-diskriminuese dhe të bazuar në kosto. Ligji gjithashtu thjeshtëzon procesin e licencimit: nëse rrjetet dhe/ose shërbimet nuk kanë nevojë për burime të rralla (të tilla si radio frekuenca dhe numra), operatorët thjesht duhet të njoftojnë AKEP për qëllimet e biznesit të tyre dhe llojin e shërbimeve të ofruara. Sisteme të tilla autorizimesh janë provuar se lehtësojnë rritjen e shpejtë të shërbimeve të ndryshme të lidhura me TIK.

Implementimi i Kuadrit Rregullator

3.19. **Ofrimi i interkoneksionit në mënyrë transparente, jo-diskriminuese dhe me tarifa të bazuar në kosto është aspekti i vetëm më i rëndësishëm i rregullimit për të nxitur konkurrencën e tregut në industrinë TIK.** Kjo kërkon publikimin dhe imponimin e adaptimit të ofertave referencë të interkoneksionit (ORI) të miratuara. ORI-t e tre operatorëve me FNT janë publikuar që në muajin Shkurt 2009, që përmbajnë tarifën e interkoneksionit deri në Shtator 2010. Këto tarifa janë bazuar në tarifën mesatare benchmark të BE. Në mënyrë ideale, tarifën e interkoneksionit duhet të reflektojnë kostot afatgjatë inkrementale me qëllim nxitjen e investimeve në facilitetet e përbashkëta.³² Deri kohët e fundit mënyra e zgjedhur e AKEP për rregullimin e tarifave të terminimit ka qënë benchmark i BE (tarifa mesatare e terminimit në BE). Aktualisht tarifa e terminimit në rrjetet celulare është 10.5 lek/minutë ose 7.6 eurocent, e cila është 11 përqind më e ulët se mesatarja e BE prej 8.55 eurocent (dhe më ulët se në 13 nga 27 vende anëtare të BE).

3.20. **Tarifat e interkoneksionit janë dhe do të vazhdojnë të jenë një çështje shumë e rëndësishme për hyrësit e rinj në treg.** Në mënyrë të dukshme, pagesat për interkoneksionin që kryhen për operatorët ekzistent mundet që shpesh të arrijnë në 40 përqind të shpenzimeve të tyre (hyrësve të rinj). Përveç kësaj, operatorët me FNT gjithmonë kanë stimuj për të kundërshtuar në gjykatë elementet teknike, tarifore dhe metodologjike të interkoneksionit, duke penguar në këtë mënyrë hyrësit e rinj që të fillojnë ofrimin e shërbimeve të tyre, përveç komunikimeve brenda-rrjetit. Si rrjedhojë, hyrësit e rinj, për krijimin e bazës së tyre të klientëve, ndeshen me pengesa të krijuara nga operatori me fuqi të ndjeshme. Përvoja kudo në BE dhe vende të tjera tregon se vendosja e tarifave jo-diskriminuese të interkoneksionit të bazuara në kosto, është një proces i gjatë dhe objekt i kundërshtimeve të shumta nga operatorët me FNT.

3.21. **Një çështje shumë e rëndësishme për të arritur objektivat e reformës rregullatore është sigurimi i rregullimit të mirë të sektorit dhe transparencës së tij.** Për shembull, dhënia e licencave celulare ka qënë problematike dhe me mungesë transparence. Më problematike ishte veçanërisht dhënia e licencës së katërt, pavarësisht se AKEP kishte deklaruar se rregullat për tenderin ndërkombëtar ishin shkelur. Duket se perceptimi për vendimet e qeverisë në këtë fushë është se ato janë arbitrare. Një shembull tjetër shqetësues ishte përpjekja e autoriteteve tatimore për të deklaruar Eagle Mobile si të falimentuar për shkak të përcaktimeve ligjore që imponojnë falimentimin për çdo kompani që ka tre vjet rresht që del me humbje. Një problem më i gjerë institucional ka qënë zëvendësimi i shpeshtë i anëtarëve të bordit të AKEP, i cili ka rezultuar në kohëzgjatje mesatare të punës, duke filluar nga 2005, më të vogël se 2 vjet, krahasuar me mandatin 5 vjeçar të anëtarëve të këshillit drejtues dhe të kryetarit të tij. Efekti i këtij rotacioni shumë të shpejtë, zvogëloi perceptimin e pavarësisë së këshillit drejtues.

³² AKEP ka vendosur për përdorimin e “Bottom up Long Run Average Incremental Costs” për përcaktimin e tarifave të interkoneksionit celulare dhe fikse.

Propozime Politikash për të Ecur Përpara

3.22. **Qeveria Shqiptare e ka kuptuar rëndësinë e TIK dhe ka bërë zhvillimin e TIK një nga prioritetet kryesore të saj.** Qeveria prezantoi iniciativën “Shqipëria Dixhitale” e cila bën të nevojshme përshtetimin e penetrimit të TIK në Shqipëri. Për të arritur objektivat e “Shqipërisë Dixhitale” do të jetë e nevojshme të kryhen investime në infrastrukturë, reforma institucionale, përmirësime ligjore, rritje e kapaciteteve dhe më e rëndësishmja implementimi efektiv i këtyre politikave. Përdorimi masiv i aksesit në TIK nga bizneset dhe familjet, përfshirë ato në zonat rurale, do të sigurojë një input strategjik për ‘axhendën e re të rritjes’ në mënyrë të dyanshme.

3.23. **Implementimi efektiv i ligjit të telekomunikacioneve përbën një element shumë të rëndësishëm që nuk mund të nënvlerësohet.** Bërja realitet e konkurrencës në treg dhe lehtësimi i zhvillimit të shpejtë të të gjithë tregut të TIK do të përbente një faktor ndihmës. Për efikasitetin e ligjit, të paktën katër elementë janë veçanërisht të rëndësishëm në periudhë afatmesme deri afatgjatë: (i) rregulla efektive të interkoneksionit; (ii) portabiliteti i numrit; (iii) zhvillimi i konkurrencës së tregut; dhe (iv) ‘shtytje të madhe’ drejt zhvillimit të tregut të internetit me brez të gjerë. Për të krijuar një treg me konkurrencë të ndershme duhet të ndërmerren masa proaktive, nëpërmjet heqjes së pengesave potenciale të hyrjes në treg dhe zgjerimin e kufijve të tregjeve (Kutia 3.2). Shumica e elementëve kryesorë janë krijuar tashmë në Shqipëri-sfida më e rëndësishme ngelet implementimi i ligjeve dhe politikave të miratuara.

Kutia 3.2: Praktika të Mira për Promovimin e Aksesit me Brez të Gjerë

OECD, bazuar në vëzhgimin e politikave mbështetëse të aplikuara në vendet anëtare, ka identifikuar disa iniciativa të veçanta që mund të promovojnë investimet në Internetin me brez të gjerë. Këto përfshijnë politika që synojnë :

- përmirësimin e aksesit në infrastrukturën pasive (tubacione, shtylla dhe tuba) dhe koordinimin e punëve të hapjes së kanaleve për ndërtimin e rrjetit si një mënyrë efektive për të inkurajuar investimet efektive. Në rastin e Shqipërisë kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme pasi shumë rrugë rurale kanë ende nevojë për rehabilitim;
- sigurimin e aksesit për të drejtën e ndërtimit të rrjeteve në mënyrë të drejtë dhe jo-diskriminuese;
- inkurajimin dhe promovimin e instalimit të aksesit të hapur në infrastrukturën pasive në rastet e kryerjes së punëve publike;
- lejimin e bashkive ose kompanive të utiliteteve për të hyrë në tregjet e telekomunikacioneve. Në rastet kur ka shqetësime për shtrembërime të tregut, politikbërësit mund të kufizojnë pjesëmarrjen e bashkive vetëm në investimet bazë (p.sh. ofrimi i rrjeteve të fibrës së errët me rregulla të aksesit të hapur); dhe
- ofrimin e aksesit në një spektër më të madh radiofrekuencash (i cili është një pengesë e konsiderueshme tregu për ofrimin e aksesit pa tela në internet me brez të gjerë) dhe adoptimin e mekanizmave më të orientuar nga tregu për promovimin e përdorimit eficient të spektrit

3.24. **Për të arritur penetrim të lartë të shërbimeve cilësore me çmime të përballueshme, politik-bërësit duhet të përgatisin terrenin për një konkurrencë më intensive midis rrjeteve, veçanërisht në Internetin me brez të gjerë.** Ligji i ka dhënë fuqinë AKEP për të rregulluar tarifat e operatorëve të përcaktuar me FNT nëse AKEP arrin në përfundimin se në treg nuk ka konkurrencë efektive. Mbajtja e tarifave të ulëta mund të jetë një zgjidhje afat shkurtër për të mbrojtur mirëqenien e konsumatorëve por ajo nuk mund të jetë një strategji afatmesme apo afatgjatë. Përmirësimet me efekte afatgjata mund të arrihen vetëm nëpërmjet rritjes së konkurrencës.

3.25. **Për të rritur konkurrencën janë të nevojshme disa hapa.**

- **Së pari, për të ulur riskun e bllokimit të interkoneksionit nëpërmjet vonesave proceduriale, rekomandohet që AKEP të nxjerrë vendime të përkohshme detyruese**

për tarifatat e interkoneksionit për të cilat zakonisht ka më shumë mosmarrëveshje. Vendimet e përkohshme detyruese lejojnë hyrësit e rinj në treg të kenë akses në një treg më të gjerë gjatë një periudhe që elementët metodologjikë dhe të tarifimit janë nën shqyrtim. Pas marrjes së rezultateve finale mund të kryhet një proces kompensimi për të rregulluar diferencat midis vlerave të përkohshme dhe vlerave finale. Në marrjen e vendimeve të përkohshme rregullatori mund të përdorë tarifatat e niveleve referuese (benchmark) ndërkombëtare. Megjithatë është e rëndësishme që metoda e tarifave të bazuara në kosto të zbatohet në kohën e duhur.

- **Së dyti, për të rritur konkurrencën në tregun celular, është e nevojshme implementimi i portabilitetit të numrit.** Kjo është veçanërisht e rëndësishme për tregjet e vegjël që janë shumë të maturuar. Tregu celular Shqiptar arriti tashmë penetrimin 129 përqind në fund të vitit 2009, dhe pjesa e tregut e mbetur për operatorët e rinj mund të jetë e kufizuar nëse kostot monetare dhe jo-monetare të përdoruesve për ndryshimin e numrit janë të larta. Ligji i ri përmban përcaktime për portabilitetin e numrit dhe rolin e AKEP për të hartuar një rregullore të veçantë. Portabiliteti i numrit pritej të zbatohet nga mesi i vitit 2009, por ky implementim është vonuar. Qeveria duhet të prezantojë portabilitetin e numrit celular (dhe fiks) pa vonesa të mëtejshme. Portabiliteti jo domosdoshmërisht është teknikisht i komplikuar apo financiarisht i shtrenjtë dhe ai është një proces i zakonshëm në vendet e BE ku operatorët që janë prezent në Shqipëri kanë përvojë. Në Shqipëri mund të ketë disa vështirësi për portabilitetin e numrave fiks, meqenëse ka rreth 70 operatorë të rrjeteve fiks, por nuk duhet të ketë probleme të rëndësishme për prezantimin e portabilitetit të numrave celulare. Përdorimi i portabilitetit është shumë i varur nga tarifatat për transferimin e numrit dhe nga shpejtësia e procesit të transferimit të numrit. Koha e nevojshme për transferimin e numrit celular shkon nga disa orë në Irlandë dhe Maltë në 20 ditë në Itali dhe Sllovakia. Një proces i tillë i gjatë i transferimit të numrit do të kufizonte natyrshëm mundësinë e klientëve për të ndërruar operator. Duke prezantuar një proces me një ndalesë (one-stop-shop) dhe një sistem të integruar, koha e nevojshme për të transferuar një numër telefoni do të reduktohet në disa ditë.
- **Së treti, për të promovuar konkurrencën në treg, Shqipëria duhet të zgjerojë më fuqishëm teknologjitë alternative të rrjeteve, të tilla si 3G celular, DLS, TV kabllor dhe WiMAX.** Të gjitha këto iniciativa janë përfshirë në strategjinë e qeverisë për sektorin, kështu që hapi tjetër është përsheptimi i implementimit të tyre. Një nga alternativat e shpejta të rritjes së tregut të internetit me brez të gjerë do të ishte dhënia e licencave 3G si edhe WiMAX. Në këtë mënyrë procesi i tenderit për licencën 3G duhet të kryhet sa më shpejt. Nuk ka asnjë arsye që Shqipëria të vonojë hyrjen e këtyre teknologjive të cilat do të sjellin konkurrencë më të madhe në treg, çmime më të ulëta dhe shërbime me cilësi më të lartë.
- **Së katërti, në segmentin fiks duhet të hapet qarku lokal dhe të jepet me qera me tarifa të arsyeshme për operatorët e rrjeteve alternative.** Kjo do të kontribuonte në rritjen e rrjetit tradicional DSL. Në Shqipëri ky segment vazhdon të jetë minimal dhe i monopolizuar nga Albtelecom, megjithëse edhe operatorët e tjerë kanë të drejtë të ndërtojnë infrastrukturë. Tarifatat e dhënies me qera të qarkut lokal duhet të jenë të bazuara në kosto. Nëse Albtelecom varet në masë të madhe nga të ardhurat e tregut DSL, atëherë kjo mund të zgjidhet nëpërmjet një fondi të shërbimit universal (i cili parashikohet edhe nga ligji). Ligji i ri i kushton vëmendje të veçantë Shërbimit Universal i përkufizuar si një set i shërbimeve publike të komunikimeve elektronike me sasi dhe cilësi të specifikuar të cilat janë të disponueshme me çmime të arsyeshme për të gjithë përdoruesit pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike. Ky aspekt është veçanërisht i rëndësishëm në kushtet kur shumë zona rurale në Shqipëri nuk kanë përfituar nga zhvillimi i TIK.³³ Megjithatë

³³ Ofruesit e shërbimit universal kanë të drejtë të marrin kompensim nëse ofrimi i shërbimit shkakton kosto shtesë tek ofruesi i saj. Këto kosto llogariten si kosto neto të shërbimit nën skemën e shërbimit universal. Një

nuk duhet të ketë subvencionim të tërthortë midis tarifave të shërbimeve në segmentet konkurruese dhe jo-konkurruese.

- **Së pesti, duhet ti kushtohet më shumë vëmendje forcimit të stimujve për të investuar në infrastrukturë e cila do të mundësojë një konkurrencë më të madhe dhe çmime më të ulëta.** Kjo bën të nevojshme, veçanërisht, përcaktimin e rregullave më të qarta për “të drejtën e përdorimit (rights of way)” të tilla si parashikimi për tubacione në rrugët e reja dhe vendosjen e tyre në rrugët ekzistuese, dhe krijimin e një kuadri për përdorimin e faciliteteve të përbashkëta. Për disa prej këtyre iniciativave mund të ketë nevojë për kontribut nga shteti, për shkak të kostove të larta fillestare dhe karakteristikave të të mirave publike të këtyre investimeve. Autoritetet duhet të konsiderojnë seriozisht shtrirjen e fibrës apo tubave në të gjitha projektet e rrjeteve (p.sh. rrugët apo transmetimi i energjisë elektrike) me kosto marxhinale të ulët me qëllim për të rritur mbulimin kombëtar me broadband në si edhe mundësinë për të qenë një vend hub. Kjo infrastrukturë mund të përdoret më pas në bazat e ‘aksesit të hapur’. Në këto raste është e domosdoshme që AKEP të miratojë një kuadër për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, veçanërisht në zonat rurale dhe për lehtësimin dhe saktësimin e çështjeve të së drejtës të përdorimit/ndërtimit.
- **Së fundmi, që Shqipëria të hyjë në një rreth virtual dhe të rrisë ndjeshëm penetrimin e internetit ajo mund të ketë nevojë për një “shtysë të madhe” në anën e kërkesës. Kjo për faktin se tregjet e TIK tentojnë të zhvillohen me shpejtësi pasi është arritur një nivel i caktuar (niveli kritik) i saj.** Disponibiliteti më i madh i përmbajtjes tërheqëse do të stimulojë kërkesën. Qeveria ka mundësi të marrë drejtimin në krijimin e kërkesës nëpërmjet implementimit të qeverisjes elektronike (e-government), duke filluar me prokurimet elektronike të cilat do të inkurajojnë ofruesit të përfitojnë aftësi të lidhura me përdorimin e internetit për të pasur mundësinë e dhënies së ofertave për kontratat e qeverisë. Shembujt në vendet e tjera në tranzicion ilustronë rëndësinë e forcimit të anës së kërkesës në tregjet TIK. Për shembull, Lituania si strategji për zhvillimin e internetit me brez të gjerë u fokusua në stimulimin e kërkesës për TIK, veçanërisht në zonat rurale. Qeveria e Lituanisë synon të ofrojë lidhje me brez të gjerë të gjitha institucioneve dhe zyrave të administratës publike. Ajo gjithashtu synon të ofrojë rrjete me brez të gjerë të gjitha SME-ve, nëpërmjet investimit në 3,000 km linja me fiberoptike në zonat rurale si edhe stimulimin e kërkesës për shërbimet me brez të gjerë, përfshirë edukimin elektronik, e-government dhe tregtinë elektronike (Banka Botërore, 2006). Stimulimi i kërkesës në zonat rurale duket se është më i vështiri, por edhe atje ekzistojnë mundësitë dhe Posta Shqiptare po zhvillon tashme pika të aksesit publik të internetit në zonat rurale.

III. ENERGJIA ELEKTRIKE

Situata e Sektorit të Energjisë Elektrike

3.26. **Gjatë katër viteve të fundit janë bërë përpjekje të mëdha për të përmirësuar furnizimin me energji elektrike.** Reformat nisën nga nevoja për të zgjidhur problemet e sistemit të cilat dolën në pah në mesin e viteve 2000, kur rritja ekonomike e shtyu sistemin drejt limiteve të tij të furnizimit me energji elektrike. Energjia hidrike përbën mesatarisht rreth 95 përqind të prodhimit aktual të brendshëm të energjisë elektrike në Shqipëri. Në dekadën e fundit, gjatë viteve me reshje të ulëta, kombinimi i motit të thatë, tarifave të shijes me pakicë nën kosto, humbjeve të larta në rrjet (teknike


Fond i Shërbimit Universal do të krijohet dhe financohet nga kuotat mbi të ardhurat vjetore të ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve publike elektronike. Sigurisht që do të duhet kohë që fondi të akumulojë fonde të mjaftueshme financiare nga klientët aktualë për të ofruar shërbime me çmime të arsyeshme atyre që nuk shërbehen mjaftueshëm.

dhe jo-teknike), niveleve të ulëta të arkëtimit dhe kërkesës në rritje, bëri që KESH të siguronte furnizimin me energji duke pësuar humbje ose duke zbatuar ndërprerje të gjata të energjisë. Periudha shumë e thatë në vitin 2007 rezultoi në ndërprerje të shpeshta të furnizimit dhe në humbje financiare. Në vitin 2008, i ndihmuar nga kushte më të favorshme moti, KESH përmirësoi situatën e furnizimit por vazhdoi të akumulonte humbje dhe borxhe. Në të njëjtën kohë, në procesin e përgatitjeve për privatizim, KESH u nda duke krijuar një kompani të re shpërndarjeje (OSSH). OSSH, tashmë në pronësi private, administron operimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe shërbimin e furnizimit me pakicë publik.

3.27. **Roli i KESH-it nuk mund të nën-vlerësohet.** KESH është kompania më e madhe në sektorin e energjisë elektrike të Shqipërisë, në bazë të vlerës së tregut të aseteve. KESH zotëron rreth 1.4 GW kapacitet hidroenergjetik. Megjithatë, vlera e aseteve të tij ka rënë pasi ai merr vetëm rreth një të pestën e të ardhurave të mundshme të tregut. Sipas strukturës aktuale të tregut në Shqipëri, KESH fokusohet në dy aktivitete kryesore: (i) Prodhimi (KESH Gen) i cili mirëmban kapacitetet prodhuese ekzistuese (hidrike) dhe prodhon energji për të mbuluar kërkesat e përdoruesve fundorë me një çmim të rregulluar për Furnizuesit Publik me Shumicë (FPSH); dhe (ii) FPSH i cili vepron si një furnizues tipik bazuar në detyrimin publik për të blerë energji elektrike nga KESH Gen (prodhuesi kryesor aktualisht), nga Prodhuesit e Pavarur të Energjisë Elektrike (PPE) me çmim të rregulluar dhe nga tregu, për të plotësuar nevojat e përdoruesve fundorë në Shqipëri.

3.28. **Arkëtimi e faturave dhe pagesave të energjisë elektrike bëhet në nivelin e shpërndarjes.** Të ardhurat më pas shpërndahen dhe transferohen tek pjesët e transmetimit dhe furnizimit të sistemit. Megjithatë, humbjet e larta në shpërndarje, të kombinuara me arkëtimet e ulëta të energjisë elektrike të faturuar, kanë bërë që KESH, për disa vite, të arkëtojë vetëm rreth 50 përqind të energjisë elektrike të furnizuar nëpërmjet rrjetit të tij, ose rreth 80 përqind të energjisë elektrike të faturuar pas marrjes parasysh të humbjeve teknike dhe tregtare. (Shiko Tabelën 3.1). Duhet të vihet në dukje që të dhënat në këtë tabelë tregojnë vetëm sasinë e energjisë së furnizuar. Për të arritur në shifrën totale të kërkesës, nevojitet të shtohet sasia e ngarkesës që është kufizuar (Figura 3.9).

Figura 3.9: Furnizimi me Energji Elektrike dhe Ndërprerjet



Burimi: KESH; 2010 është parashikim.

3.29. **Performanca e dobët e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike e la KESH-in me para të pamjaftueshme për të investuar në mirëmbajtjen, funksionimin dhe zgjerimin e duhur të sistemit të tij.** Për më tepër, mungesa e fondeve e pengoi atë që të ishte në gjendje të paguante të gjithë energjinë elektrike të nevojitur për të kompensuar rënien në prodhimin e brendshëm të energjisë. Kompanisë i janë dashur transfertat të konsiderueshme të drejtpërdrejta nga shteti në vitet 2000-2004, 2007 dhe 2008.

3.30. **Qeveria, duke parë problemet në modelin e administrimit, vendosi të ristrukturojë KESH-in.** Ajo adoptoi një model të ri tregu për sektorin e energjisë elektrike në përputhje me angazhimet e saj si anëtare e Komunitetit të Energjisë³⁴, dhe ndau operatorin e sistemit të shpërndarjes me pakicë nga KESH, duke e bërë atë një

Tabela 3.1: Performanca e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010p
Furnizimi total	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Humbje Transmetimi	5.8	4.5	3.7	3.7	3.4	3.2	3.2
Humbje shpërndarjeje	33.9	36.4	37.7	32.8	32.0	32.2	28.5
Fatura të papaguara	9.8	11.7	11.4	6.5	9.8	15.3	8.3
Fatura të paguara	50.5	47.4	47.2	57.0	54.8	49.4	60.0

Burimi: KESH Shënim: të dhënat për vitin 2010 janë parashikime. Faturat e paguara përfshijnë edhe grumbullimin e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

kompani të re aksionere me ortakëri (OSSH). Paralelisht, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) përgatiti rregullore, licenca dhe metodologji tarifash të reja për pjesëmarrësit e ndryshëm në sektorin e reformuar të energjisë elektrike. Privatizimi u përfundua me sukses me nënshkrimin e një Marrëveshjeje të Blerjes së Aksioneve në Mars 2009, ku CEZ, korporata energjetike çeke, pagoi 102 milionë € për 76 përqind të aksioneve të OSSH

3.31. **OSSH e privatizuar funksionon sipas dy licencave tridhjetë vjeçare.** Këto licenca janë (i) një Licencë si Operator i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) për 30 vite me të drejtën ekskluzive për t'i shërbyer të gjithë Shqipërisë; dhe (ii) një Licencë si Furnizues Publik me Pakicë (FPP) për 30 vite me të drejtën ekskluzive për të furnizuar me energji elektrike klientët tarifor. Licenca FPP i jep OSSH-së të drejtën për të blerë energjinë elektrike të destinuar për konsumatorët fundorë nga Furnizuesi Publik me Shumicë (FPS), i cili do të mbetet shtetëror (aktualisht si një pjesë e KESH-it). Aktualisht, FPS është e detyruar të furnizojë OSSH-në me të paktën 4800 GWh energji elektrike në vit. Blerjet nga FPS kryhen në bazë të një tarife të rregulluar, ashtu siç ndodh për klientët tarifor fundorë. FPS do të blejë, me çmim të rregulluar, të gjithë energjinë elektrike të prodhuar nga KESH. Nëse kjo është e pamjaftueshme për të kënaqur minimumin për të cilin ka rënë dakord për të furnizuar OSSH-në, FPS do të importojë pjesën e mbetur. Në të vërtetë, kjo e bën FPS “furnizuesin e zgjidhjes së fundit”, përgjegjës për sigurinë e përgjithshme të furnizimit në Shqipëri. Ky model ofron një stimul të fortë për reduktimin e shpejtë të humbjeve në shpërndarje.

3.32. **Përveç kësaj, bazuar në Kuadrin Rregullator të miratuar, OSSH e privatizuar duhet të plotësojë disa objektiva performance.**³⁵ Konkretisht, OSSH duhet (i) të reduktojë humbjet e shpërndarjes nga 34 përqind në vitin 2009 në 17 përqind deri në vitin 2014; (ii) të rrisë nivelin e arkëtimeve nga 76 përqind të faturimit në vitin 2009 në 91 përqind deri në vitin 2014; (iii) të përmirësojë eficiencën operative; dhe (iv) të përmirësojë cilësinë e furnizimit me energji elektrike. Me qëllim që të realizojë këto përmirësime, CEZ pret që OSSH të investojë rreth 240 milionë Euro në pesë vitet e para të funksionimit pas privatizimit. Ndërsa OSSH në vitin 2009 operoi me një tarifë që

³⁴ Traktati ndërkombëtar i Komunitetit të Energjisë është një element i rëndësishëm i një strategjie të zhvilluar nga shtetet anëtare të Evropës Juglindore dhe BE për të siguruar akses në një furnizim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm me energji elektrike. Krijimi i një zone pa kufij të brendshëm për energjinë kontribuon në përparimin ekonomik dhe social dhe një nivel më të lartë punësimi si dhe zhvillim të balancuar dhe qëndrueshëm. Gjithë vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë kanë perspektivën e anëtarësimit të BE, dhe Traktati i Komunitetit të Energjisë kërkon nga anëtarët të zbatojnë Direktivën 2003/54/EC (energji elektrike).

³⁵ Kuadri Rregullator është inkorporuar në Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve të nënshkruar midis qeverisë dhe CEZ, me një Garanci të Pjesëshme për Riskun të dhënë nga Banka Botërore që garanton që autoriteti rregullator (ERE) do të respektojë skedarin e rritjes së tarifës në linjë me rekuperimin e kostove dhe me kusht që CEZ të realizojë nivelet e synuara të performancës.

është nën nivelin e mbulimit të kostove, Kuadri Rregullator përmban dispozita specifike për rimbursimin e OSSH për humbjet financiare në vitet pasardhëse.

3.33. **Një sfidë të rëndësishme është arritja e besueshmërisë të strukturës së re.** Nxitja e konsumatorëve për të respektuar lidhjet, matjet dhe pagesat është mjaft e ulët nga historia e gjatë e shërbimit jo të sigurt në këtë sektor. Për këtë arsye, do të jetë e rëndësishme që autoritetet të mbështesin masat e ndërmarra nga OSSH për të rritur arkëtimet dhe për të rritur çmimet drejt nivelit që siguron mbulimin e plotë të kostove. Në mënyrë shumë të rëndësishme, ERE është angazhuar të rrisë gradualisht tarifën mesatare të ponderuar të përdoruesit fundor me 15 përqind në terma reale nga Janari 2010 deri sa tarifa të arrijë nivelet e mbulimit të kostos. OSSH do të rimbursohet për çdo humbje financiare deri në fund të vitit 2012 ndërkohë që tarifatat mbetet nën mbulimin e kostos. Tarifatat në vitet e mëpasshme parashikohen të ulen ndërkohë që kompania plotëson synimet e saj progresive ambicioze për humbjet e shpërndarjes dhe arkëtimin e të ardhurave, të cilat janë përcaktuar në Kuadrin Rregullator.

Ndikimi në Sektorin Privat i Furnizimit me Cilësi të Ulët të Energjisë Elektrike

3.34. **Deri para vitit 2008, qëndrueshmëria dhe cilësia e ulët e furnizimit me energji elektrike citohej si pengesa më e madhe për të bërë biznes.** Për shkak të ndërprerjeve të energjisë, shumë firma blenë gjenerator (naftë) për të garantuar vazhdimin e prodhimit, gjë që rriti kostot e tyre të prodhimit. Gjithashtu për shkak të luhatjeve të mëdha të tensionit, firmat që përdornin pajisje të sofistikuar (të ndjeshme ndaj tensionit) iu desh të blinin pajisje shtesë (p.sh. invertera, stabilizatorë etj) për të parandaluar dëmtimin ose shkatërrimin e tyre. Megjithëse këto pajisje shtesë mund të ofronin mbrojtje nga ndryshimi i tensionit, shumë firma shprehën ngurrim për të investuar në pajisje të sofistikuar.

3.35. **Megjithëse furnizimi me energji elektrike është përmirësuar ndjeshëm, me më pak ndërprerje të furnizimit me energji (dhe asnjë për shkak të ‘mungesës’ së energjisë elektrike), shumë biznese akoma mbajnë sistemet e tyre të mbrojtjes ose e perceptojnë akoma me rrezik përdorimin e pajisjeve të sofistikuar (Kutia 3.3).** Për rrjedhojë, shumë përdorues të mëdhenj të energjisë elektrike nuk kanë dashur të përdorin rrjetin elektrik apo energjinë elektrike të furnizuar nga ofruesit publik (FPS-KESH dhe FPP-OSSH).

Kutia 3.3: Prodhuesit me Përdorim Intensiv të Energjisë Elektrike në Shqipëri

Seament, një fabrikë çimentoje e krijuar në vitin 2007, nuk mbështetet tek KESH për energjinë elektrike, kryesisht për arsye se furnizimi nuk është i sigurt. Ajo bleu gjeneratorë me naftë (tre njësi me 8 MW) dhe importon naftën e saj me kamion nga Maqedonia. Kostoja e tyre për prodhimin e energjisë vlerësohet të jetë deri në 16 Lek për kWh për shkak të çmimeve të larta ndërkombëtare të naftës, por vazhdueshmëria dhe stabiliteti i furnizimit me energji janë të pazëvendësueshme për kompaninë. Kurum, një prodhues çeliku, është një nga konsumatorët më të mëdhenj të energjisë i cili merr rreth 5 përqind të energjisë elektrike të prodhuar nga KESH. Megjithëse Kurum, një “klient i kualifikuar”, plotëson kushtet për të importuar drejtpërdrejt nga jashtë (duke anashkaluar FPS/KESH) nuk ka zgjedhur ta bëjë këtë megjithëse rrezikonte përballjen me ndërprerje të mëdha. Prodhuesi i kromit ACR në Elbasan, i cili është një klient tjetër i madh “i kualifikuar” i energjisë në Shqipëri, për më shumë se katër vite (2006-2009) është furnizuar nga një furnizues që plotëson kushtet. Në këtë rast energjia elektrike u importua nga jashtë. Gjatë vitit 2010 një kompani (Titan) ka filluar tashmë të furnizohet nga jashtë dhe një tjetër do të bëjë të njëjtën gjë. Të dyja kompanitë janë fabrika çimentoje.

3.36. **Ndaj, rikthimi i besueshmërisë në furnizimin e qëndrueshëm me energji elektrike është shumë i rëndësishëm.** Faktikisht, pavarësisht tarifave nominale relativisht të ulëta të energjisë elektrike të ofruar për publikun (me rreth 10 Lek për KWH), kostoja e vërtetë për firmat që përdornin gjeneratorë me naftë është zakonisht të paktën tre herë më e lartë-dhe përsëri shumë firma zgjedhin këtë alternativë më të shtrenjtë (Figura 3.10 dhe 3.11, si edhe Tabela 3.2). Gjithashtu pronarët e gjeneratorëve duhet të importojnë lëndën djegëse nga jashtë vendit në sasi të vogla. ERE vlerëson që kostot e prodhimit me naftë janë 44.14 Lek/KWH. Gjithashtu, luhatjet e kërkesës nga llojet e

ndryshme të konsumatorëve nuk mund të grupohen. Nëse furnizimi me energji nga rrjeti do të ishte më i sigurt, këto kosto inefficience mund të shmangeshin lehtësisht.

Figura 3.10: Çmimet e Energjisë Elektrike në Shqipëri, € Cent Për KWH





Figura 3.11: Krahasimi i Çmimeve të Energjisë Elektrike, 2007, € Cent Për KWH



Shënim: Të dhënat i referohen tarifave tipike për përdoruesit mestar të biznesit, dhe konsumin mbi 300KWH për familjet.

Burimi: KESH dhe ERE

Burimi: Eurostat.

Trajtimi i Rreziqeve dhe Sfidave të Tjera

3.37. **Sistemi i energjisë elektrike i ka mundësitë për të përballuar plotësisht kërkesën e Shqipërisë në një periudhë afatmesme dhe të sigurojë një furnizim të sigurt 24 orë me energji elektrike.** Kërkesa për energji pritet të rritet me një normë disi më të ulët gjatë periudhës së pas-krizës. Për më tepër, tregu (veçanërisht familjet) tani është afër pikës së ngopjes, ndërkohë që me reduktimin e humbjeve të shpërndarjes do të ketë disponibilitet të energjisë elektrike për furnizim shtesë. Pritet që në disa vite të ardhshme kërkesa për energji elektrike të jetë në intervalin 7000-7500 GWh. Nga kjo, KESH mund të mbulojë mesatarisht 4,000-5000 GWh nëpërmjet prodhimit të brendshëm, ndërsa pjesa e mbetur e kërkesës do të duhet të mbulohet nga importet.

3.38. **Qeveria duhet të gjejë mënyra efektive për të rritur kapacitetin prodhues, veçanërisht nëpërmjet projekteve të vogla.** Në kuadër të ligjit të koncesioneve, janë dhënë koncesione të shumta të ‘pakontestuara’ për projekte të hidrocentraleve të vegjël dhe të mesëm. Megjithatë, pavarësisht dhënies së 90 koncesioneve që arrijnë një total prej disa qindra Megavat vetëm një prej tyre ka hyrë në funksionim dhe pesë të tjerë janë duke u ndërtuar. Shumë nga këto koncesione ka mundësi të kenë tejkaluar termat kohorë të kontratës dhe rrezikojnë të anulohen nga Qeveria për shkak të mosperformancës. Por problemi kryesor me koncesionet e pakontestuara lidhet me përgatitjen e dobët të shumë prej tyre që në ndonjë rast mund të jenë blerë thjesht për qëllime spekulative dhe jo për të ngritur një biznes serioz. Analiza e performancës së koncesioneve të pakontestuara do të bënte të mundur që autoritetet të ndërprisnin ato koncesione që kanë shkelur tashmë kushtet e kontratës dhe të kufizojë përdorimin e tyre në të ardhmen.

3.39. **Si një alternativë ndaj dhënies së koncesioneve për propozimet e pakontestuara, Qeveria mund të marrë drejtimin në përgatitjen e specifikimeve të hollësishme teknike për këto projekte, dhe më pas t’i shesë me një proces transparent ankandi.** Një shembull i suksesshëm i një tenderi konkurrues i mirë-përgatitur është hidrocentrali i Ashtës. Projekti është një partneritet publik-privat (PPP) në sektorin e energjisë, në të cilin Verbund, kompania më e madhe e energjisë elektrike në Austri, fitoi koncesionin 35 vjeçar për të ndërtuar dhe operuar hidrocentralin e Ashtës, i pari hidrocentral i madh i ndërtuar në Shqipëri në 30 vite. Verbund do të investojë më shumë se 220 milionë US\$ në projekt, i cili do të ketë një kapacitet të instaluar prej 48 MW dhe prodhim mesatar prej 220 GWh në vit. E njëjta metodë mund të ndiqet edhe për energjinë e erës, ku duket se ka po aq interes të lartë. Qeveria duhet të rishikojë mundësitë për partneritete private-publike në sektorin e energjisë elektrike të cilat mund të sjellin investime të reja, përfshirë investime të huaja, në sektor dhe që mund të shtojnë kapacitet prodhuese me disa qindra MW me nivel të ulët karboni.

3.40. **Edhe KESH mund të transformohet në një burim për investimet e reja të furnizimit të energjisë.** Mungesa e fondeve për të investuar në modernizimin e faciliteteve ekzistuese dhe eksplorimin e projekteve të reja ka bërë që KESH të operojë në nivele shumë më të ulëta se potenciali i tij. Kjo mund të adresohet nëpërmjet një partneriteti me një investitor strategjik. Kompania në të kaluarën, në vend që të krijonte një vizion strategjik për përmirësimet, ka pasur tendencën e zgjidhjes së problemeve në mënyrë ad hoc dhe shpesh në varësi të ndryshimeve të motit. Gjithashtu, kompania vazhdon të jetë objekt i ndërhyrjeve jot ë duhura politike. Në mënyrë që KESH të bëhet një kompani moderne e cila do të kontribuojë pozitivisht në plotësimin e nevojave në rritje për energji elektrike në Shqipëri, këto pengesa duhet të tejkalohen. Së fundmi, është e nevojshme gjithashtu që të rritet eficientia dhe zhvillimi i ardhshëm i sistemit të transmetimit.

Tabela 3.2: Tarifat e Energjisë Elektrike në Shqipëri (Lek për KWH)

Klasifikimi	2006	2007	2008	2009	2010s
Tension i lartë					
Buxhetor	4.5	4.5	7.0	7.5	8.5
Privat	4.5	4.5	7.0	7.5	8.5
Tension i mesëm					
Buxhetor	9.4	9.4	9.5	9.5	11.5
Privat	7.0	7.0	8.0	8.0	9.1
Tension i ulët					
Buxhetor	10.0	10.0	12.0	12.0	14.0
Privat	8.0	8.0	9.5	9.5	10.5
Volum i ulët, vendas	7.0	7.0	7.0	7.0	7.7
Volum i lartë, vendas	7.0	7.0	12.0	12.0	13.5
Tarifa Mesatare (Lek)	7.2	7.0	7.9	8.4	9.5
Tarifa Mesatare (€ cent)	5.9	5.6	6.4	6.3	6.9

Burimi: ERE; s-i planifikuar.

3.41. **Në të ardhmen, rreziqet kryesore në sektorin e energjisë elektrike janë kryesisht të një natyre rregulatore dhe institucionale dhe më pak teknike.** Megjithatë kapacitetet prodhuese termike shtesë mund të përdoren si një sistem rezervë strategjik në rrethana ekstreme, çështjet më të rëndësishme lidhen me garancinë që: (i) rregullatori krijon një mjedis në të cilin OSSH është e aftë të investojë në mirëmbajtjen e rrejtës së shpërndarjes (e cila do të sjelli zvogëlimin e humbjeve në shpërndarje); (ii) ndiqen politika të përshtatshme tarifore për të siguruar që ka burime të disponueshme për të mbuluar luhatjet në prodhimin nga hidrocentralet, dhe (iii) Qeveria të kërkojë mënyra për të rritur kapacitetin prodhues, veçanërisht nëpërmjet projekteve të vogla por eficiente hidrike dhe me erë. Arritja e një furnizimi të qëndrueshëm me energji elektrike do të reduktojë drejtpërdrejt kostot e biznesit dhe do të lehtësojë investimet, veçanërisht në pajisjet e sofistikuara elektronike, të cilat janë më të ndjeshmet ndaj luhatjeve të furnizimit me energji elektrike.

3.42. **Kuadri rregullator duhet të garantojë që tarifat vendosen në nivele që mbulojnë kostot mesatare afatgjata të furnizimit me energji, duke mbajtur njëkohësisht parasysh ndikimet mbi shtresat e varfra dhe në nevojë të popullsisë.** Kjo është arritur për tarifën e pakicës pas rritjeve të njëpasnjëshme të tarifave nga viti 2008 deri në 2010 pas një periudhe stanjacioni dhe madje reduktim të tarifave në 2006 dhe 2007. Familjet e varfra shpenzojnë mesatarisht 7 përqind të buxhetit të tyre për energji elektrike, që është më e vogël se në vendet e tjera fqinje (në Serbi, për shembull, ajo është 12 përqind për shkak të varësisë më të madhe nga energjia elektrike për qëllime ngrohjeje).³⁶ Megjithatë, kjo pjesë duket që po rritet me kalimin e kohës (me 43 përqind ndërmjet viteve 2005 dhe 2008), dhe ka mundësi të vazhdojë të rritet përsëri.


3.43. **Aktualisht, përpjekjet për të garantuar një nivel bazë të konsumit të energjisë për të varfrit adresohen nëpërmjet (i) strukturës së tarifave dhe (ii) subvencioneve që ofrohen nëpërmjet sistemit të mbrojtjes sociale.** Struktura e tarifave bën të mundur që nivelet më të ulëta të

³⁶ Për të pasur një ide rreth rëndësisë, konsideroni që shpenzimi i më shumë se 10 përqind të buxhetit familjar për energji (tw përgjithshme, jo vetëm ajo elektrike) zakonisht shihet si një shenjë e një stresi të madh, kështu që një prag 10 përqind supozohet që identifikon familjet në “varfëri energjetike”.

konsumit të energjisë kanë një çmim më të ulët. Kjo lloj strukture tarifore mund të hartohet në mënyrë të tillë që të garantojë që familjet e mbulojnë nevojat e tyre bazë për energji me çmime të arsyeshme. Megjithatë, ndërkohë që 79 përqind e të varfërve konsumojnë brenda kufirit të bllokut me tarifë të ulët, edhe 64 përqind e jo të varfërve konsumojnë brenda këtij limiti. Kjo sugjeron që blloku i parë i konsumit mund të jetë tepër i gjerë për të garantuar vetëm konsumin “jetësor”. Gjithashtu, për energjinë elektrike ofrohen subvencione nëpërmjet sistemit të mbrojtjes sociale, dhe kryesisht nëpërmjet programit të Ndhmës Ekonomike, i fokusuar tek të varfrit. Megjithatë, vetëm 12.4 përqind e të varfërve përfitojnë nga këto masa të mbrojtjes sociale. Megjithëse targetimi i Ndhmës është efikas (56 përqind e përfitimeve i shkojnë kuintilit më të ulët (të fundit)), mbulimi i programit është shumë i ulët (mbulon vetëm 21 përqind e kuintilit të fundit). Gjithashtu, ky program përmban një kusht shtesë për përfitimin e subvencioneve, atë të kryerjes së pagesave të plota të energjisë elektrike. Fatkeqësisht ky kusht rëndon në mënyrë jo proporcionale mbi familjet e varfra pasi kushti vështirëson kualifikimin e tyre për të marrë asistencë.

3.44. Në të ardhmen, është e nevojshme që politikat për të ndihmuar të varfrit të ristrukturohen me qëllim që ato të kenë një ndikim më të fokusuar dhe eficient. Nga të dy instrumentet e përdorur aktualisht, struktura e tarifës duket të jetë një instrument tepër i shtrenjtë për të mbrojtur të varfrit (për shkak se ka rrjedhje të lartë për tek grupet me më shumë të ardhura) dhe subvencionimi nëpërmjet ndihmës sociale duket relativisht inefektiv për shkak të mbulimit të ulët. Kështu që, një detyrë e rëndësishme për të ardhmen në mënyrë që të sigurohet zbatueshmëria e politikave të strukturës tarifore, është hartimi i një sistemi i cili ofron mbrojtje për grupet e varfra të popullsisë duke shmangur subvencionet për pjesës tjetër të popullsisë. Një metodë e tillë ndoshta do të përfshinte dhe shmangien e tarifave më të ulëta për konsumatorët industrialë dhe buxhetorë në krahasim me konsumatorët familjarë.

Figura 3.12: Humbjet në Shpërndarje, Matjet dhe Arkëtimet



Burimet: KESH, OSSh, dhe ERE

3.45. Struktura e re tarifore është e nevojshme por jo e mjaftueshme për t'i dhënë siguri financiare sektorit energjetik. Humbjet në shpërndarje duhen reduktuar deri në nivelin e fqinjëve, të cilët kanë humbje në rreth 15 përqind të furnizimit total me energji, krahasuar me nivelin aktual në Shqipëri prej më shumë se 30 përqind (Figura 3.12). Gjithashtu, nivelet e arkëtimit duhet të rriten në 93 përqind krahasuar me nivelet e tanishme prej rreth 85 përqind. Pritet që këto objektiva të arrihen deri në vitin 2014, por për këtë, do të jetë e nevojshme të ndërmerren një sërë masash, kryesisht nga OSSH. Së pari, matja e të gjithë sasisë së konsumuar (pajisja me matësa të energjisë elektrike të të gjithë përdoruesve) është thelbësore për të bërë konsumatorët të ndërgjegjshëm për kostot marxhinale të konsumit (kjo do të kontribuojë sidomos në uljen e mbi-konsumit përfshirë ngrohjen me energji elektrike), si dhe për ta bërë transparent dhe të drejtë sistemin e faturimit. Një element i dytë për reduktimin e humbjeve dhe rritjes së faturimit është që subjekteve shtetërore t'u kërkohej të paguajnë faturat e tyre në kohë. Rritja e mos-arkëtimeve gjatë vitit 2009, ndërkohë që procesi i privatizimit po finalizohet, erdhi si rezultat i mos-paguesës së faturave nga subjektet shtetërore. Megjithatë, tani duket që OSSH po tregohet proaktive duke ndërprerë furnizimin me energji për institucionet që nuk paguajnë, që do të ndihmojë rritjen e nivelit të arkëtimeve.

3.46. Për arritjen e objektivave të mësipërme mund të ndihmojnë edhe politikat e palëve të tjera të interesuara. Së pari, qeveria mund të japë një kontribut të rëndësishëm duke bërë të të qartë se do të mbështesë përpjekjet e OSSH për të ndërprerë shërbimin për mos-paguesit dhe në veçanti për të ndëshkuar subjektet publike që nuk paguajnë faturat e utiliteteve. Së dyti, politika e tarifave nuk duhet të përdoret për të subvencionuar industrinë. Historikisht ka pasur një prirje për të favorizuar tarifa të ulëta për konsumatorët industrialë me lidhje të tensionit të lartë (110 kV ose më shumë). Megjithëse këto tarifa u rritën nga viti 2008 në 2010, (shiko Tabelën 3.2) ato janë ende më të ulëta se

tarifat e që u ofrohen konsumatorëve të energjisë me tension të ulët dhe të mesëm. Kjo është e pranueshme deri në atë pikë që kostot e furnizimit të energjisë me tension të lartë janë më të ulëta se për furnizimin me tension të ulët dhe të mesëm. Megjithatë, është e rëndësishme që tarifat më të ulëta të mos përdoren si një mjet për të mbështetur ndërmarrjet ose industrinë, meqenëse kjo mund të nxisë një zgjerim të paqëndrueshëm të sektorëve që me përdorim të lartë të energjisë. Siç u theksua dhe më parë, shumica e firmave janë të gatshme të paguajnë çmime më të larta për të pasur furnizim më të qëndrueshëm energjie.


3.47. **Tarifimi në bazë të kostos për furnizimin me tension të lartë do të nxiste klientët e kualifikuar për të blerë energjinë elektrike drejtpërdrejt nga tregu ndërkombëtar rajonal (Kutia 3.4).** Blerja e energjisë nga OSSH do të mbetej një nga mundësitë, për sa kohë ruhet cilësia e shërbimit. Një mënyrë tjetër që Shqipëria të shkojë drejt një mekanizmi të tillë të tregut të liberalizuar, është krijimi i një tregu të drejtave të transmetimit. Në vend që të mbështetet mbi rezultatet e tregut në vendet fqinje, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) mund të ketë nevojë të zhvillojë mekanizmin e vet të ankandit për të shpërndarë të drejtat e transmetimit, të cilat do të krijonin të ardhura të mjaftueshme për të investuar dhe për të mirëmbajtur siç duhet sistemin e transmetimit.

Kutia 3.4: Marrëveshjet e Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri

Sistemi i energjisë elektrike të Shqipërisë aktualisht është i lidhur me tre vende fqinje: Mali i Zi (220 kV), Kosova (220 kV), dhe Greqia (400 kV). Ai u përball me një kufizim në kapacitet për importimin e energjisë elektrike gjatë viteve 2005-2008. Investimet e kohëve të fundit për përmirësimin e lidhjes me Malin e Zi (një linjë e re interkoneksioni 400 kV prej 43 milionë Euro) dhe linjat veriore të transmetimit (12.5 milionë Euro) do të heqin kufizimet kryesore të kapacitetit të transmetimit në afat të shkurtër. Një linjë e re 400 kV midis Shqipërisë dhe Kosovës pritet të përfundojë në dy deri tre vitet e ardhshme. Në një periudhë afatgjatë mund të ketë nevojë për investime shtesë për një linjë 400 kV me Maqedoninë dhe një zgjerim të mundshëm me Italinë nëpërmjet një kabloje nëndetare DC.

Aktualisht, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) i Shqipërisë nuk ka futur tenderimin e tij konkurrues për shpërndarjen e të drejtave të transmetimit. Nëse ka ndonjë kapacitet shtesë, konsumatorët e mëdhenj (klientët e kualifikuar) mund të importojnë energji elektrike nga prodhuesit/furnizuesit privatë të energjisë, duke paguar çmimin e tregut për kapacitetin e transmetimit, i cili aktualisht i referohet rezultatit të ankandit në Malin e Zi dhe Serbi. Ai luhet nga 1 në 10 Euro për MWh, në varësi të stinës. Gjithashtu, blerësit e energjisë duhet të paguajnë një tarifë uniforme të transmetimit prej 0.5 Lek për kwh tek OST për shërbimet e transmetimit dhe ato ndihmëse që për vitin 2010 është 0.6 Lek/kwh. Tarifa e transmetimit në praktikë vlen vetëm për OSSH dhe Klientët e Kualifikuar. Për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të transmetimit, OST duhet të jetë në gjendje të zbatojë tenderimin e vet konkurrues për të shpërndarë kapacitetin e transmetimit ndaj blerësve/treguesve të energjisë (përfshirë KESH), siç kërkohet nga standardet e BE. Një veprim tjetër i rëndësishëm që do të rriste sigurinë e OST si dhe do të jepte një sinjal pozitiv për subjektet ekzistuese dhe ato të reja të prodhimit të energjisë, do të ishte dhe adoptimi i një tarife transmetimi për energjinë e prodhuar në vend.


Figura 3.13: Oferta dhe Kërkesa e Parashikuar për Energjinë Elektrike në Shqipëri, Sipas Kuadrit të Ri Rregullator



Burimi: KESH. Vini re se ndryshimi midis ofertës dhe kërkesës nënkupton ndërprerjet

3.48. **Kuadri rregullator i krijuar pas privatizimit të OSSH, vendosi disa objektiva për reduktimin e humbjeve dhe rritjen e arkëtimeve.** Mbi këtë bazë parashikohet që deri në vitin 2011, sistemi do të ketë kapacitetin për të plotësuar të gjithë kërkesën aktuale, dhe me vazhdimin e reduktimit të humbjeve deri në vitin 2015 të mundësohet plotësimi i kërkesës së rritur të sistemit (Figura 3.13). Kuadri tarifor krijon hapësira të mjaftueshme për importet në vite normale hidrologjike, por edhe në rastin e kërkesave për importe shtesë, çmimet vendore të energjisë janë pranë atyre që mbizotërojnë në Bursën Evropiane të Energjisë madje dhe në nivelet e tyre kulmore (Figura 3.14).

Figura 3.14: Çmimi Mesatar për Energjinë Bazë në Bursën Evropiane të Energjisë



Burimi: Bursa Evropiane e Energjisë

3.49. **Megjithatë, në periudhën afatgjatë, Shqipëria ka nevojë të mundësojë më shumë investime në kapacitetin prodhues të energjisë dhe të forcojë lidhjet e transmetimit me rrjetin rajonal të energjisë.** Reduktimet e mëtejshme të humbjeve në transmetim dhe shpërndarje së bashku me një strukturë tarifore që motivon konsumatorët të përdorin energjinë më me zgjuarsis, do të ndihmojnë në mbulimin e hendekut të furnizimit për rreth tre vitet e ardhshme. Ndërsa ekonomia rritet, dhe pasi të jenë zgjidhur problemet e humbjeve në shpërndarje, kërkesa për energji elektrike ka gjasa të rritet në mënyrë proporcionale. Një përlllogaritje e shpejtë tregon që nëse ekonomia e Shqipërisë rritet me 5 përqind në vit, sasia e kapacitetit të instaluar të nevojshëm në 5 vitet e ardhshme mund të jetë rreth 470 MW. Edhe nëse rritja ngadalësohet në 2 përqind, mund të kërkohej një kapacitet shtesë prej 180 MW. Sektori i energjisë i Shqipërisë nuk do të jetë në gjendje të ruajë shërbime cilësore të energjisë dhe tu japë shërbime tërheqëse klientëve në afat më të gjatë, pa tërheqjen e suksesshme të investimeve të reja.

3.50. **Është e rëndësishme për t'u theksuar se, hidrologjia mbetet e pasigurt dhe çmimet ndërkombëtare të energjisë mund të vazhdojnë të jenë të paqëndrueshme.** Kjo do të thotë që mbetet e paqartë se sa kapacitet duhet të sigurohet për një furnizim të qëndrueshme të energjisë elektrike dhe se sa kapacitet mund të zhvillohet në një bazë tregtare.

3.51. **Shqipëria duhet ta zgjidhi në mënyrë të drejtëpërdrejtë këtë pasiguri me plane të qarta kontigjence.** Në parim, ekziston një plan financiar kontigjence. Në kohën e privatizimit, ERE miratoi një deklaratë rregullatore që përmbante një mekanizëm stabilizimi, ku tarifat e KESH si një Furnizues Publik me Shumicë, do të merrte parasysh kostot më të larta të huamarrjes nga tregu për të financuar blerjet në periudhat e thata. Por dispozita deri tani nuk është zbatuar. Nga ana tjetër, nëse Qeveria dëshiron të ndërhyjë në këto situata duke ndihmuar KESH-in për të pasur akses në fonde më të lira, ajo mund ta bëjë një gjë të tillë. Megjithatë, kjo do të sillte një subvencion të fshehtë, i cili do të ndihmonte ata që konsumojnë më shumë. Rruga më neutrale për të bërë përpara është të ketë tarifa uniforme të cilat rriten në periudha mungese për t'i bërë konsumatorët të përdorin energjinë në mënyrë efikase. Shumë biznese do të ishin të gatshme të pranonin tarifa më të larta në këmbim të një furnizimi të qëndrueshëm me një cilësi të pranueshme, ndërsa tarifat familjare mund të rriteshin për konsumin mbi një sasi KWh në muaj në mënyrë që nga njëra anë të mbrohen të varfrit dhe nga ana tjetër të reduktohet kërkesa e tepërt. Tarifat më të larta për konsumatorët që kërkojnë furnizim të qëndrueshëm me energji mund të nxisë dhe disa konsumatorë të mëdhenj që të kontraktojnë furnizimin me energji elektrike drejtpërdrejt jashtë vendit, dhe duke reduktuar në këtë mënyrë mospërputhjen ndërmjet ofertës dhe kërkesës për pjesën tjetër të konsumatorëve.

3.52. **Në përfundim, zhvillimi i mëtejshëm i sektorit të energjisë elektrike i bazuar në progresin e madh të kryer vitet e fundit, duhet të përfshijë disa fusha.** Këto përfshijnë liberalizimin e tregut për klientët e mëdhenj, forcimin e operatorit të rrjetit kryesor (backbone) të transmetimit për të vepruar si një operator i vërtetë sistemi, tërheqjen e investimeve private në sektor për asetet jo strategjike të prodhimit, dhe forcimin e kapaciteteve rregullatore. Gjithashtu nevojitet një udhëzues i qartë për të zbatuar veprimet e politikave afatshkurtra dhe afatmesme në drejtimet e mëposhtme:

- Në periudhë afatshkurtër fokusi duhet të jetë në: (i) forcimin e qëndrueshmërisë financiare, administruese dhe teknike të kompanive energjetike dhe reduktimin e detyrimeve të prapambetura ndërmjet kompanive; (ii) uljen e detyrimeve të mbetura ndaj Qeverisë; (iii) zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga privatizimi i sektorit të shpërndarjes, përfshirë dhe kryerjen e investimeve për të reduktuar humbjet e energjisë; dhe (iv) gjetjen e mënyrave për rritjen e kapacitetit prodhues, veçanërisht nëpërmjet projekteve të vogla të hidrocentraleve dhe energjisë së erës.
- Në periudhën afatmesme është e rëndësishme të gjendet një partner strategjik për OST. Më pas, ndërsa ekonomia vazhdon të rritet, do të nevojiten kapacitete të reja prodhuese vendase dhe pjesëmarrje në Shkëmbimet Rajonale të Energjisë. Lëvizja drejt tregut rajonal të energjisë do të nënkuptonte dhe një transformim të KESH-it, për të zhbllokuar vlerën e aseteve të tij dhe për ta transformuar atë në një kompani bashkëkohore të energjisë elektrike.

IV. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT

Hyrje

3.53. **Një infrastrukturë të mirë transporti është një komponent thelbësor për të pasur një konkurrueshmëri më të mirë.** Një infrastrukturë transporti e cilësisë së dobët përkthehet në shpenzime më të larta dhe një disavantazh konkurrueshmërie për prodhuesit e brendshëm në tregjet ndërkombëtare, dhe çmime më të larta për mallrat e importuara.


Përveç infrastrukturës së mirë fizike, një komponent thelbësor, është edhe infrastruktura e “butë” e tregtisë. Kjo përfshin një gamë të gjerë veprimtarish që fokusohen në uljen e kostove të transaksioneve tregtare të firmave të cilat janë të përfshira në tregtinë ndërkombëtare. Si i tillë, lehtësimi i tregtisë përfshin më shumë se sa thjesht transporti me kamion i mallrave midis kufijve kombëtarë apo dërgimi i ngarkesave me transport detar. Kufijtë kombëtarë vendosin një seri kërkesash të ndërlikuara procedurale mbi tregtinë dhe logjistikën, përfshirë terma të distribucionit, konsolidimin e ngarkesave, magazinimin dhe kalimin e kufirit për të hyrë në vend dhe sistemet e pagesave. Ky seksion përshkruan shkurtimisht problemet kryesore në sektorin e transportit dhe jep disa rekomandime për të maksimizuar përfitimet nga investimet në këtë sektor.

Rrjeti i Rrugëve

3.54. Kushtet e rrjetit rrugor janë përmirësuar ndjeshëm. Raporti i parë pesëvjeçar i Planit Kombëtar të Transportit Shqiptar (ANTP) tregon se gjendja aktuale e rrugëve është si vijon: një e treta (31%) e seksioneve primare dhe gjysma e seksioneve sekondare (49%) të rrjetit të rrugëve kombëtare janë në kushte jo të mira, dhe me 55 përqind dhe 5 përqind respektivisht, në gjendje shumë të mirë. Kjo përbën një përmirësim të ndjeshëm nga viti 2005 ku 67 përqind e rrjetit të rrugëve kombëtare ishte në gjendje të keqe ose shumë të keqe. Rrugët rajonale dhe lokale janë në gjendje veçanërisht të keqe dhe për këtë arsye qeveria është fokusuar në një program të madh investimesh për të përmirësuar aksesin e komuniteteve rurale. Përveç kësaj, ka ende shumë punë për të bërë për implementimin e standardeve të reja Shqiptare të Projektimit dhe Ndërtimit, të cilat do të përmirësonin cilësinë e rrjetit dhe sjellin standardet moderne të operimit dhe mirëmbajtjes.

3.55. Kushtet e rrjetit dhe investimet e mëdha në infrastrukturë vënë në dukje rëndësinë e menaxhimit të mirë të këtyre asetëve. Çështjet kryesore janë: (i) fonde të pamjaftueshme për mirëmbajtjen rutinë dhe periodike të planifikuar; (ii) zbatimi i kufijve të peshës mbi aks, moszbatimi i të cilit kontribuon në degradimin e parakohshëm edhe të atyre rrugëve ku janë shpenzuar fonde; (iii) përgatitja për një rritje të konsiderueshme të volumeve të trafikut; dhe (iv) shfrytëzimi i mirëmenadur i fondeve të disponueshme, duke përdorur teknika të reja për të përmirësuar eficiencën e shpenzimeve, siç është kontraktimi në bazë të rezultateve dhe performancës si edhe riveshjet sipërfaqësore.³⁷

Figura 3.15: Gjendja e Rrjetit Rrugor Dytësor/Tretësor



Burimi: Banka Botërore, 2008

3.56. Për rrjedhojë, problemi kryesor në periudhë afatmesme është mirëmbajtja e rrjetit dhe vazhdimi i forcimit të institucioneve të sektorit. Fokusi në sektorin e transportit kërkon një balancim jo të lehtë midis vazhdimit të zgjerimit të rrjetit aty ku është me leverdi ekonomike, duke siguruar në të njëjtën kohë alokimin e burimeve të mjaftueshme për mirëmbajtjen e këtyre asetëve. Në thelb ky është një problem menaxhimi ekonomik-krijimi i mekanizmave që të sigurojnë vlerësimin e plotë të kostove dhe përfitimeve të investimeve të ardhshme në infrastrukturën e transportit, zhvillimin e kapaciteteve për të mirëmbajtur rrjetin e rrugëve, koordinimin e mirë të përpjekjeve si në aspektin e brendshëm edhe me fqinjët rajonalë të Shqipërisë, programimin e duhur kohor të punëve si pjesë e një portofoli buxhetor të qëndrueshëm nga ana fiskale.

³⁷ Këto tani po pilotohen në Projektin e Transportit, me mbështetje nga Banka Botërore.

Sektori i Porteve

3.57. **Në Shqipëri funksionojnë dy porte të thellë detare në Durrës dhe Vlorë.** Gjithashtu ka dhe dy porte dytësore në Shëngjin dhe Sarandë, të përdorur kryesisht për transportin detar në afërsi të brigjeve. Porti i Durrësit është porti kryesor tregtar i vendit. Aktualisht ky port trajton mallra të përgjithshme, me kontenierë, rifuxho të thatë (drithëra, minerale, qymyr, çimento, klinker), rifuxho të lëngët, dhe tragete (pasagjerë dhe ngarkesa lëvizëse (makina)). Duhet nënvizuar se, trajtimi i rifuxhos të lëngët do të transferohet në një port të ri në Porto Romano.

3.58. **Mirëmbajtja e pajisjeve, ambienteve, strukturave, infrastrukturës dhe thellimit të portit në përgjithësi janë neglizhuar dhe jo-financuar siç duhet në Durrës ashtu dhe në portet e tjerë.** Porti i Durrësit ka rreth 30 cm sedimente çdo vit. Megjithatë, thellimi për mirëmbajtjen e kanaleve të hyrjes dhe basenit të portit, nuk kryhet rregullisht. Mungesa e këtij thellimi ka bërë që kanali të jetë i disponueshëm vetëm për anije me thellësi lundrimi të ulët. Anijet më të mëdha nuk mund të futen në port, gjë që ka penguar zhvillimin e tij dhe shfrytëzimin e plotë të investimeve të bëra në kapacitetet e reja të vendeve të ankorimit, zonave të magazinimit dhe pajisjeve. Për më tepër, hapësirat dhe kapaciteti përpunues vazhdojnë të jenë të kufizuara.

3.59. **Porti është i lidhur mirë me rrjetin kombëtar rrugor dhe hekurudhor dhe mund të jetë konkurrues në nivel rajonal.** Aksesi kryesor në port është autostrada Durrës - Tiranë (e ndërtuar në vitin 2001). Akset kryesore për transport rrugor mallrash janë Durrës – Tiranë – Elbasan (dhe më tej për në kufirin me IRJ të Maqedonisë), Durrës/Tiranë – Lezhë – Shkodër – Podgoricë në Malin e Zi, dhe Durrës/Tiranë – Vlorë (dhe më tej për në kufirin me Greqinë) dhe lidhja e rëndësishme e re Durrës – Milot – Morinë – Kukës për në Kosovë.

3.60. **Në përfundim,** nëse synohet kthimi i Durrësin në një port konkurrues në rajon, ai ka nevojë për burimet e duhura (ose të ketë një partneritet publik/privat) për të hequr pengesat ekzistuese dhe për të përmirësuar shërbimet e tij.

Lehtësimi i Tregtisë

3.61. **Pavarësisht progresit të konsiderueshëm, ka akoma shumë hapësirë për të përmirësuar proceset e zhdoganimit.** Sistemi akoma nuk është plotësisht pa letër dhe ende kërkohet të dorëzohen kopje të shtypura të deklaratës së importit menjëherë pas dorëzimit elektronik. Në përgjithësi, ka pak inspektime të ngarkesave në kufi. Inspektimet kryhen në pikat e brendshme tokësore të zhdoganimit dhe ende ekziston një tendencë për të inspektuar fizikisht 100 përqind të ngarkesës në vend të zbatimit të një sistemi me përzgjedhje. Analiza e rrezikut nuk përdoret në mënyrë efektive. Në përgjithësi, reforma e doganave vazhdon të përballet me probleme për zbatimin e (i) përpunimit elektronik të dokumenteve; (ii) analizës së rrezikut e cila do të mundësonte përqendrimin e vëmendjes tek ngarkesat me rrezik të lartë; dhe (iii) transferimit të një përgjegjësie më të madhe tek importuesit dhe eksportuesit për zhdoganimin e ngarkesave të tyre në mënyrë më transparente. Masat që çojnë në përmirësimin e performancës së doganave mund të përfshijnë: (i) ndarjen e qarkullimit mallrave të import-eksportit nga qarkullimi i mallrave tranzit; (ii) thjeshtëzimin e përpunimit të dokumenteve; dhe (iii) rishpërndarjen e personelit të kufirit nëpër pika kufitare sipas volumit të trafikut dhe nivelit të rrezikut.

3.62. **Sektori i logjistikës në rajon konsiston kryesisht në shërbime bazike transporti me kamionë dhe magazinim të ofruara nga transportuesit apo të deleguara palëve të treta.** Duke qenë se tregjet kryesore janë vendet fqinje, dërgesat përfshijnë lëvizje të drejtpërdrejta kamionësh nga pika e prodhimit tek blerësi final, pa nevojën e magazinimit të ndërmjetëm. Ofruesit e shërbimeve të logjistikës janë të vegjël dhe konkurrues, por e përdorin pak teknologjinë e informacionit që është një aspekt kritik i shërbimeve moderne të logjistikës së integruar. Sofistikimi i shërbimeve të logjistikës do të rritet, pasi të ketë një kërkesë dhe specializim më të madh të rrjeteve të furnizimit. Në përgjithësi, edhe kompanitë “e mëdha” shqiptare të transportit me kamionë janë të vogla dhe vetëm pak kompani kanë flota me më shumë se 25 kamionë. Një nga kufizimet më të cilat përballen shoferët e kamionëve në Shqipëri është numri i kufizuar i lejeve rajonale (CEMT) dhe bilaterale. Ka një kërkesë të kufizuar për dërgesa ajrore, meqenëse koha e dërgesave për në BE, që është dhe tregu

kryesor jashtë rajonit, është e përafërt ndërmjet transportit rrugor dhe ajror. Disa nismat për të forcuar logjistikën mund të përfshijnë (i) rritjen e licencave për dërgesat për në vendet e BE; (ii) përmirësimin e kushteve për procesimin e ngarkesave të përziera, meqenëse aktualisht procedurat doganore kërkojnë zhdoganim më vete të secilës ngarkesë individuale; dhe (iii) futjen e teknikave të menaxhimit të rrjetit të furnizimit, ku konkurrenca nuk përqendrohet vetëm tek çmimet.

KAPITULLI 4: INSTITUCIONET PUBLIKE DHE QEVERISJA PËR INVESTIMET

I. HYRJE

4.1. Ky kapitull shqyrton ndikimin e institucioneve publike dhe qeverisjes në përcaktimin e pritjeve dhe sjelljes së investitorëve. Dy kapitujt e mëparshëm theksuan rëndësinë e kapitalit njerëzor dhe infrastrukturës fizike për investimet dhe rritjen ekonomike. Ky kapitull diskuton se si institucionet publike dhe qeverisja ndikojnë nivelin dhe sigurinë e kthimeve të investimeve private dhe ndikimin e tyre në rritjen e përgjithshme ekonomike.

Pasiguria zvogëlon kthimet nga investimi, kështu që investimet do të rriten nëse firmat mund të jenë relativisht të sigurta për klimën aktuale dhe të ardhshme të investimeve. Në përgjithësi, burimet e mundshme të pasigurisë vijnë nga: nivelet aktuale dhe të ardhshme të taksave, pasiguria në lidhje me mundësitë e ryshfeteve dhe pagesave informale, ndryshimet në ligje dhe rregulla apo në zbatimin e tyre, praktikant antikonkurrese nga firmat ekzistuese, pasiguria për çmimin dhe disponibilitetin e inputeve kryesorë (veçanërisht nga infrastruktura publike), dhe pasiguria mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë (veçanërisht për tokën dhe kontratat tregtare). Të gjithë këta komponentë mund të përmbledhen si pjesë të 'infrastrukturës së butë' të ekonomisë "që përbëhet nga institucionet, rregullat, kapitali social, sistemet e vlerave dhe rregullime sociale dhe ekonomike" (Lin, 2009a). Firmat që përpiqen të lëvizin në prodhimin e produkteve të rinj (ose përdorim teknologjie të re) përballen me pasigurinë e strukturave të reja të kostos me të cilat do të përballen. Në këto kushte, sipërmarrësit përqendrohen në investime që mund të sjellin fitime të mëdha shumë shpejt.³⁸ Kjo mund të mos jetë optimale në perspektivën e rritjes ekonomike në periudhë afatgjatë. Në këtë mënyrë, pjesa tjetër e këtij kapitulli do të vlerësojë nivelin e zhvillimit të infrastrukturës së butë të Shqipërisë, perceptimin e saj nga firmat, dhe do të japë rekomandime se çfarë mund të bëhet për të forcuar sigurinë e klimës së investimeve.

II. QEVERISJA DHE KLIMA E INVESTIMEVE

4.2. Në vitet e fundit, Shqipëria ka bërë përmirësime të mëdha në klimën e saj të investimeve. Ky është një reflektim i fokusimit të madh të programeve të qeverisë në këtë fushë. Si rezultat i kësaj, Shqipëria ka bërë një përmirësim të madh: renditja e saj në Treguesit e të Bërit Biznes, të Bankës Botërore u përmirësua nga vend i 136 në vitin 2007 në vendin e 82 në vitin 2009. Ndër reformat më të rëndësishme janë:

- i) Fillimi i përdorimit të një takse të sheshtë (10 përqind) ndaj bizneseve dhe individëve dhe përmirësimi i administrimit të taksave,
- ii) thjeshtëzimi i krijimit të një biznesi nëpërmjet një ndalese të vetme (Qendra Kombëtare e Regjistrimit) e cila ka rregulluar procesin dhe ka shkurtuar kohën për hapjen e një biznesi të ri,
- iii) reduktimi i kohës për regjistrimin e transferimeve të tokës nga 47 në 30 ditë për pronat e paregjistruara më parë,

³⁸ Kjo është e lidhur shumë ngushtë me vështirësitë e transferimit të teknologjisë dhe njohurive nga investimet e huaja meqenëse shpesh ka një supozim të nënkuptuar që teknologjia është thjesht një paketë informacioni që mund të transferohet. Megjithatë, ka fakte të forta teorike dhe empirike që në vendet të cilat janë larg kufirit të prodhimit (siç është Shqipëria) zbulimi i strukturave të kostos është në vetvete e shtrenjtë dhe kërkon investime. Si pasojë, ka një risk të humbjes së investimit nëse kostot rezultojnë të jenë të paqëndrueshme, apo nëse fitimet mund të shterojnë shpejt nëse kostot nuk reduktohen. Shiko Hausmann & Rodrik, 2003 mbi metodën teorike dhe Amsden, 2001 mbi përvojën empirike të transferimit të teknologjisë.

- iv) hyrja në fuqi e ligjeve të reja të prokurimeve dhe të koncesioneve,
- v) modernizimi i sistemeve të doganave,
- vi) krijimi i një regjistri publik të kredive, dhe
- vii) forcimi i mbrojtjes së investitorëve të huaj nëpërmjet një ligji të ri për kompanitë dhe nëpërmjet miratimit të një ligji të ri për falimentimin.

4.3. Masat e mësipërme janë pjesë e një strategjie të plotë të reformës rregullore të filluar në 2005. Ajo përfshin politika të cilat janë ende duke u zbatuar, të tilla si fillimi i përdorimit të Vlerësimit i Ndikimit Rregullator (i mundshëm për të filluar në 2011) dhe një reformë të inspektimeve dhe licencimeve. Këto reforma, së bashku me ato të përshkruara në dy kapitujt e mëparshëm, pa dyshim që kanë kontribuar në normat e mëdha të rritjes ekonomike. Gjithsesi, evidencat e shqyrtuara në këtë kapitull sugjerojnë se me zhvillimin e ekonomisë, janë rritur edhe pritjet e bizneseve nevojat e të cilave janë gjithmonë e më shumë të fokusuar në parashikueshmërinë e klimës së investimeve.

4.4. Pavarësisht reformave të rëndësishme të ndërmarra deri tani, duket se ka faktorë që i bëjnë investimet të pasigurta, domethënë më pak tërheqëse. Përfundimet e Studimit të Klimës së Investimeve (ICS) dhe BEEPS 2008 ofrojnë disa ide (Figura 4.1). Në BEEPS 2008, pesë pengesat më të rëndësishme të bërjes së biznesit ishin: energjia elektrike (e përmendur nga 81 përqind e sipërmarrjeve), korrupsioni (66 %), normat e taksave (62 %), telekomunikacionet (56 %) dhe aftësitë dhe arsimimi i punonjësve (53%) (Shiko Figurën 3.1, paneli i djathtë). Në ICS, pesë pengesat kryesore të investimeve ishin elektriciteti (38%), informaliteti (15 %), paqëndrueshmëria politike (7 %), korrupsioni (7 %) dhe normat e taksave (7%)³⁹

4.5. Gjithashtu, duhet të vihet re se pas kryerjes së studimeve qeveria kreu përmirësime të ndjeshme në furnizimin me energji elektrike. Përveç kësaj, normat e taksave ka mundësi të jenë më pak problematike pavarësisht pikëve të larta. Vihet re se përqindja e firmave që perceptojnë normat e taksave si një pengesë ka rënë dukshëm që prej 2005 (kur 84 % e raportuan këtë si problem) dhe është një nga më të ulëtat në vendet në tranzicion. Në mënyrë të ngjashme, duke krahasuar BEEPS 2005 dhe BEEPS 2008 është vënë re ka pasur një përmirësim të madh në disa tregues, të tillë si funksionimi i gjykatave.


4.6. Pas kufizimeve në faktorët e inputeve (infrastruktura dhe kapitali njerëzor), të cilët u diskutuan në dy kapitujt e mëparshëm, ICA evidenton pjesë të institucioneve publike që kanë nevojë për përmirësim dhe masën deri ku ndërmarrjet mund të jenë të sigurta për “rregullat e lojës”. Studimi i ICA sugjeron se me gjithë progresin e madh në klimën e investimeve dhe qeverisjen e përgjithshme, ka ende hapësirë për përmirësim, veçanërisht kur krahasohet me vendet e tjera në tranzicion. **Për shembull, ndër burimet e pasigurisë janë** ndryshimet arbitrare në rregullore (që shpesh janë kontradiktore me ligjet e tjera), mungesë e procesit të duhur për miratimin e rregulloreve dhe ligjeve, dhe ndryshimet e shpeshta të zyrtarëve publikë, që shpesh dhe ata vetë nuk janë të familjarizuar me rregullat. Në fakt shumë sipërmarrës tregojnë se ndryshime të tilla krijojnë pasiguri të madhe dhe rrisin rrezikun për investimet. Kjo është e vërtetë pavarësisht faktit se korrupsioni, i matur nëpërmjet masës së marrjes dhe dhënies së ryshfetit, ka rënë dukshëm (në 2009 vetëm 38.9 përqind e firmave raportoi se ishte e nevojshme të bëheshin pagesa jo formale që gjërat të kryheshin, që përbën rënie nga 76 përqind në 2002 dhe 58 përqind në 2007)⁴⁰. Këto ndryshime evidentohen edhe në progresin e bërë midis studimeve të BEEPS në 2005 dhe 2008 (Figura 4.2). Në fakt, këto studime

³⁹ Ndërmjet dy studimeve ka dy dallime kryesore metodologjike. E para është që BEEPS i referohet pengesave ndaj të bërit biznes në një kuptim të gjerë, ndërsa ICS i referohet pengesave të investimeve. Dallimi i dytë është se në studimin e BEEPS ndërmarrjet mund të listojnë të gjithë çështjet që ata i konsiderojnë si pengesa për të bërë biznes ndërsa në studimin ICS çdo ndërmarrje mund të shprehë vetëm pengesën kryesore.

⁴⁰ Shqipëria gjithashtu u përmirësua shumë në Treguesin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International, duke u ngjitur nga vendi i 105 nga 180 vende në vitin 2007 në vendin e 85 në vitin 2008.

tregojnë që Shqipëria ka bërë progres të madh megjithëse ende renditet më poshtë se disa prej vendeve të rajonit. Patjetër që këto janë zhvillime pozitive mbi të cilat është e nevojshme të bazohen zhvillimet e mëtejshme.

Figura 4.1: BEEPS 2005 dhe 2008: Përqindja e Firmave që Tregojnë se Ka një Problem




Shënim: Evropa dhe Azia Qendrore (ECA) përfshin të gjitha ekonomitë në tranzicion dhe Turqinë.
Burimi: BEEPS 2008.

III. ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR

4.7. Një nga çështjet kritike për firmat është efikasiteti i zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese nga institucionet publike. Shqipëria tregon një shkallë rregullimi (rregulla formale sikurse shprehur nga renditja në përqindje e treguesit të Bërit Biznes) në përputhje me një vend me PPB e saj për frymë (Figura 4.3 (a)). Nga ana tjetër, praktikatat e zbatimit të saj të matura nga Treguesit Botëror të Qeverisjes (WGI) për vitin 2008, janë më poshtë se ç'pritet nga një vend në një fazë të tillë zhvillimi. (Figure 4.3 (b)).⁴¹ Në raste të tjera, përmirësimet e mjedisit të biznesit kanë ardhur kryesisht nëpërmjet ndryshimit të kuadrit ligjor (në veçanti thjeshtimin e procedurave për fillimin e një biznesi dhe futjen e legjisllacionit efektiv për falimentimin), por sidoqoftë ky hendek zbatimi midis kuadrit formal dhe praktikës, është ajo që vlen për investitorët

⁴¹ Treguesit Botërorë të Qeverisjes janë kombinime të burimeve dhe studimeve të shumta të cilat vlerësojnë qeverisjen në gjashtë dimensione: zëri dhe përgjegjshmëria, stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës, efektiviteti i qeverisë, cilësia rregullatore, shteti ligjor dhe kontrolli i korrupsionit. Vlerësimi i përgjithshëm është i përbërë nga të gjashtë dimensionet dhe mundëson renditjen e vendeve sipas cilësisë së qeverisjes. Treguesit për vitin 2008 janë publikuar në Kaufmann, Kraay, & Mastruzzi, 2009


Figura 4.2: Shpeshësia dhe Madhësia e Ryshfetëve – Të Dhëna për Vendet nga Studimet BEEPS




Burimi: BEEPS⁴²

Figura 4.3: Rregullimi Formal, Praktikët e Implementimit dhe Nivelet e të Ardhurave

(a) GDP për frymë dhe rregullimi formal



(b) GDP për frymë dhe praktikët e implementimit



Shënim: Treguesi i rregullimit formal është renditja në përqindje e Bërjes së Biznesit në 2010, PPB për frymë i referohet 2008.

Shënim: Praktika e zbatimit i referohet mesatares së efektivitetit të qeverisjes dhe treguesit të zbatimit të ligjit në Treguesit Botërorë të Qeverisjes, 2008.

4.8. Në mënyrë të ngjashme, treguesit e qeverisjes sugjerojnë se Shqipëria renditet më keq se vendet e tjera të rajonit të Ballkanit, në fushat që ndikojnë investimet si shteti ligjor dhe korrupsioni. WGI vë në dukje se në Shqipëri ka pasur përmirësime të ndjeshme në zbatimin e shtetit ligjor, por vendi është ende prapa vendeve të rajonit (Figura 4.5). Kur shteti ligjor është joefikas dhe firmat janë objekt i vendimeve arbitrare të zyrtarëve, menaxhimi i firmave duhet të shpenzojnë më

⁴² I përshtatur nga Raporti IV i BEEPS që është në përgatitje: Korrupsioni dhe Barra rregullatore në ECA.



shumë kohë dhe burime se sa do të duhej normalisht në përballjen me zyrtarët për të marrë vendime të favorshme. Megjithatë, është e rëndësishme të vihet në dukje se treguesit e shtetit ligjor janë përmirësuar ndjeshëm, (Figura 4.4), që është në përputhje me përfundimet e treguara më parë nga studimet BEEPS.

4.9. Ndoshta jo çuditërisht, perceptimi i korrupsionit nga publiku është në rënie. Instituti për Alternativat e Zhvillimit të Kërkimit në studimin e tij vjetor (IDRA, 2009), arriti në përfundimin se pjesa e publikut që raporton korrupsionin e zyrtarëve si “shumë të përhapur”, është zvogëluar nga dy të tretat në 2005 në gjysmë në 2009. Nënpunësit e doganave dhe të tatimeve shihen si më të korruptuarit me 72 përqind dhe 69 përqind që i perceptojnë ata si të korruptuar, por kjo ishte dukshëm më e ulët se nivelet korresponduese në 2005 (87% dhe 83%).

4.10. Një fushë ku duket se ka ende nevojë për përmirësim, është zbatimi i kuadrit ligjor. Në të vërtetë ka shumë fusha me legjislacion të mbivendosur dhe kontradiktor. Kjo është më e theksuar në rastin e regjistrimit dhe të drejtave të pronësisë ku nëpunësve u kërkohet të interpretojnë ligjin. Kjo mund të rezultojë në inkosistenca dhe vendime të dukshme arbitrare, të cilat dëmtojnë shtetin ligjor (Kutia 4.1).

Figura 4.4: Treguesit Botërorë të Qeverisjes për Shqipërinë

Figura 4.5: Krahasimi Rajonal për Tregues të Përzgjedhur të WGI



Shënim: Gjashtë treguesit e qeverisjes janë matur në njësi që marrin vlera në intervalin -2.5 deri në 2.5, ku vlerat më të larta i korrespondojnë rezultateve më të mira të qeverisjes.

Burimi: www.govindicators.org.

Kutia 4.1: Vendimet Arbitrare dhe Veprimet e Pa Koordinuara

Më poshtë janë disa shembuj të shkurtër të rasteve në të cilat janë marrë vendime arbitrare ose të pa koordinuara dhe që priren të cenojnë integritetin e kuadrit ligjor dhe besimin që bizneset mund të kenë në mbrojtjen dhe zbatimin e ligjeve.

Zbatimi i Ligjit të Falimentimit

Drejtoria e Tatimeve filloi veprimet e falimentimit automatik kundrejt 27 bizneseve në vitin 2009, duke përfshirë biznese të zotëruara nga të huaj. Veprimet e falimentimit u filluan sipas Kodit Procedural të Taksave i miratuar në Maj 2008 që thotë se një kompani që ka të ardhura neto negative (humbje neto) në bilanc për tre vite rresht automatikisht konsiderohet e falimentuar. Veprimet u tërhoqën pas shpjegimeve nga kompanitë e interesuara. Megjithatë autoriteti i taksave ishte i gatshëm të ndreqte gabimin e tij, fillimi i veprimeve ngriti shqetësimet rreth veprimeve arbitrare të qeverisë.

Drejtoria e Tatimeve veprroi pa konsultimin e duhur për të përcaktuar faktet e situatës. Vetë Ministria e Financës akuzoi Drejtorinë e Tatimeve në dështimin për ndjekjen e procedurës së duhur duke mos zbatuar Nenin 104 të Ligjit të Falimentimit të 2002. Ligji kërkon një analizë të aftësisë së kompanisë për të shlyer borxhin e saj si një parakusht thelbësor për fillimin e veprimeve të falimentimit. Nëse do të ishte bërë kjo, asnjë nga këto kompani nuk do ishte e kualifikuar për fillimin e veprimeve të falimentimit.

Një ligj jo i plotë për falimentimin

Ligji i Falimentimit u amendua në vitin 2008 dhe parashikon krijimin e një agjencie (autoriteti) kombëtar që do të trajtojë rastet e falimentimit. Agjencia ende nuk është krijuar. Sipas raport progresit të KE për 2009 “nuk është raportuar asnjë rast i zbatimit të Ligjit të Falimentimit. Procedurat e falimentimit ende nuk po përdoren, gjë e cila frenon efikasitetin e mekanizmave të tregut”.

Përdorimi i referencave për çmimet, pagat dhe numrin e punonjësve

Si pjesë e procesit nxitës për të rritur mbledhjen e taksave, ekziston një përdorim i gjerë i çmimeve referencë (për importet), pagave referencë (për taksat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore) madje edhe referencave për numrin e punonjësve (për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore). Ndërsa qëllimi për uljen e informalitetit dhe evazionit fiskal është i dukshëm, efekti i tij është bërja e vendimeve tatimore më arbitrare dhe objekt i vendimeve të zyrtarëve individual. Kjo ka krijuar gjithashtu efektin ku sistemi i taksave po bëhet gjithnjë e më pak i bazuar në rregulla dhe më shumë i varur nga një mozaik arbitrar normash.

Vështirësi në kompensimin e TVSH

Qeveria, për të rritur të ardhurat, shpesh refuzon t'u kthejë TVSH ndërmarrjeve që kanë mbipaguar TVSH ose kanë të drejtë për kompensim mbi eksportet. Vendimi është arbitrar dhe nuk ka bazë ligjore. Efekti i kësaj është cenimi i besimit në gjithë sistemin administrativ dhe të taksave.

Tregu i Tokave dhe Pronave

4.11. **Një aspekt i shtetit ligjor i cili ka rëndësi të veçantë është i lidhur me tregun e pasurive.** Problemet që mund të krijojnë pengesa për funksionimin efikas të tregut të pronave përfshijnë mungesën e dokumenteve ligjore, mbivendosjen e pretendimeve, sistemin gjyqësor të ngadaltë dhe të paparashikueshëm dhe mungesën e koordinimit midis agjencive qeveritare. Në Shqipëri, shumica e problemeve duket se ekziston në zonat afër qyteteve, veçanërisht aty ku pronarët e pronës nuk kanë marrë pjesë në procesin e legalizimit. Përveç këtyre, kontradikta të rëndësishme ka edhe në kuadrin ligjor që drejton kthimin e pronës, regjistrimin e saj dhe privatizimin fillestar të pronës, të cilat bëjnë që të drejtat e pronësisë mbi tokën të jenë objekt i kontradiktave dhe paqartësive, në pritje të një rishikimi i mundshëm i gjithë kuadrit ligjor.

4.12. **Për shkak të pasigurisë që rrethon vendimet mbi pronësinë e pronave, shumë prona transaksione me pronat kryhen jashtë kuadrit formal ligjor.** Në rastet e lindjes së mosmarrëveshjeve mbi pronat, dhe shumë të tilla po shkojnë në gjykata, nuk ka asnjë mënyrë të qartë për t'i zgjidhur ato. Ndërsa disa biznese janë të gatshme të marrin përsipër rrezikun duke shpresuar që problemet eventualisht do të zgjidhen, të tjerë, veçanërisht investitorët e huaj, frenohen në bërjen e

investimeve. Në BEEPS 2008, 43 për qind e firmave raportoi aksesin në tokë si një problem madhor, krahasuar me vetëm 26 për qind në 2005, nivel i cili është më i lartë se në vendet e tjera në rajon.

4.13. **Ndërsa kuadri ligjor për pronat e patundshme (që mbulon kontratat, transaksionet, regjistrimin, administrimin dhe planifikimin) duket se është i përshtatshëm, praktika tregon se kuadri ligjor nuk po vepron plotësisht.** Vlerësohet se deri një e treta e të gjithë ndërtesave në Shqipëri janë të jashtëligjshme për shkak të mungesës së titullit të plotë të pronësisë së tokës nga zënësi dhe/ose mungesës së lejeve të duhura të ndërtimit.

4.14. **Legalizimi i zënies së tokës dhe ndërtesave të ndërtuara pa leje është një proces kritik, që mund të sqarojë pronësinë, përmirësojë administrimin dhe të largojë disa nga pengesat për ecurinë efikase të tregut të pronave.** Agjencia e zbatimit – ALUIZNI – ka burime të mjaftueshme, por ka përfunduar më pak se një të tretën e legalizimeve të dorëzuara deri tani. Ndërkohë zënia dhe ndërtimi i jashtëligjshëm duket se po vazhdon, dhe në fakt kjo inkurajohet nga procesi i zgjatuar i legalizimit. Zënia dhe ndërtimi i jashtë ligjshëm i përket shumë nën-kategorive, si okupimi i tokës private ose shtetërore, cenimi i tokës private, mungesë e lejeve të ndërtimit dhe shkelje të lejeve të ndërtimit. Shumë ndërtesa në Tiranë trajtohen si të jashtë ligjshme (të kufizuara) pasi kanë shtesa të pa autorizuara, që i ndalon ato të shiten ose përdoren si garanci. Dështimi ose paaftësia për të vepruar me vendosmëri për të ndaluar zënie dhe ndërtimin e jashtë ligjshëm ka çuar në vazhdimin e këtij fenomeni, që tani ka marrë përmasa të dukshme në zonat bregdetare që kanë potencial të lartë të zhvillimit të turizmit. Shkatërrimi i ndërtesave të jashtë ligjshme mbetet problematike, ku përgjegjësinë për shumicën e punëve e kanë bashkitë të cilat nuk kanë burime të mjaftueshme dhe eksperiencë në këtë fushë.


4.15. **Në mungesë të një zgjidhje ligjore gjithëpërfshirëse të çështjeve të tokës, së bashku me mungesën e angazhimit të besueshëm për të zbatuar marrëveshjet, disponueshmëri e tokës dhe investimet do të vazhdojnë të jenë të kufizuara.** Mungesa e qartësisë për të drejtën e pronësisë mbi tokën ndikon të gjitha fushat e tjera të të drejtës mbi pronën, për shkak të uljes së besueshmërisë së zbatimit të ligjit dhe institucioneve ligjore.

Parashikueshmëria dhe qëndrueshmëria e rregulloreve

4.16. **Shkalla deri ku zyrtarët kanë mundësi të mbrojnë zbatimin e ligjit lidhet pjesërisht me menaxhimin e kapaciteteve dhe personelit në sektorin publik. Me gjithë përmirësimet e vëna në dukje më sipër, është e qartë se midis firmave dhe publikut të gjerë ka një perceptim të fortë se vendimet arbitrare nga zyrtarët janë prova të kërkimit të ryshfeteve dhe korrupsionit.** Megjithatë, problemi mund të jetë edhe një çështje e lidhur me kapacitetet e kufizuara të menaxhimit, procedurat e paqarta dhe mungesën e kuptimit nga shumë zyrtarë të qëllimit të ligjeve dhe rregulloreve, të cilat përkeqësohen nga një qarkullim i madh i punonjësve civil brenda administratës.

4.17. **Pavarësisht burimit të origjinës së problemeve, studimet e firmave kanë evidentuar problemet kryesore që rrisin më shumë kostot dhe pasigurinë.** Këto probleme ishin: hyrja në fuqi e ligjeve dhe rregulloreve të reja, me efekt të menjëhershëm, pa kryer një trajnim paraprak të zyrtarëve ose pa informuar paraprakisht firmat për t'i lejuar ato të realizojnë një përputhmëri pa probleme; mungesa e konsultimeve përpara hyrjes në fuqi të rregulloreve; miratimi i ligjeve dhe rregulloreve që janë në kontradiktë me ligjet ekzistuese dhe në këtë mënyrë bëjnë të nevojshme interpretimin zyrtar; mungesë e mekanizmave për apelimin e vendimeve administrative; një mungesë e përgjithshme besimi në sistemin gjyqësor; dhe mungesën e dëshirës së zyrtarëve për të vepruar në përputhje me vendimet e gjykatave. Në studimin e ICS, më shumë se 70 për qind e firmave nuk binin dakord me pohimin se interpretimet e zyrtarëve publikë të ligjeve dhe rregulloreve janë konsistent dhe të parashikueshëm. Në thelb, kjo shihet si një kufizimi i madh detyruar për vendim-marrjen e firmave për investimet afatgjata.

Figura 4.6: Perceptimi i Interpretimeve Konsistente dhe të Parashikueshme të Ligjeve dhe Rregulloreve



Burimi: Studimi mbi Klimën e Investimeve, 2008.

4.18. **Të dhënat tregojnë gjithashtu se firmat e vogla dhe SME-të mesatarisht ndikohen shumë më tepër se firmat e tjera nga inkonsistenca dhe paparashikueshmëria e interpretimit të ligjeve dhe rregulloreve nga zyrtarët (Figura 4.6).** Gjithashtu, menaxherët e lartë të firmave në 2007-2008 shpenzuan mesatarisht 18 për qind të kohës së tyre për t'u marrë me kërkesat e vendosura nga qeveria dhe rreth një e treta e firmave shpenzojnë më shumë se 25 për qind të kohës së tyre në të parën (megjithëse çuditërisht firmat e mëdha priren ti kushtojnë më shumë kohë menaxhimi këtyre kërkesave se sa firmat e vogla). Gjithashtu, duket se barra është më e rëndë për eksportuesit që priren të shpenzojnë 27 për qind të kohës së tyre duke u marrë me kërkesat ligjore.

4.19. **Barra mbi bizneset rrjedh nga zbatimi praktikave jo formale, duke përfshirë interpretim kontradiktor dhe të paparashikueshëm të rregulloreve ose zbatim arbitrar nga sistemi gjyqësor.** Shtrembërimet e imponuara nga praktikat jo-formale rregullatore çojnë në vendosjen e një "takse kohe" dhe një "takse ryshfeti" mbi firmat, pasi ato shpenzojnë kohë dhe para për tu marrë me zyrtarët qeveritarë në mënyrë që të rrisin mundësitë që rregullat të interpretohen në mënyrë të favorshme. Kjo rrit kostot operacionale si edhe redukton kohën e kërkuar për kthimin e investimeve. Sa më i paqëndrueshëm mjedisi, aq më pak të pasigurta janë kthimet e ardhshme dhe prandaj ato skontohehen me një normë më të lartë. Madje edhe në rastet kur qëllimi nuk është që të nxirren fitime por të zbatohet politika, efekti është krijimi i një mjedisi ku mund të lulëzojë korrupsioni.

Shteti Ligjor dhe procesi i hyrjes në BE

4.20. **Në kontekstin e procesit të hyrjes në BE, rëndësia e zbatimit të kuadrit ligjor është rritur.** Në raportin e fundit të progresit të lëshuar nga Komisioni Evropian mbi rrugën e Shqipërisë për anëtarësim në BE, KE (Komisioni Evropian, 2009) deklaron se pengesat kryesore që dalin janë pikërisht në fushën e shtetit ligjor dhe të drejtave të pronësisë. Për shembull raporti citon se: "një tendencë e ekzekutivit për të ushtruar kontroll mbi institucioneve të pavarura, veçanërisht gjyqësorin, ka ngritur shqetësim". Raporti gjithashtu thekson rëndësinë që të sigurohet se procedurat gjyqësore të mund të kryhen në mënyrë efektive kundrejt çdokujt pavarësisht pozicionit të mbajtur në mënyrë që të sigurohet besueshmëria e luftës ndaj korrupsionit. Raporti përfundon se reformat gjyqësore mbeten ende në fazën fillestare dhe se sistemi gjyqësor vazhdon të funksionojë dobët për shkak të mungesës së pavarësisë, transparencës dhe efikasitetit.

4.21. **Me qëllimin e progresit në aspiratat e Shqipërisë për hyrjen në BE, vendi ka nevojë t'i kushtojë një rëndësi më të madhe procesit të zbatimit të ligjeve dhe cilësisë së administratës publike.** Raporti i progresit i KE për Shqipërinë vë në dukje se në shumë fusha megjithëse është miratuar legjislati, nuk janë miratuar (ende) rregulloret e nevojshme për zbatimin e tij; si edhe në disa raste ka mungesa të zbatimit të tij. Për shembull, raporti vë në dukje se nuk ka përfunduar as

regjistrimi fillestar i pronave e as inventari i tokës shtetërore të caktuar për kompensim, dhe se çështjet e pazgjidhura lidhur me kompensimin e ish pronarëve vazhdojnë të frenojnë progresin. Më pas, në fushën e politikës së taksave raporti tërheq vëmendjen mbi nevojën për konsultime me biznesin dhe shoqërinë civile “për të shmangur pasiguritë që lindin nga ndryshimet e vazhdueshme në kuadrin ligjor”.

4.22. Raporti i progresit i BE vë re gjithashtu se në përgjithësi është bërë pak progres në përmirësimin e administratës publike. Ai raporton se veçanërisht Ligji i Shërbimit Civil është sabotuar nga numri i madh i punonjësve me kontratë dhe politizimi i emërimeve. Ai përfundon se nevojitet progres i mëtijshëm për të krijuar një shërbim civil profesional të pavarur bazuar mbi meritat. ICA plotëson rëndësinë e këtyre përfundimeve duke treguar se: (i) produktiviteti i firmave ndikohet negativisht nga problemet e efikasitetit të gjykatave, përhapjes së korrupsionit, dhe kohën e humbur nga praktikantët me burokracinë; (ii) firmat eksportuese kanë më shumë mundësi të ndikohen negativisht nga mungesa e parashikueshmërisë rreth zbatimit të rregullave dhe kohës që kërkohet për të qënë në përputhje me këto rregullore; (iii) krijimi i vendeve të punës ndikohet negativisht nga procesi i zgjatur i përputhjes me rregulloret e qeverisë.

4.23. Plotësimi i standardeve të BE në lidhje me shtetin ligjor dhe cilësinë e institucioneve publike do të çojë në stimulimin e investimeve dhe rritjes ekonomike. Përfitimet e hyrjes në BE shtrijnë efektet si në përmirësimin e institucioneve dhe cilësinë e qeverisjes, po ashtu edhe në përfitimet e drejtpërdrejta të integritetit të tregut dhe disponueshmërinë e burimeve financiare nga BE. Me kryerjen e progresit, përfitimet ekonomike të këtyre reformave do të ndihen madje para hyrjes në BE. Kështu që, gjatë kohës që qeveria vazhdon të bëjë progres në këto fusha, bizneset do të fillojnë të ndjejnë përfitimet e reformave institucionale në formën e rritjes së investimeve dhe mundësive ekonomike. Megjithatë, duhet të jetë e qartë se procesi drejt anëtarësimit në BE kërkon kryerjen e një progresi të vërtetë (që është i ndryshëm nga kryerja vetëm e reformave të kuadrin ligjor). Në fakt, për anëtarësimin në BE do të vlerësohet zbatimi i reformave në praktikë. Progresi i ngadaltë, përveç ngadalësimit të procesit të hyrjes në BE, mund të japë një sinjal negativ si ndaj investitorëve vendas ashtu dhe ata të huaj në lidhje me klimën e investimit.

IV. REKOMANDIME

4.24. Në vitet e fundit Shqipëria ka bërë progres të madh në përmirësimin e qeverisjes së sektorit publik dhe klimës së investimeve. Efekti i veprimeve të qeverisë është konfirmuar nga anketimet e firmave shqiptare. Megjithatë, Shqipëria ka është ende prapa vendeve më të suksesshme në rajon, kështu që intensifikimi i fokusit në këto fusha duhet të përbëjë një prioritet të lartë, si për shkak të ndikimit pozitiv në axhendën e rritjes afatgjatë ashtu edhe për rolin thelbësor të tyre në integrimin në BE. Siç duket një nga çështjet kyçe që duhet të trajtohet për të ulur kostot dhe pasigurinë e investimeve është që të sigurohet që institucionet publike dhe gjithë zyrtarët të mbështesin dhe imponojnë zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve - dhe ç’është më e rëndësishme, edhe perceptimi për veprimet e tyre të jetë i tillë. Rekomandimet e këtij raporti janë:

- **Të përmirësohet qartësia (transparenca) e proceseve të miratimit të ligjeve dhe rregulloreve të reja dhe të rishikimit të efikasitetit të atyre ekzistuese.** Kjo mund të arrihet nëpërmjet forcimit të rolit të Task Forcës për Reformat Rregullatore (RRTF) që ka një mandat për të formuluar dhe monitoruar planin e reformave rregullatore dhe duke i dhënë asaj formën e një strukture të përhershme nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të Kryeministrit. Gjithashtu e rëndësishme është edhe përfundimi i reformës së inspektimit dhe krijimi i një sistemi tërësisht funksional të Analizës së Ndikimit Rregullator (RIA). Megjithatë, ndonëse të dy këto masa janë të nevojshme, masa e parë mund të ketë ndikim të vogël në vetvete, ndërsa e dyta mund të kërkojë kohë të gjatë për tu kryer.

- **Të rishikohet procesi ku vendimet për politikat merren dhe kthehen në ligje.** Kjo mund të kërkojë që propozimet e reja, përveç vlerësimit të ndikimit rregullator të tyre, të analizohen edhe për përputhshmërinë me kuadrin ligjor ekzistues. Për më tepër, kompleksiteti i zbatimit duhet të vlerësohet në mënyrë realiste. Kjo do të ndihmojë në sigurimin që koha dhe burimet administrative të nevojshme janë të disponueshme përpara se legjislacioni i ri të hyjë në fuqi dhe që afatet kohore të përshtatshme për përpunimin e rregulloreve zbatuese të ligjeve janë përcaktuar paraprakisht.
- **Të kryhen konsultime periodike midis sektorit privat dhe qeverisë mbi të gjitha masat e rëndësishme që prekin bizneset.** Gjithashtu, qeveria duhet të ketë detyrim ligjor për të publikuar një përmbledhje të çështjeve të ngritura nga sektori privat dhe se si do të trajtohen këto nëse legjislacioni i ri do të hyjë në fuqi. Një mekanizëm i tillë duhet të jetë një kusht paraprak si për funksionimin efikas të TFRR ashtu dhe për krijimin e një procesi efektiv të RIA. Ajo do të ketë efektin e ndërgjegjësimit të zyrtarëve rreth problemeve të mundshme me legjislacionin e ri (dhe mundësinë për shmangien e konflikteve me legjislacionin ekzistues).
- **Të krijohet një gjykatë për apelimet administrative.** Kjo do ju japë atyre që preken negativisht nga vendimet e qeverisë mundësinë e apelimt të tyre. Për të hequr ndjesinë e individëve dhe ndërmarrjeve se ata nuk kanë mundësi për të apeluar kundër vendimeve të qeverisë, madje edhe kur këto duket se janë në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret, do të duhet një kohë shumë e gjatë.
- **Të përmirësohet procesi i konsultimeve dhe zbatimit të vendimeve të gjykatës së apelit administrativ.** Angazhimi për të respektuar procesin e konsultimit dhe vendimet e gjykatës administrative do të ndihmojë krijimin e besimit dhe demonstrimit se zyrtarët publikë iu nënshtrohen të njëjtave ligje sikurse çdo kush tjetër. Kjo do të përmirësojë ndjeshëm nëpërmjet sanksionimit të zyrtarëve që nuk zbatojnë ligjet dhe vendimet e gjykatës.

BIBLIOGRAFIA

- Amsden, A. H. (2001). *The Rise of "The Rest" : Challenges to the West from Late-industrializing Economies*. Oxford ; New York: Oxford University Press.
- Arrow, K. J. (1973). Arsimi i lartë si një filtrues. *Journal of Public Economics*, 2, 3, fq. 193-216.
- Beirne, J. dhe Campos, N. F. (2007). Inputet dhe rezultatet arsimore para tranzicionit nga komunizmi. *Economics of Transition / Banka Europiane pwr Rindwrtim dhe Zhvillim (Ndwrkombwtare)*, 15, Nr. 1, fq.57-76.
- Blanchard, O. dhe Giavazzi, F. (2002). Defiçitet e llogarive rrjedhëse në zonën e euros: Fundi i enigmës Feldstein-Horioka? *Brookings Papers on Economic Activity (U.S.)*, Nr. 2, fq. 147-209.
- Canning, M., Godfrey, M. dhe Holzer-Zelazewska, D. (2007). *Vocational Education in the New EU Member States: Enhancing Labor Market Outcomes and Fiscal Efficiency*. Washington DC: Banka Botërore.
- Carletto, C. dhe Kilic, T. (2008). *Ngjitja në Shkallë. Ndikimi i Përvojës së Emigrimit në Mobilitetin e Punësimit në Shqipëri*: Banka Botërore.
- Chandra, V., Eröcal, D., Padoan, P. C. dhe Braga, C. A. P. (Eds.). (2009). *Innovation and growth: chasing a moving frontier*. Paris: OECD dhe Banka Botërore.
- Cullen International (2010). Ofrimi i shërbimeve të monitorimit rregullator dhe zhvillimeve të tregut për shërbimet e komunikimeve elektronike dhe të shoqërisë së informacionit në Vendet e Zgjerimit. Draft Raport për Komisionin Europian.
- Dahlman, C. (2009). Different innovation strategies, different results: Brazil, Russia, India, China dhe Korea (the BRICKs). Në (publikimin e) V. Chandra, D. Eröcal, P. C. Padoan dhe C. A. P. Braga, *Innovation and growth: chasing a moving frontier*. Paris: OECD dhe Banka Botërore.
- Komisioni Europian (2009). Raport Progresi i Shqipërisë 2009.
- Komisioni Europian (2010). Një Strategji Europiane për Rritje Ekonomike të Zgjuar, të Qëndrueshme dhe Përfshirëse. Komisioni Europian.
- Fellegi, I. (2004). Ruajtja e Besueshmërisë së Statistikave Zyrtare. *Statistical Journal of the United Nations Economic Commission for Europe*, 21, 3-4, fq. 191-198.
- Hanushek, E. A. dhe Woessmann, L. (2008). The Role of Cognitive Skills in Economic Development. *Journal of Economic Literature*, 46, fq. 607-668.
- Hanushek, E. A. dhe Woessmann, L. (2009). *Do better schools lead to more growth? Cognitive skills, economic outcomes, and causation*. Washington DC: NBER Working Paper 14633.
- Hausmann, R. dhe Rodrik, D. (2003). Economic development as self-discovery. *Journal of Development Economics*, 72, 2, fq. 603-633.
- Hausmann, R., Rodrik, D. dhe Velasco, A. (2008). Growth Diagnostics. Në N. Serra dhe J. E. Stiglitz (eds), *The Washington Consensus reconsidered : towards a new global governance*. Oxford: Oxford University Press.
- Horvat, V. (2004). Brain Drain: Threat to Successful Transition in South East Europe? *Southeast European Politics*, 5, 1, fq. 76-93.

- IDRA. (2009). *Korrupsioni në Shqipëri: Studim i Perceptimit dhe Përvojës 2009, Përmbledhje e përfundimeve*. Tiranë: Instituti për Kërkimin e Alternativave të Zhvillimit: Shqipëri.
- Jonas, J. (2010). *Shqipëria: Objektivat Fiskale në Periudhën Pas Programit të FMN: Dokument Pune i FMN*.
- Kaufmann, D., Kraay, A. dhe Mastruzzi, M. (2009). Governance Matters VIII: Aggregate and Individual Governance Indicators, 1996-2008. *Libraria elektronike SSRN*.
- Kilic, T., Carletto, G., Davis, B. dhe Zezza, A. (2007). Investimi në Atdhe: Emigrimi i Kthyer dhe Pronësia e Biznesit në Shqipëri. Banka Botërore.
- Kopits, G. (2001). *Fiscal Rules: Useful Policy Framework or Unnecessary Ornament?* Washington DC: IMF Working Paper WP/01/145.
- Kydland, F. E. dhe Prescott, E. C. (1977). Rules Rather Than Discretion: The Inconsistency of Optimal Plans. *Journal of Political Economy*, 85, 3, fq. 473-491.
- Lin, J. Y. (2009a). Economic Development and Structural Change Paper presented at the "Challenges and Strategies for Promoting Economic Growth", Mexico City, 20 Tetor, 2009.
- Lin, J. Y. (2009b). *Economic development and transition : thought, strategy, and viability*. Cambridge ; New York: Cambridge University Press.
- Linden, T., Arnhold, N. and Vasiliev, K. (2008). *From Fragmentation to Cooperation: Tertiary Education, Research and Development in South Eastern Europe*. Washington DC: Banka Botërore.
- Lowell, L., Findlay, A. dhe Stewart, E. (2004). *Brain Strain: Optimising Highly Skilled Migration from Developing Countries: IPPR Azili dhe Emigracioni Dokument Pune, Nr. 3*.
- Luci, E., Muco, M. dhe Sojli, E. (2006). Eurozimi në Shqipëri: nga spontaniteti tek konsensi. *Global Development Network Southeast Europe*.
- Lundvall, B.-Å. (2008). Higher Education, Innovation, and Economic Development. Në (publikimn e) J. Y. Lin, B. Pleskovic dhe Banka Botërore. *Annual World Bank Conference on Development Economics 2008, Regional : Higher education and development*. Washington DC: Banka Botërore.
- Mertaugh, M. (2008). The Role of Secondary Vocational Education and Training in Meeting Changing Skill Needs (dokument informues). Në, *Closing the Skill Gap Study of the ECA Region (për tu botuar së shpejti)*. Washington DC: Banka Botërore.
- Miluka, J. dhe Dabalën, A. (2008). Eksplorimi i Rolit të Emigracionit Ndërkombëtar të Shqipërisë në Arsim. Studim i prezantuar në konferencën Shqipëri-Banka Botërore.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë. (2008). *Strategjia për Arsimin e Lartë (2007-2013)*. Tiranë.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë. (2009). *Raporti Vjetor i Statistikave të Arsimit 2006-2007*. Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë dhe Banka Botërore (2008). *Shqipëria: Arsimi i Mesëm dhe i Lartë – Si Japin Mësim Mësuesit në Klasat e Shkollave të Mesme*. Banka Botërore.

- Nexus Migration Development Initiative. (2009). DEVINPRO Pasqyrë e Rezultateve për Shqipërinë.
- Nikolovska, M. (2008). Zhvillimi i Kapitalit Human. Analizë e Vendit: Shqipëria. Fondacioni European i Trainimeve.
- North, D. C. (1994). Economic performance through time. *American Economic Review*, 84, 3, fq. 359-368.
- OECD (2009). The Role of Communication Infrastructure Investment in Economic Recovery. OECD Grupi i Punës së OECD për Politikat e Infrastrukturës dhe Shërbimeve të Komunikimeve.
- Qiang, C. Z.-W. dhe Rossotto, C. (2008). Economic Benefits of Broadband. In, *Information and Communications for Development 2009: Extending Reach and Increasing Impact*, . Washington DC: Banka Botërore.
- Salter, A. dhe etj. (2000). Talent, not Technology: Publicly Funded Research and Innovation in the UK. Raport i kryer për Komitetin Dekanëve dhe Drejtorëve dhe Këshilli i Financimit të Arsimit të lartë për Anglinë.
- Sikor, T., Müller, D. dhe Stahl, J. (2009). Fragmentizimi i Tokës dhe Braktisja e Tokave Pjellore në Shqipëri: Ndikimet mbi Rolin e Shtetit dhe Komunitetin në Konsolidimin e Tokës në Fazën Pas-Komuniste. *World Development*, 37, 8, fq. 1411-1423.
- Spence, A. M. (1973). Job Market Signaling. *Quarterly Journal of Economics*, 87, 3, fq. 355-374.
- Tan, H., Gimpelson, V., Kapelyushnikov, R., Lukyanova, A. dhe Savchenko, Y. (2007). *Skills shortages and training in Russian enterprises*. Washington, D.C.: Banka Qëndrore, Rajoni i Europës dhe Azisë Qëndrore, Njësia e Zhvillimit të Sektorëve të Privat dhe Financiar.
- Vullnetari, J. (2007). Emigracioni dhe Zhvillimi i Shqipërisë: Analizë Moderne. IMISCOE. Banka Botërore. (2005). *Shqipëria: Ruajtja e Rritjes Ekonomike pas Tranzicionit*. Washington DC.
- Banka Botërore. (2007). *Shqipëria: Politika Strategjike për një Sektor më Konkurrues të Bujqësisë*. Washington DC: Banka Botërore.
- Banka Botërore. (2008). *The Growth Report: Strategies for Sustained Growth and Inclusive Development*. Washington DC
- Banka Botërore (2009a). *Krijimi i Konkurrueshmërisë në Shqipëri: - Vlerësimi i Klimës së Investimeve*. Washington DC: Banka Botërore.
- Banka Botërore (2009b). *Politikat e Inovacionit: udhëzim për vendet në zhvillim*. Washington, D.C.: Banka Botërore.
- Forumi Botëror Ekonomik. (2009). *Raporti i Konkurrueshmërisë Globale 2009–2010*. Gjenevë: Forumi Botëror Ekonomik.
- Forumi Botëror Ekonomik dhe INSEAD. (2009). *The Global Information Technology Report 2008–2009: Mobility in a Networked World*. Gjenevë: Forumi Botëror Ekonomik.
- Yemtsov, R. G., Cnoblach, S. R. dhe Mete, C. (2006). Evolution of the Predictors of Earnings during Transition, Draft Dokument.